

**Vlerësimi i dhjetë mbi gjendjen e pakicave etnike në Kosovë**  
(Periudha kohore prej muajit maj 2002, deri në dhjetor 2002)

Mars 2003

## PËRMBATJA

<b>PËRMBATJA .....</b>	<b>2</b>
<b>FJALORTHI.....</b>	<b>3</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>5</b>
<b>REKOMANDIMET.....</b>	<b>8</b>
<b>PJESA 1: SIGURIA DHE LIRIA E LËVIZJES PËR PAKICAT NË KOSOVË.....</b>	<b>12</b>
I. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM .....	12
II. PASQYRA REGJIONALE .....	14
<i>Regjioni i Prizrenit.....</i>	<i>14</i>
<i>Regjioni i Pejës.....</i>	<i>16</i>
<i>Regjioni i Gjilanit .....</i>	<i>17</i>
<i>Regjioni i Mitrovicës.....</i>	<i>21</i>
<i>Regjioni i Prishtinës .....</i>	<i>25</i>
<b>PJESA 2: QASJA NË DREJTËSI .....</b>	<b>30</b>
I. INTEGRIMI GJYQËSOR/PUNËSIMI NËPËR GJYQE .....	30
II. QASJA FIZIKE NË GJYQE DHE OBJEKTET E PARABURGIMIT .....	32
III. STRUKTURAT PARALELE .....	34
<b>PJESA 3: DISKRIMINIMI DHE QASJA NË SHËRBIMET THEMELORE .....</b>	<b>36</b>
I. QASJA E BARABARTË NË ARSIMIM .....	37
<i>Strukturat paralele të arsimit dhe efekti i tyre mbi të drejtën për arsimim .....</i>	<i>37</i>
<i>Arsimimi në gjuhën amtare.....</i>	<i>38</i>
<i>Nevojat e veçanta arsimore për bashkësitë RAE .....</i>	<i>39</i>
II. QASJA E BARABARTË NË PUNËSIM .....	39
III. QASJA E BARABARTË NË SHËRBIMET SOCIALE.....	41
IV. QASJA E BARABARTË NË KUJDESIN SHËNDETËSOR .....	44
<b>PJESA 4: TË DREJTAT PRONËSORO-BANESORE.....</b>	<b>47</b>
I. DREJTORATI PËR ÇËSHTJE PRONËSORE DHE BANESORE (DÇPB) DHE KOMISIONI PËR ANKESA DHE PARASHITRESA PËR ÇËSHTJE BANESORE DHE PRONËSORE (KAPÇB).....	47
II. KADASTRI .....	51
III. NDËRTIMI I PALIGJSHËM DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS .....	52
IV. RREGULLORJA MBI RREGJISTRIMIN E KONTRATAVE PËR SHITBLERJEN E PATUNDSHMËRIVE NË ZONAT E VEÇANTA GJEOGRAFIKE TË KOSOVËS (DHE URDHËRESA ADMINISTRATIVE 2001/16 DHE 2002/4 .....	52
V. RINDËRTIMI DHE KTHIMI.....	55
<i>Qasja e pakicave në ndihmën për rindërtim .....</i>	<i>55</i>
<i>Qasja e pakicave dhe zbatimi i Udhëzimeve të UNMIK-ut mbi rindërtimin e shtëpive .....</i>	<i>56</i>
<b>PJESA 5: QASJA NË STRUKTURAT PUBLIKE, CIVILE DHE POLITIKE .....</b>	<b>62</b>
I. QASJA NË PROCESIN ZGJEDHOR .....	62
II. QASJA NË PROCESIN POLITIK .....	64
<i>Strukturat qendrore.....</i>	<i>64</i>
<i>Strukturat komunale.....</i>	<i>65</i>
III. TOLERANCA, PAJTIMI DHE DIALOGU NDËRETNIK .....	66

## FJALORTHI

ABC(orig)	Bordi këshilldhënës mbi komunitetet
KK-ës	Kuvendi i Kosovës
QKKM	Qendra Koordinuese për Kosovë dhe Metohi
KQZ	Komisioni qendror i zgjedhjeve
CoE(orig)	Këshilli i Evropës
QPS-le	Qendra për punë sociale
DJA(orig)	Departamenti i punëve gjyqësore
DOJ(orig)	Department i drejtësisë
KEDNj-ut	Konventa evropiane mbi të drejtat e njeriut
IRJM	Ish Republika Federale e Maqedonisë
KAPÇB	Komisioni për ankesa/parashtrësia për çështje pronësore/banesore
DÇPB	Drejtoria për çështje pronësore/banesore
KNKK	Komiteti ndërkombëtar i kryqit të kuq
PZhI	Personat e zhvendosur intern
IOM(orig)	Organizata ndërkombëtare për migrim
GPNSHDNj(IPWGHR orig)	Grupi punues ndërshtyllor mbi të drejtat e njeriut
SIGj	Seksioni për integrim gjyqësor
AKK-ës	Agjencioni Kadastral i Kosovës
BKK-ës	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KEK	Korportata Elektroenergjetike e Kosovës
KFOR(orig)	Forcat e Kosovës
BSH-KFOR	Brigada shumëkombëshe e KFOR-it
KGjPK	Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës
SHPK	Shërbimi policor i Kosovës
TMK	Trupat e Mbrojtjes së Kosovës
ZBL-le	Zyrtari për bashkësitë lokale
GPL-le	Grupet punuese lokale
ZKK-it	Zyrtari komunal i kadastrit
MAPH	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
KKB-re	Komitetet komunale banesore
MPMS-le	Ministria e punës dhe mirëqenies sociale
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
GPK	Grupi punues komunal
ZÇK-ve	Zyra për çështje të komuniteteve
OCHA (orig)	Zyra e KB-ra për koordinimin e çështjeve humanitare
ZÇK-ve	Zyra e PSSP-së për çështjet e komuniteteve/bashkësive
OHCHR(orig)	Zyra e komisionerit të lartë për të drejtat e njeriut
ZKK	Zyra e PSSP-së për kthime dhe komunitete
OSBE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë
IPV-es	Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes
RAE	Romë/Ashkali/Egjptas
GRI	Grupi regjional implementues
GRP	Grupi regjional punues
NjSP	Njësi special i policisë
PSSP	Përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm
RKS KB-ra	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB-ra
UNICEF(orig)	Fondi i KB-ra për fëmijë

UNHCR (orig)  
AK KB-ra  
UNMIK(orig)  
OBSH

Komisioneri i lartë i KB-ra për refugjatë  
Administratori komunal i UNMIK-ut  
Administrata e përkohshme e KB-ra, Misioni në Kosovë  
Organizata botërore e shëndetësisë

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Ky raport është i dhjeti në vazhden e vlerësimeve të kryera mbi gjendjen e pakicave etnike në Kosovë, dhe i realizuar bashkarisht nga OSBE dhe UNHCR. Ky vlerësim ofron zhvillimet më të reja mbi përfundimet dhe rekomandimet e propozuara në vlerësimin paraprak, dhe mbulon periudhën kohore prej muajit maj deri në muajin dhjetor të vitit 2002. Duke njohur zhvillimet e rëndësishme në proceset e zhvillimit të korinizës ligjore dhe vendim-marrëse në Kosovë gjatë periudhës raportuese, ky raport gjithashtu mbulon edhe diskutimet mbi zhvillimet të cilat kanë ndikuar në gjendjen e pakicave në Kosovë.

Vlerësimi i nëntë i rradhës, i publikuar në prill të vitit 2002, kishte identifikuar dhe vënë në spikamë aspektet kyçe të shqetësimeve mbi gjendjen e pakicave etnike në Kosovë: sigurinë dhe lirinë e lëvizjes, qasjen në shërbimet elementare, pjesëmarrjen në procesin politik dhe në strukturat civile, nxitjen e dialogut ndëretnik, si dhe modelet e procesit të kthimit. Në atë kohë, sipas atij vlerësimi, ishin vërejtur kahje pozitive të rritjes së sigurisë dhe lëvizshmërisë për pakicat në Kosovë, por kishte mbetur ende kritik progresi i ngadalshëm dhe jokonsistent në drejtim të garantimit për pakicat të qasjes stabile në sistemin gjyqësor dhe shërbimet tjera, si dhe qasjes në kornizën mbrojtëse për të drejtat e tyre pronësore juridike. Vlerësimi në fjalë, gjithashtu kishte bërë të ditur për strukturat paralele të cilat ekzistojnë në komunat veriore të Kosovës, të dominuara nga serbët. Të gjitha këto shiheshin si faktorë përcaktues për çështjen e integritetit dhe ndërveprimit të pakicave me popullatën shumicë, por edhe si një faktor i rëndësishëm parandalues ndaj përpjekjeve të Misonit të administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe të Institucioneve të përkohëshme të vetëqeverisjes (IPV), drejt krijimit të institucioneve dhe strukturave të qëndrueshme në shërbim të të gjitha bashkësive të Kosovës dhe për territorin e tërësishëm të Kosovës.

Ky raport përshkruan lëvizjet nëpër këto regjione gjatë periudhës raportuese dhe bën vlerësime mbi atë se deri në çfarë shkalle janë implementuar rekomandimet e parashtruara në vlerësimin e nëntë dhe çfarë ndikimi kanë pasur veprimet e tilla në kushtet e bashkësive të pakicave në Kosovë dhe në procesin e kthimit. Duke njohur dhe avancuar të drejtën e secilit individ për t'u kthyer në shtëpinë e vet, pa marrë parasysh statusin etnik apo ndonjë tjetër status, ky vlerësim ka për qëllim t'i ndihmojë UNMIK-ut dhe IPV-es, me rekomandimet mbi atë se si të krijohen kushtet për një kthim përmbytësor. Për këtë qëllim, raporti krijon një lidhje logjike në mes të gjendjes së pakicave etnike në Kosovë dhe procesit të kthimit. Njëkohësisht, ky raport analizon edhe efektet e secilit zhvillim apo ngecje, në zbatimin e politikave dhe praktikave që ndikojnë në pakicat, në inkurajimin apo dekurajimin e të kthyerëve në rifillimin e jetës në bashkësitë nga të cilat janë detyruar apo shtyer të largohen. Pasi që personave të zhvendosur u është dhënë zgjidhja e lirë dhe e informuar për t'u kthyer, faktori kuptimplotë dhe i cili ndikon në përcaktimin e tyre mund të jetë vetëm përparimi i arritur në aspektet kryesore të shtjelluara me këtë raport, siç janë: siguria, liria e lëvizjes, prona, shërbimet elementare, pjesëmarrja në strukturat politike dhe civile dhe dialogu ndëretnik.

Ky raport mëton të ofrojë një pasqyrë objektive mbi gjendjen e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes në secilin rajon të Kosovës në të cilin janë të pranishme bashkësitë e pakicave. Gjatë periudhës raportuese, ky raport vërenë se ka pasur përmirësime të kufizuara të shkallës së sigurisë, gjatë përcjelljes së disa rajoneve të bashkësive të pakicave. Zbritja graduale e shkallës së kriminalitetit me motive etnike, heqja e pikave kontrolluese të KFOR-it dhe miratimi i arranzhimeve më fleksibile dhe më pakë ndërhyrëse të sigurisë dhe pjesëmarrja e shtuar e pjesëtarëve të pakicave në kuadër të SHPK-së, dhe gjyqësi, gjë që përfaqëson shenja se gjendja e pakicave ofron më shumë baza inkurajuese. Megjithatë ky vlerësim konstaton se bashkësitë e pakicave vazhdojnë të

përrjetojnë shkallë të ndryshme të ngacmimeve, frikësimeve dhe provokimeve, pastaj edhe liri të kufizuar të lëvizjes.

Ky vlerësim i shtjellon çështjet e diskriminimit që kanë të bëjnë me bashkësitë e pakicave në Kosovë, dhe sidomos në sektorin e qasjes në arsimim, punësim, shërbime sociale dhe kujdes shëndetësor. Lidhur me këtë, ky raport konstaton se, çoftë i drjetpërdrejtë apo i tërthortë, qëllimshëm apo i pa qëllimtë, ky diskriminim vazhdon të paraqesë pengesë të madhe për mundësitë e pakicave që të jetojnë jetën e tyre normale në Kosovë. Përderisa Bordi Këshilldhënës për Komunitete (ABC orig), i cili është themeluar para publikimit të vlerësimit të mëparshëm, ka filluar të shqyrtojë çështjet e diskriminimit në nivelin e lartë politik, ky raport gjenë se diskriminimi nuk është adresuar në mënyrë të duhur në nivelet më të ulta. Qasja në arsimim, shërbimet sociale dhe kujdes shëndetësor nuk janë përmirësuar për pakicat në Kosovë. Qasja në sektorin publik të punësimit ka parë disa përmirësime të matura gjatë periudhës raportuese, por politika e diskriminimit pozitiv, që në parim është aprovuar, ende mbetet që të implementohet, ndërsa shkalla e përgjithshme e punësimit të pakicave në nivelin qendror dhe atë komunal nuk është e nivelit të kënaqshëm. Shpresohet që kjo gjendje do të përmirësohet me hyrjen në fuqi dhe zbatimin e Urdhëresës Administrative për implementimin e rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36. Për të nënvizuar disa prej rezultateve të arritura në përpjekjet për të identifikuar, eliminuar dhe ofruar mjete juridike efikase kundër diskriminimit, ky raport e ka identifikuar si rezultat “Projekt-pakon e ligjeve anti-diskriminuese”, si një prej hapave kryesorë në luftimin e fenomenit të përgjithshëm të diskriminimit, dhe që është relevant për bashkësitë e pakicave por edhe për popullatën shumicë. Shpejtësia e shqyrtimit dhe miratimit të këtij ligji nga ana e IPV-es dhe UNMIK-ut, paraqet një element esencial drejt avancimit dhe fuqizimit të praktikave anti-diskriminuese në Kosovë.

Nga perspektiva e qasjes në të drejtat pronësore, ky raport, prap e analizon shkallën e realizimit efektiv të të drejtave pronësore juridike, të cilat i gëzojnë bashkësitë e pakicave, por edhe ndikimin që e ka për mundësitë e pakicave, që kthimi i tyre i qendrueshëm të bëhet nga perspektiva e qasjes në të drejtat pronësore. Qasja në pronë si dhe realizimi i të drejtave pronësore juridike janë vlerësuar përmes një testi trepalësh: njohuria e të drejtave ligjore; qasja fizike në organet relevante gjyqësore dhe ekzekutive; dhe nëse qasja këtu realizohet, mundësia e organeve relevante për të garantuar gëzimin e këtyre të drejtave. Në këtë drejtim ky raport vlerëson efikasitetin dhe mekanizmat e Drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore (DÇPB-re) dhe Komisionit për ankesa dhe parashtesa për çështjet pronësore banesore (KAPÇPB-re), si dhe qasjen e pakicave në shërbimet kadastrale dhe ndihmën për rindërtim, por edhe zbatimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/17. Përkundër disa përparimeve që prej vlerësimit të fundit, ky raport gjenë se, niveli i qasjes në të drejtat pronësore në këto aspekte është joadekuat. Në veçanti, ky raport ka gjetur se, përkundër zhvillimeve inkurajuese, operacioneve të DÇPB-re dhe KAPÇPB-re, kërkojnë që t’ju kushtohet një vëmendje e vazhdueshme për të siguruar mbrojtje efikase për të drejtat pronësore të pakicave. Problemet për pakicat vazhdojnë të jenë ato të realizimit të qasjes në shërbimet kadastrale, si në aspektin e shërbimeve komunale dhe në atë të qasjes fizike në këto shërbime, dhe problemi i mungesës së shërbimit kadastral të kompletuar dhe funksional. Gjithashtu janë nënvizuar problemet që kanë të bëjnë me shitjet dhe qasjen në tokën bujqësore. Sa i përket rindërtimit, ky raport konkludon se qasja e pakicave në ndihmën përkatëse duket se është përmirësuar, por që mbrojtja e të drejtave pronësore për pakicat, varet nga shfrytëzimi i mekanizmave të paraparë me Udhëzimet e UNMIK-ut mbi rindërtimin e shtëpive. Nëse këto nuk shfrytëzohen, çoftë nga Komitetet komunale banesore, apo strukturat relevante për procesin e kthimit, të drejtat pronësore do të rrezikohen. Brenda kësaj kaptine, janë shqyrtuar edhe strukturat e reja të procesit të kthimit.

Pas ngecjes politike e cila kishte rrjedhur pas zgjedhjeve të përgjithshme të Kosovës në nëntor të vitit 2001, kjo periudhë raportuese shënon edhe nisjen dhe manifestimin e institucioneve të përkohshme në arenën politike. Në këtë moment, janë vërejtur disa shenja të angazhimit të strukturave lokale politike në dialogun ndëretnik, ndërsa angazhimi i plotë i të gjitha subjekteve dhe strukturave politike kërkon më shumë përpjekje dhe përkrahje nga bashkësia ndërkombëtare. Në këtë drejtim, raporti gjithashtu potencon se, për shkak se ndërtimi i mirëbesimit duhet të ngërthejë një ndryshim fundamental dhe cilësor të raporteve politike dhe sociale në mes të grupeve etnike, nevojitet angazhimi aktiv dhe përkrahja nga të gjithë akterët, përfshirë këtu të gjitha nivelet e IPV-es, të gjitha komunitetet lokale, të zhvendosurit dhe të kthyerit potencial, UNMIK-un, por edhe OJQ-të ndërkombëtare dhe vendëse të angazhuara dhe komunitetin e donatorëve. Raporti vën në spikamë rezultatet e zgjedhjeve komunale të tetorit 2002 si dhe efektet potenciale të proporcioneve të reja të pakicave nëpër kuvendet komunale të cilat mund të ndikojnë në gjendjen e bashkësive të pakicave në Kosovë. Çështja e ndërtimi i besimit dhe tolerancës është shtjelluar në kuptim të përpjekjeve të investuara si nga ana e bashkësisë ndërkombëtare dhe OJQ-ve vendëse drejt arritjes së një shoqërie të fuqishme civile në Kosovë, nga e cila pritet që pastaj të merr për sipër rolin kryesor në sigurimin e sistemit të kontrollit dhe baraspeshimit në arenën politike lokale.

Në përgjithësi, duke marrë parasysh gjendjen e përgjithshme të përshkruar në këtë raport, ndryshimet e vërejtura gjatë periudhës raportuese nuk janë fundamentale për të konkluduar se ekzistojnë kushtet për kthime të pakicave në një shkallë më të madhe në të ardhmen, duke nënvizuar me këtë rast, nevojën e vazhdueshme për mbrojtje ndërkombëtare të pjesëtarëve të këtyre pakicave, e sidomos serbëve, romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve të Kosovës.

## **REKOMANDIMET**

### **Siguria dhe liria e lëvizjes**

Vlerësimi i nëntë ka nxjerrur një sërë rekomandimesh përkitazi me sigurinë dhe lirinë e lëvizjes. Përparimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve duhet të vazhdojë.

- Përderisa ky vlerësim dokumenton se kufizimet në lirinë e lëvizjes për pjesëtarët e pakicave janë në masë të madhe të bazuara në perceptime se në gjendjen ekzistuese të sigurisë, Njësia e Policisë së Komunitetit e UNMIK-ut duhet të jetë edhe mëtutje e përfshirë në nismat për ngritjen e mirëbesimit në kuadër të të gjitha komuniteteve të pakicave, dhe paralelisht edhe të zhvillojë fushatë për ngritjen e vetëdijes në lidhje me mandatin, funksionet dhe përfitimet që mund t'i ketë komuniteti në fjalë nga e gjithë kjo.

### **Drejtësia**

- Përpjekjet e vazhdueshme të UNMIK-ut për shpërbërjen e strukturave paralele në komunat veriore të Kosovës, duhet të vazhdojë, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse në Beograd. Kjo ndërlidhet me (1) procedurat penale paralele për shkak se ato krijojnë mundësinë e rrezikut të dyfishtë dhe mund të kenë ndikim në korrektësinë e gjykimit dhe (2) procedurat civile paralele përderisa të krijojnë një mjedis të paqartësive ligjore dhe pengojnë integrimin e pakicave në gjyqësi.
- Një fushatë të informimit publik e cila do t'i njoftonte pjesëtarët e pakicave se integrimi gjyqësor dhe themelimi i gjyqeve të reja do të pritet si një hap drejt inkurajimit të këtyre qytetarëve që të shfrytëzojnë dhe të mbështeten në punën e këtyre gjykatave. Një fushatë e tillë mund të organizohet nga Shtylla I, Shtylla III, dhe/apo çfarëdo organizate tjetër joqeveritare.
- OSBE-ja përsërit rekomandimet e saj se në të ardhmen, lëndët nuk bën t'ju caktohen gjykatësve në bazë të përkatësisë etnike. Të gjitha lëndët e ndjeshme të cilat kanë të bëjnë me gjykatës dhe të pandehur të përkatësive të ndryshme etnike duhet të monitorohen për së afërmi nga OSBE-ja dhe çdo gjykatës i cili shpreh anime apo diskriminim duhet të jetë objekt i masave disiplinore nga ana e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës.

### **Arsimimi**

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) duhet, në bashkëpunim me KFOR-in, policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në, të hartojë një plan gjithëpërfshirës për të përmirësuar qasjen e barabartë në arsimim për të gjithë pjesëtarët e pakicave. Ky plan duhet të ofrojë siguri për studentët minoritar, e cila në vetëi do të përfshinte edhe sigurimin e transportimit të sigurtë me autobus.
- UNMIK-u dhe MASHT-ja duhet të organizojnë dhe zbatojnë një plan për të ofruar një arsimim në gjuhët e pakicave në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut.
- Organizatat qeveritare dhe ato joqeveritare kanë arritur sukses në organizimin e projekteve të cilat do të ofrojnë një riarsimim si mjet përmirësues për diskriminimin e pjesëtarëve të pakicave RAE. UNMIK-u dhe MASHT-ja duhet të studiojnë “praktikat më të mira” të këtyre projekteve dhe t'i zbatojnë ato anëmbanë Kosovës, në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtar dhe OJQ-të.

### **Punësimi**

- Ministria e Shërbimeve Publike duhet të sigurojë zbatimin e Urdhëresës Administrative 2003/2 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, dhe të vendos një theks të veçantë në dispozitat të cilat mundësojnë një përfaqësim proporcional të komuniteteve (një plan për diskriminimin pozitiv). Një plan i tillë duhet të përfshijë një trajnim për nëpunësit civil në kuadër të spektrit të cilin e mbulon Urdhëresa



Administrative, në veçanti ato dispozita që ndërlidhen me diskriminimin pozitiv. Më tutje, krijimi i një sistemi efikas të brendshëm i cili do të monitoronte këtë zbatim luan një rol kyç në këtë drejtim.

- Në dritën e urdhëresës së re administrative, të gjitha praktikave të punësimit duhet të rivlerësohen përbrenda pasi të jenë përcaktuar politikave dhe procedurat e punësimit për të gjitha nivelet, për shkak se një gjë e tillë do të siguronte zbatimin e praktikave të drejta të punësimit në kuadër të tërë Shërbimit Civil të Kosovës.
- Zyra e Kryeministrit duhet të jap pëlqimin e saj në lidhje me pakon e ligjeve antidiskriminuese, e cila mëpastaj duhet të miratohet dhe të nxirret nga kuvendi dhe pastaj si i tillë të zbatohet nga IPVQ-të. Mekanizmat zbatues në kuadër të këtij propozim ligji do të ofrojnë mjete kompenzuese efikase për pjesëtarët e të gjitha pakicave, të cilët u janë nënshtruar formave të ndryshme të diskriminimit, veçanërisht atyre të diskriminimit në punësim.
- Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shërbimeve Publike, duhet të zbatojnë programin gjithëkosovar për promovimin e punësimit të pakicave e cila do t'i tërheqte kandidatët e kualifikuar nga rradhët e pakicave që të aplikojnë për punësim.

### **Shërbimet sociale**

- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të hartojë një politikë gjithëpërfshirëse për sforcimin e masave të cilat do të ofronin bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave ndërmjet punëtorëve të qendrave për punë sociale të cilët punojnë në zonat e banuara me popullatë shumicë dhe atyre që punojnë në zonat me popullatë pakicë. Nismat siç janë mbledhjet ku shkëmbehen informatat dhe sesionet e zakonshme trajnuese duhet të implementohen nga drejtorët e QPS-ve dhe të përkrahen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Strategjitë e qëndrueshme të qasjes së pakicave, të cilat udhëhiqen plotësisht nga punëtorët social, duhet të zbatohen me vëmendje të posaçme për ata pjesëtarë të pakicave që janë izoluar nëpër shtëpitë e tyre qoftë në zonat urbane apo edhe ato rurale.
- QPS-të duhet të ofrojnë një shpërndarje proporcionale të oficerëve për mbrojtje sociale në zonat e banuara me komunitetet e pakicave.

### **Kujdesi shëndetësor**

- Ministria e Shëndetësisë duhet të ndërmerr veprime drejt implementimit të një sistemi të kujdesit shëndetësor, i cili është i aftë të vihet në shërbim si të komunitetit shumicë gjithashtu edhe të atij pakicë, dhe i cili është në gjendje të ofrojë mbështetje për ato objekte shëndetësore të cilat ofrojnë shërbime për komunitetet e përziera dhe së fundi të jetë në gjendje të dyfishojë numrin e praktikave ekzistuese të mira. Përpjekjet e koordinuara dhe dialogu ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, UNMIK-ut dhe Ministrisë së Shëndetësisë në Beograd duhet të na shpiejnë drejt një zgjidhje të qëndrueshme për praninë e mëtejshme të sistemit paralel të kujdesit shëndetësor në Kosovë.
- Ministria e Shëndetësisë duhet të nxjerr sa më shpejt “Kartën e të Drejtave të Pacientëve”, e cila për momentin ka vetëm formën e draftit, e cila përfshin edhe dispozitat mbi qasjen pa diskriminim në kujdesin shëndetësor.
- Ministria e Shëndetësisë duhet të vazhdojë me përpjekjet e saj të vazhdueshme në ngjitjen e vetëdijes përkitazi me shërbimet ekzistuese të kujdesit shëndetësor që i'u ofrohen pakicave, duke u përqëndruar më shumë në komunitetet RAE.

### **Të drejtat pronësore dhe banesore**

Vlerësimi i nëntë ka nxjerrur një sërë rekomandimesh në lidhje me të drejtat pronësore dhe banesore për shkak se ato ndërlidhen ngushtë me komunitetet e pakicave. Vazhdimi i rekomandimeve të tilla të nxjerra nga OSBE-ja, kanë treguar se nuk është shënuar ndonjë zhvillim i rëndësishëm në ato rajone të cilat ishin temë trajtimi e vlerësimit të nëntë. Së këndejmi, OSBE-ja nuk do t'i përsërit rekomandimet në fjalë.

- Rekomandimet paraprake përkritazi me ndarjen e resurseve DPÇB-së/KAPÇPB-së, aktivitetet e shtuara për ngritjen e vetëdijes dhe menaxhimi i përmirësuar i lëndëve mbetet ende me rëndësi thelbësore dhe duhet të adresohen në mënyrë prioritare.
- DPÇB-ja duhet të hapë zyrën e saj në Shkup (IRjM) për të lehtësuar më shumë qasjen e parashtruesve të ankesave të përkatësisë së pakicave të zhvendosur jashtë Kosovës.
- Çdo komunë duhet të ketë stafin i cili është i trajnuar mirë në çështjet që kanë të bëjnë me mekanizmat dhe kompetencat e DPÇB-së. Ky person duhet të veprojë si një kontakt person për DPÇB-në në kuadër të organit vetëqeverisës lokal.
- Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerr sa më shpejt legjislacionin potësues, i cili është i domosdoshëm për zbatimin e rregullores 2002/22, mbi themelimin e regjistrit të pronave të paluajtshme në Kosovë. Puna drejt krijimit të një sistemi funksional kadastral duhet të jetë një prioritet si i UNMIK-ut gjithashtu edhe i IPVQ-ve.
- Zyrtarët komunal dhe ata të organeve për zbatimin e ligjit duhet të ndërmarrin hapa adekuat për të penguar dhe zgjedhur problemet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të paligjshëm të tokës bujqësore dhe asaj banesore të cilat janë pronë e pjesëtarëve të pakicave.

### **Rindërtimi i cili ndërlidhet me kthimin**

- Udhëzimet e ardhshme për Rindërtimin e Shtëpive duhet të nxirren në formë të një urdhërese administrative. Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të hartojë ligje të cilat do t'ja paraqes Kuvendit të Kosovës për miratim të cilat duhet të përmbajnë edhe kriteret për ndarjen e ndihmës për rindërtim pa diskriminim, dispozitat për një proces të hapur të selektimit dhe mekanizmat të cilat parashehin përgjegjshmërinë e organeve përkatëse dhe të drejtën për ankesë.
- Format e ardhshme të udhëzimeve nuk duhet të vlerësojnë vetëm shkallën e përgjithshme të rrezikueshmërisë së komuniteteve si një kriter për dhënien e ndihmës për rindërtim, mirëpo ato gjithashtu parashohin mekanizmat për adresimin e vlerësimeve të shkallës së rrezikueshmërisë individuale.
- OJQ-të të cilat veprojnë si partnerë implementues të Komiteteve Banesore Komunale duhet të mbahen të përgjegjshme për veprimet e tyre si nga vetë KBK-të gjithashtu edhe nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor për qëndrimin e tyre kundrejt pakicave. Format e ardhshme të këtyre udhëzimeve duhet të përcaktojnë mekanizmat adekuat. Çdo komunë duhet të emërojë nga një përfaqësues të merr pjesë në procesin e vlerësimit të punës së OJQ-ve në këtë drejtim dhe të raportojë për çfarëdo parregullsi KBK-ve apo MAPH-së.
- Bartja e përgjegjësive komunave nga ana e UNMIK-ut duhet të shoqërohet me një mekanizëm të përkohshëm efikas monitorues, siç është raportimi javor, me qëllim të krijimit të të një shkalle të pranueshme të mbajtjes në përgjegjësi të drejtorateve përkatëse dhe KBK-ve për veprimet e tyre nga ana e UNMIK-ut dhe MAPH-së.
- Komunitat dhe partnerët e tyre implementues duhet të sigurojnë që të gjithë ata të cilët pranojnë ndihmë për rindërtim t'i lëshojnë pronat të cilat i kanë okupuar në mënyrë të paligjshme duke i'u mundësuar personave të zhvendosur të kthehen në shtëpitë e tyre. DPÇB-ja/KAPÇPB-ja dhe gjyqet duhet të përfshihen në mënyrë aktive në gjetjen e mjeteve kompenzuese për okupimin e paligjshëm.

- Komunat dhe partnerët e tyre implementues duhet të sigurojnë që të drejtat pronësore të vërtetohen para se të vazhdohet me rindërtim. DPÇB-ja duhet të jetë e përfshirë në mënyrë aktive në procesin e vërtetimit të këtyre të drejtave.
- UNMIK-u, veçanërisht Zyra për Kthimin e Komuniteteve, duhet të vazhdojnë me përpjekjet e tyre për të siguruar një shkallë të koherencës, transparencës dhe konsistencës në strukturat vendim-marrëse dhe ato që hartojnë politika mbi çështjen e kthimit si në nivel komunal ashtu edhe në atë regjional.

### **Kthimi**

- Bashkësia ndërkombëtare dhe IPVQ-të duhet të vazhdojnë të gjejnë zgjidhje për të kthyerit e të gjitha përkatësive etnike. Ata gjithashtu duhet të vazhdojnë të forcojnë të fthitha strukturat të cilat janë themeluar për t'ju përgjigjur nevojave të të kthyerve.
- Aktivitetet të cilat ndërlidhen me dialogun ndëretnik dhe ndërtimin e tolerancës luajnë një rol thelbësor në krijimin e kushteve për kthim. Duke pasur parasysh ndikimin që e kanë IPVQ-të në qëndrimin e popullatës lokale ndaj kësaj çështje, rekomandohet fuqimisht intensifikimi i mëtutjeshëm i përfshirjes së tyre aktive në aktivitetet e këtij lloji në Kosovë.
- IPVQ-të duhet të rrisin angazhimin e tyre në procesin e kthimit. Në të njëjtën kohë, UNMIK-u duhet të ofrojë përkrahje të fuqishme për aktivitetet që ndërlidhen me kthimin të cilat i zhvillojnë IPVQ-të, përfshirë këtu edhe ato që kanë të bëjnë me dialogun politik dhe ndërtimin e koncenzusit.
- IPVQ-të dhe UNMIK-u duhet t'i inkurajojnë komunat që të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e planifikimit të kthimit dhe në zbatimin e projekteve të tilla për kthim.
- IPVQ-të, UNMIK-u, donatorët dhe akterët e tjerë relevant duhet të sigurojnë funksionimin efikas të Grupeve Punuese Komunale, për shkak se ato paraqesin organet kryesore koordinuese dhe vende (forume) ku mund të diskutohen çështjet përkitazi me kthimin.
- Duhet të bëhen përpjekje të koordinuara për shpërndarjen me kohë dhe në mënyrë të saktë të informatave tek personat e zhvendosur përderisa ato hartohen në kuadër të kornizës informative të UNMIK-ut/UNHCR-së për personat e zhvendosur. Duhet të pranohet në mënyrë të plotë përgjegjësia e mediave kosovare në promovimin e dialogut ndëretnik.

## **PJESA 1: SIGURIA DHE LIRIA E LËVIZJES PËR PAKICAT NË KOSOVË**

### **I. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM**

Kjo periudhë raportuese shënon rënjen e vazhdueshme të shkallës së krimeve me motive etnike, në veçanti, të krimeve të dhunshme të kryera kundër pjesëtarëve të bashkësive të pakicave. Këto shifra duhet të shihen në kontekst të zbritjes së përgjithshme të nivelit të krimeve të rënda në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe KFOR-i ka vazhduar me strategjinë e “ç’fiksimit”, me ç’rast është reduktuar numri i pesonelit të KFOR-it me detyra “fikse”(statike) – siç janë, ruajtja e lokaliteteve trashëgimore apo ofrimi i pikave statike kontrolluese me përdorimin e automjeteve. Edhe gjatë periudhës raportuese, politika e heqjes së trupave “fikse” (të pozicionuara) ka vazhduar me qëllim që ato të jenë të gatshme për operacione të sigurisë të cilat janë më fleksibile, reaguese dhe më pak ndërhyrëse. Strategjia e “ç’fiksimit” gjithashtu zbatohet edhe në uljen permanente të mbrotjes së karvaneve të automjeteve. Edhe pse përcjelljet e autobusëve apo karvaneve nga KFOR-i vazhdojnë të organizohen në regjione të caktuara, siç është rasti me Pejën dhe Prizrenin, respektivisht, orientimi i përgjithshëm i KFOR-it është që të reduktojë përcjelljet për karvanet me automjete, dhe që të ofrojë vetëm sigurinë e vijës(ave) qarkulluese<sup>1</sup>. Kjo strategji është zhvilluar dhe implementuar bashkarisht me policinë e UNMIK-ut, dhe është pjesë e strategjisë së përbashkët të tranzicionit të çështjeve të sigurisë. Strategjia e tranzicionit mëton uljen e profilit të KFOR-it në komunitetin civil, dhe vazhdon me procesin e bartjes së detyrave të sigurisë që i kishte, tek autoritetet civile. Policia e UNMIK-ut në mënyrë graduale është duke zvogëluar shërbimet e përcjelljes, duke lënë që SHPK-ja të marrë përsipër përcjelljet të cilat konsiderohen të domosdoshme.

KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut janë të vetëdijshëm për atë se çdo ndryshim në masat e sigurisë mund të shkaktojë nervozizëm në rradhët e bashkësive të pakicave. Rrjedhimisht këto ndryshime kanë qenë graduale, proporcionale dhe kanë qenë të kombinuara me përpjekjet e angazhimit më të madh të policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së në ofrimin e sigurisë, përmes ndërtimit të besimit dhe përmes kryerjes efikase të detyrave policore. Në këtë kuptim, theks i veçantë i është dhënë edhe organizimit të patrullave etnikisht të përziera të SHPK-së, ndërsa stacioni i parë policor i cili udhëhiqet krejtësisht nga SHPK-ja tani është në funksion në Graçanicë. Vendimet mbi aspektet operative për zbatimin e strategjisë së sigurisë, janë zhvilluar nga brigadat shumëkombëshe të KFOR-it dhe komandave regjionale të policisë së UNMIK-ut. Policia dhe KFOR-i kanë arritur të përshtasin implementimin e strategjisë së tranzicionit në përgjigje të rrethanave lokale të sigurisë, por gjithnjë në kuadër të kornizës së përgjithshme të kalimit prej sigursë ushtarake në atë të sigurisë civile.

Udhëheqësit politik të serbëve të Kosovës, kanë ngritur zërin kundër heqjes së masave fikse të sigurisë nga ana e KFOR-it, dhe e gjithë kjo në kontekst të sulmeve me bombë të cilat kishin dëmtuar dy kisha ortodokse serbe në komunën e Istogut, gjatë natës së 17 nëntorit, menjëherë pas heqjes së masave fikse të mbrojtjes nga ana e KFOR-it. Megjithatë, në rradhët e shumë pjesëtarëve të bashkësive të pakicave, duket se ekziston një kuptim i përgjithshëm mbi logjikën e masave të reviduara të sigurisë, si dhe të pranuarit se siguria e tyre nuk vëhet në pyetje me qasjen e re të zbatuar.

---

<sup>1</sup> Siguria e vijave qarkulluese nënkupton kontrollimin paraprak të rrugës për mundësitë e krëcënimeve duke vëzhguar rrugën dhe pikat strategjike dhe që njësitë për reagim të shpejtë të jenë të gatshme për t’iu përgjigjur shumë shpejtë lajmërimeve të incidenteve përgjatë rrugës.

Pa marrë parasyshë stabilizimin e gjendjes së sigurisë, frika nga ngacmim, frikësimi dhe provokimi ende mbetet pjesë e përditëshmërisë për pjesëtarët e bashkësive të pakicave në tërë Kosovën. Pjesëtarët e grupeve të pakicave, të cilët jetojnë në bashkësitë e përziera apo të cilët dalin nga enklavat e tyre, mund të bëhen shënjestër e sulmeve me granata, zjarrëvënje apo sulmeve fizike, sidomos kundër serbëve, romëve, egjiptasve, ndërsa në shumë raste edhe kundër ashkalinjëve të Kosovës. Hulumtimet e UNHCR-së kanë zbuluar se ngacmimet dhe sulmet në shumicën e rasteve ndërlidhen me çështjet pronësore, dhe kanë për qëllim ose parandalimin e kthimeve ose që pjesëtarët e pakicave që ende jetojnë në vendet gjegjëse, të detyrohen të shesin pronën e vet<sup>2</sup>. Sulmet ndaj grupeve të pakicave mund të rezultojnë gjithashtu edhe si pasojë e konkurrencës për resurset e pranishme tanimë të zvogëluara ekonomike në rrethinën e bashkësisë. Me përjashtim të boshnjakëve të Kosovës në Mitrovicë, gjendja e sigurisë, si për boshnjakët e Kosovës poashtu edhe për goranët e Kosovës dhe bashkësitë e tyre, në përgjithësi është stabilizuar, dhe nuk ka shënuar raste të raportimit të akteve serioze të dhunës dhe nga motivet etnike kundër tyre që nga viti 2001.

Në të gjitha regionet, përveç në Mitrovicë, ekzistojnë instance në të cilat bashkësitë e pakicave mund të shfrytëzojnë transportin publik, psh, autobusin apo hekurudhën. E ashtuquajtura linjë e rregullt private me autobus e cila udhëhiqet nga goranët e Kosovës në relacionin Dragash – Beograd, e cila kalon nëpër një numër komunash me shumicë shqiptare, i tërhyjë gjithashtu edhe udhëtarët serb të Kosovës, dhe deri më tani nuk ka hasur në probleme të sigurisë.

Liria e lëvizjes dallon, si brenda komunave të caktuara, poashtu edhe raport me bashkësitë e ndryshme etnike. Në disa raste ka pasur raportime të shtuara në numër sa i përket incidenteve të sigurisë, siç janë, hedhja e gurëve (kundër kalimtarëve apo automjeteve lëvizëse), ngacmimet gojore, madje edhe sulme fizike kur pjesëtarët e pakicave tani udhëtojnë jashtë vendbanimeve, fshatërave dhe komunave të veta. Në disa raste, përgjigjet e vendosura nga ana e policisë së UNMIK-ut apo SHPK-së, e kanë ndërprerë dhunën.

Sikur incidentet e lehta, ashtu edhe ato të rënda, mbesin të paraportuara, për shkak se viktimat nuk dëshirojnë të tendosin raportet delikate të cilat me popullatën shumicë i kanë ndërtuar dalëngadalë. Ky ngurrim i raportimit të rasteve, shtohet edhe më tej për shkak të mosbesimit ndaj organeve të zbatimit të ligjit, sidomos lidhur me aftësitë dhe gatishmërinë e tyre për mbrojtjen e viktimave në rast të represaljeve të mundshme ndaj tyre<sup>3</sup>. Hulumtimi i ndërmarrë nga ana e UNHCR-së gjatë tetorit të vitit 2002, mbi perceptimet e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve të Kosovës, në lidhje me gjendjen e tyre të sigurisë, tregon për tendencën në rradhët e pjesëtarve të këtyre pakicave, që të mos i raportojnë policisë për incidentet e ngacmimeve dhe frikësimeve<sup>4</sup>. Më tej, edhe në rastet kur pakicat i raportojnë policisë incidentet e sigurisë, këto organe nuk i kryejnë gjithëherë hetimet adekuate<sup>5</sup>. Si rezultat i dinamikës së vërejtur më sipër, aftësitë e policisë për të qenë parandalues, janë të cinguara.

<sup>2</sup> Risitë mbi gjendjen e romëve, ashkalinjëve, egjiptasve, boshnjakëve dhe goranëve të Kosovës, UNHCR Kosovë, janar 2003 (më tutje në tekst “risitë e UNHCR-së janar 2003)

<sup>3</sup> P.sh. në Klinë një familje kishte heshtur kur kryesit e njohur ua kanë plaçkitur shtëpinë e tyre në muajin shtator. Rishtazi një anëtarë mashkull i të njëjtës familje ishte rrahur rëndë nga të njëjtët kryes dhe asnjëri nga këto incidente nuk ishin raportuar në polici.

<sup>4</sup> Kjo tendencë mbizotëron sidomos në rradhët e përafërsisht 400 rom, ashkalinjë dhe egjiptas të cilët jetojnë në kampin e Zitkovcit dhe “Chesmin Lug” në veri të Mitrovicës, ku ndodhin incidente të shpeshta dhe të paraportuara, prej atyre të rrahjeve deri në vjedhje.

<sup>5</sup> Për shembull, në një rast në strehimoren kolektive në Plemetin, Obiliq, në muajin shtator, një serb i Kosovës si dhe tre ashkalinjë, dyshohet se ishin sulmuar nga rojet e sigurisë së KEK-ut diku afër termoelektranës. Policia në mënyrë joadekuate e kishte paraqitur raportin mbi incidentin, dhe si rezultat, nuk ishin zhvilluar hetimet në mënyrë të duhur.

Sa i përket besimit të bashkësive të pakicave në SHPK, OSBE dhe UNHCR kanë konstatuar se kjo drejtpërdrejt varet, parasëgjithash nga angazhimi i tyre me bashkësitë e pakicave, si dhe qasja e tyre proaktive gjatë kryerjes së vizitave të këtyre banorëve por edhe shqyrtimi i ankesave të tyre, se sa nga përpërja etnike e këtij shërbimi. Prania e policëve të SHPK-së me përbërje të pjesëtaëve të pakicave, vetvetiu nuk garanton përmirësimin e gjendjes së sigurisë për këto bashkësi, por as përcjelljen e incidenteve të raportuara. Sidoqoftë, duket se bashkësitë e pakicave dëshirojnë më shumë që të merren me patrullat e SHPK-së me përbërje etnike të përziera se sa me ato me përbërje tërësisht shqiptare.

Njëri prej problemeve të vazhdueshme është edhe ai i inkurajimit të pjesëmarrjes së serbëve të Kosovës në kuadër të SHPK-së; policët serb të SHPK-së shpeheherë gëzojnë repekt nga ana e kolegëve të tyre si dhe nga ana e popullatës shumicë, por mund të mos gëzojnë repekt nga bashkësitë e përkatësisë së tyre. Kjo është e dukshme sidomos në regjionin e Mitrovicës, ku ekziston një rezistencë e vazhdueshme ndaj SHPK-së në rradhët e bashkësisë së serbëve të Kosovës, dhe dëshira për të mbajtur në jetë strukturat paralele apo futur policinë serbe nga Serbi<sup>6</sup>. Për dallim nga kjo, ekziston një shembull i mirë i besimit ndëretnik në rastin e një polici të SHPK-së në Rahovec, i cili i kryen detyrat e rregullta, përfshirë këtu edhe patrullimet nëpër regjionet e shumicës. Ngajshëm me këtë një shqiptar i SHPK-së në regjionin e Prizrenit pa probleme vazhdon të patrullojë nëpër enklavat e këtij regjioni. Edhe një herë, patrullat e përziera të SHPK-së me serbë dhe boshnjakë të Kosovës, janë pritur mirë nga shqiptarët e fshatërave pakicë në komunën e Leposaviqit.

Megjithatë, çfardo lloj mosbesimi ndaj policisë nuk duhet të shihet vetëm si një mosbesim ndaj efikasitetit të SHPK-së, por në mekanizmat e zbatimit të ligjit në përgjithësi. Kjo ka të bëjë sidomos me pakicën serbe të Kosovës në Pejë, të cilët kanë qenë nën shënjestër të një numri incidenteve të sigurisë përkundër pranisë së dukshme të policisë së UNMIK-ut dhe KFOR-it.

Sipas raportimit të bërë në vlerësimin e kaluar, duket se ende ka divergjenca në mes të gjendjes aktuale të sigurisë dhe asaj që perceptohet në disa regjione. Pjesët vijuese do të shqyrtojnë më hollësisht këtë gjendje si dhe perceptimet e regjioneve/enklavave të ndryshme të pakicave në Kosovë.

## **II. PASQYRA REGJIONALE**

### **Regjioni i Prizrenit**

Me përjashtim të Hoqës së Madhe të komunës së Rahovecit (në të cilën ende është në fuqi sigurimi statik i enklavës serbe) të gjitha pikat kontrolluese në regjionin e Prizrenit janë hequr si pjesë e strategjisë së ç'fiksimit të KFOR-it. Kjo strategji është shoqëruar me një fushatë publike të informacionit, e cila theksonte normalizimin e ambientit të sigurisë si dhe bartjen e përgjegjësive mbi sigurinë, në autoritetet policore. Liria e lëvizjes varet nga rrethanat e bashkësisë së caktuar, për shembull, rasti i pakicës turke në Prizren të cilët thuajse tërësisht janë integruar, ndërsa sikur bashkësitë e serbëve dhe romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve në Rahovec ende janë të mbyllura nëpër enklava.

#### *Qyteti i Prizrenit*

Krahas shumicës shqiptare të Kosovës, në regjionin e Prizrenit, jetojnë grupet e pakicave të turqëve, serbëve, romëve, ashkalinjëve, egjiptaseve dhe të boshnjakëve të Kosovës.

<sup>6</sup> Për informacionet plotësuese mbi strukturat paralele, lexo “raportin e OSBE-së mbi strukturat paralele të sigurisë në pjesën veriore të Mitrovicës” të datës 31 maj 2002.

Policët e komuniteteve, në mënyrë sistematike dhe të rregullt, i vizitojnë udhëheqësit e fshatërave për të vlerësuar nevojat e bashkësisë. Pjesëtarët e pakicave përfaqësohen në mënyrë të denjë në patrullat policore të SHPK-së, e sidomos në regjionin të cilin e mbulon nënstacioni policor i Reçanit (i banuar me bashkësinë boshnjake të Kosovës) dhe patrullimet e SHPK-së në përpërje të përzier janë ndodhi të zakonshme. Policët e SHPK-së nga të gjitha etnitetet, tërësisht janë të integruar në të gjitha funksionet policore, përfshirë këtu edhe zhvillimin e hetimeve. Në vet qytetin e Prizrenit, operojnë më pakë patrulla të përziera, por të gjithë policët e SHPK-së nga të gjitha grupet e pakicave, me përjashtim të serbëve të Kosovës, tërësisht janë të integruara në veprimtaritë tjera policore. Rekrutimi dhe vendosja e policëve nga pakicat në SHPK-në në Prizren, kontribon drejt përhapjes së shtrirjes së SHPK-së nëpër bashkësi, dhe ndihmon në inkurajimin e klimës së mirëbesimit në mesin e grupeve të tyre pakicave.

Gjendja e sigurisë për pjesëtarët e bashkësisë së boshnjakëve të Kosovës në qytetin e Prizrenit, ka vazhduar të përmirësohet gjatë periudhës raportuese. Ngjajshëm, banorët turk të qytetit të Prizrenit duket se janë integruar relativisht mirë me shumicën, dhe se shqetësimet e tyre mbi sigurinë më shumë kanë të bëjnë me shkallën e kriminalitetit të përgjithshëm, se sa me incidentet me motive etnike. Bashkësia turke e Kosovës, praninë e policëve turk në kuadër të SHPK-ës e sheh si një ngjarje pozitive dhe shtytëse e mirëbesimit. Pjesëtarët e bashkësisë së REA-ve (më tuje në tekst, romëve, egjiptasve dhe ashkalinjëve) të qytetit të Prizrenit gjithashtu theksojnë se gjendja e përgjithshme e sigurisë është përmirësuar. Megjithatë, prania e policëve nga këto grupe të pakicave në kuadër të SHPK-së nuk është perceptuar si faktorë kryesorë i garantimit të sigurisë së tyre, dhe kjo bashkësi vazhdon të shikojë praninë e KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut si çështje kryesore.

Bashkësitë e boshnjakëve të Kosovës nga Lugina e Zhupës, në afërsi të Prizrenit, gjendjen e përgjithshme të sigurisë e përshkruajnë si të përmirësuar. Prania e policëve boshnjakë në nënstacionin policor të Reçanit në Luginën e Zhupës, e ka rritur besueshmërinë mbi sigurinë e atij lokaliteti. Ky fakt gjithashtu ka ofruar më shumë siguri se policia do të hetojë në mënyrë efektive veprat e kryera kundër tyre. Mirëpo megjithatë, ekziston ndjenja e ngurrimit në mesin e pjesëtarëve të bashkësisë boshnjake të Luginës së Zhupës për të lëvizur nëpër rajonet e dominuara nga bashkësia shqiptare e Kosovës, sidomos nëse të parët nuk e flasin gjuhën shqipe.

### *Dragash*

Shumica e popullatës gorane të Kosovës në regjionin e Prizrenit jetojnë në komunën e Dragashit. Mundësitë e lëvizjes së lirë të goranëve janë të ngjajshme me ato të boshnjakëve të Luginës së Zhupës, respektivisht, ata të cilët e flasin gjuhën shqipe janë të gatshëm të udhëtojnë nëpër Kosovë, ndërsa ata të cilët mund të komunikojnë vetëm në gjuhën serbokroate, këto mundësi i kanë më të kufizuara. Bashkësia e goranëve të Kosovës ka mendim kritik ndaj dështimeve të policisë së UNMIK-ut për zgjidhjen e krimeve të cilat e kanë prekur popullatën lokale<sup>7</sup>. Policia e komuniteteve vepron në kuadër të bashkësisë së goranëve dhe për afërsisht gjysma e policëve të SHPK-së të stacionuar në Dragash janë goranë etnik të Kosovës. Struktura hierarkike e bashkësisë gorane nënkupton se shpeshherë krimet nuk paraqiten nga vet viktima, por përmes ndërmjetësve, me ç'rast rritet mundësia e komunikimit të gabuar dhe e uljes së efikasitetit të hulumtimeve nga ana e policisë.

---

<sup>7</sup> Një shqetësim i vazhdueshëm i goranëve të Kosovës shfaqet si rrjedhojë e vjedhjeve tejkufitare të bagëtisë, sanës dhe drunjëve për ndezje. Aq më tepër, pas një plaçkitjeje të armatosur me 24 dhjetor 2002, dhe vrasjes së një mashkulli goran me 31 dhjetor 2002, përfaqësuesit politik të goranëve në Dragash, kishin organizuar një varg demonstratash për të ngritur zërin e tyre mbi gjendjen e sigurisë

### *Rahovec*

Periudha raportuese ka parë sulme të përsëritura të zjarrëvënjes ndaj disa shtëpive në pronësi të serbëve të Kosovës në komunën e Rahovecit. Ndonëse këto shtëpi nuk ishin të banuara në kohën e sulmeve, incidentet e përsëritura bëjnë fare pakë që të përmirësohet perceptimi i bashkësisë serbe të Kosovës mbi sigurinë. Kjo gjithashtu e ulë besueshmërinë e bashkësisë në fjalë mbi efikasitetin e policisë së UNMIK-ut apo të SHPK-së dhe të rolit të tyre si garantues të sigurisë së tyre. Por, bashkësia serbe e Kosovës duket se heziton të bashkëpunojë me hetimet policore, që pjesërisht rezulton nga fakti se në Rahovec është i stacionuar vetëm një polic serb i Kosovës. Për këtë shkak, policia ka shprehur qëllimin e tyre që të transferojnë më shumë policë serb të Kosovës nga rrethina dhe që këta të inkuadrohen në patrullat e përziera me policët shqiptarë të Kosovës në Rahovec dhe me këtë të ngritet besueshmëria në paanësinë dhe efikasitetin e forcës policore.

Ndonëse gjendja e sigurisë në Rahovec është përmirësuar, dhe policia është duke punuar drejt përmirësimit të shkallës së besueshmërisë, perceptimi i bashkësisë serbe mbi sigurinë e tyre vazhdon të dominohet nga frika e ngjarjeve të kaluara. Në pikëpamje të frikës së përmendur, mendimi mbizotërues i bashkësisë serbe të Rahovecit është se, vetëm KFOR-i mund të ofrojë një ambient të mbrojtur dhe të sigurtë.

Në pjesët rurale të komunës së Rahovecit, popullata e REA-ve mund të lëvizë relativisht lirshëm dhe pa probleme të sigurisë. Por në pjesën e poshtme të Rahovecit, bashkësitë e REA-ve vazhdojnë të përjetojnë ngacmime.

### **Regjioni i Pejës**

Me 10 dhjetor 2002, autobusi i përcjellur nga KFOR-i dhe i cili bartëte një grup të pensionerëve serbë të Kosovës, nga fshati i të kthyerve të organizuar në Osojan, ishte sulmuar dhe mbuluar me gurë dhe kokteje të Molotovit, menjëherë pas ardhjes në ndërtesën komunale të Pejës. Pensionerët kishin për qëllim të regjistroheshin në skemën e re pensionale të Kosovës. Një turmë e shqiptarëve të Kosovës, përafërsisht disa qindra sosh (të cilët kishin marrë pjesë në një tubim politik në Pejë në të njëjtën ditë) ishte mbledhur për rreth ndërtesës së komunës derisa pensionerët ishin brenda dhe KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut u desht t'i shpërndajë ata me forcë. Në fund pensionerët arritën që me përcjellje të kthehen në Osojan.

Liria e lëvizjes, veçanërisht për bashkësinë e serbëve të Kosovës, mbetet problematike deh pjesëtarët e kësaj pakice shprehen se siguria e tyre mund të garantohet vetëm me mbrojtje të përhershme nga KFOR-i, si brenda në fshatërat e tyre, poashtu edhe gjatë lëvizjes së tyre jashtë. Kjo bindje ishte forcuar edhe më tej pas incidenteve të profilit të lartë të sipërpërmendura, por gjithashtu duhet të shqyrtohet në kontekst të rritjes së përgjithshme të shkallës së krimeve të dhunshme (pa motive etnike) në regjionin e Pejës.

Edhe pse gjendja e sigurisë për bashkësitë e REA-ve të Kosovës është stabilizuar edhe gjatë periudhës raportuese, ata ende janë objekt i ngacmimeve dhe sulmeve, siç janë: vjedhjet e organizara të bagëtisë, vjedhjet, detyrimet, abuzimet seksuale, zjarrëvënjet dhe rrahjet. Shumë nga këto incidente mbesin të paparaqitura, për shkak se viktimat frikohen nga represaljet dhe nuk dëshirojnë të prishin raportet e brishta të cilat kanë arritur t'i krijojnë me popullatën shumicë. Në të vërtetë ka instanca kur ngacmimet e raportuar kanë rezultuar me represalje, duke treguar kështu shenja të pandëshkueshmërisë së dhunës së ushtruar ndaj bashkësive të këtyre pakicave.

Mirëpo, përderisa serbët e regjionit të Pejës në mënyrë strikte janë të kufizuar vetëm në bashkësitë e tyre dhe për udhëtimet jashtë këtyre bashkësive kërkojnë përcjelljen e KFOR-it, në anën tjetër boshnjakët e Kosovës nga ky regjion (dhe deri në një masë të caktuar edhe REA-ve)



duket se i janë kthyer normalitetit gjatë lëvizjeve dhe udhëtimeve. Këto bashkësi i kanë mbajtur lidhjet e ngushta tradicionale si të natyrës sociale por edhe ekonomike me Malin e Zi, prandaj pamundësia që të udhëtojnë lirshëm në pjesët tjera të Kosovës, nuk ka ndikuar shumë negativisht. Mirëpo, të folurit e rrjedhëshëm të gjuhës shqipe, prapë është një prej faktorëve të rëndësishëm të lirisë së lëvizjes, përbrenda dhe jashtë regjionit në fjalë.

#### *Lugina e Osojanit, Biqë dhe Grapc*

Në regjionin e Pejës janë dy rajone në të cilat janë realizuar kthimet e organizuara të serbëve të Kosovës – respektivisht ai i Luginës së Osojanit të komunës së Istogut dhe fshatërat fqinje të Biqës dhe Grapcit të komunës së Klinës. Gjendja e sigurisë në këto lokalitete është stabile por shumë e varur nga prania e KFOR-it. Edhe pse një pikë kontrolluese e KFOR-it është hequr, pikat tjera vazhdojnë të ekzistojnë në skajet e Luginës së Osojanit, ndërsa patrullat e KFOR-it operojnë 24 orë pandërprerë.

Për dallim nga Lugina e Osojanit, në Biqë dhe Grapc, KFOR-i nuk ka pika fikse të kontrollit. Por, KFOR-i është aty i pranishëm në mënyrë permanente për shkak të afërsisë së ngushtë së këtyre fshatrave me vendbanimet e shqiptarëve të Kosovës dhe për shkak të frikës së bashkësisë serbe të Kosovës për sulmet.

Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja gjithashtu patrollojnë në këto fshatra disa herë në ditë, por nuk kanë nënstacione policore në asnjërën prej tyre. Mirëpo, policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja e kanë një “kontejner” zyre të përkohëshme në Biqë dhe punojnë çdo ditë prej orës 9 deri në 12. Edhe pse pjesëtarët e bashkësive të pakicave në përgjithësi duket se besojnë se policia e UNMIK-ut dhe e SHPK-së ju përgjigjen kërkesave të tyre për ndihmë, ata besojnë se, në disa raste policisë i mungojnë resurset dhe vendosmëria për të ofruar një siguri apo garancione efikase për lirinë e lëvizjes.

#### *Gorazhdevc*

Enklave e serbëve të Kosovës në Gorazhdevc vazhdon të mbrohet nga pikat kontrolluese të KFOR-it dhe nga patrullat e rregullta të këtyre të fundit. Por, me 29 gusht, përkundër pranisë së policisë së UNMIK-ut një grup prej gjashtë serbëve të Kosovës kishin hasur në gjuajtje të zgjatura me armë të vogla të zjarrit gjatë prerjes së malit. Ky incident shkakton shqetësime të posaçme duke pasur parasyshë paaftësinë e KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut që të ofrojnë mbrojtje dhe parandalim efikas. Fshatarët gjithashtu kishin përjetuar ngacmime të vazhdueshme dhe hedhje të gurëve, por gjithashtu kanë raportuar për kalimin e kundërligjëm nëpër arat e tyre.

### **Regjioni i Gjilanit**

#### *Qyteti i Gjilanit*

Numri i sulmeve të raportuara dhe të drejtuara kundër pakicave në Gjilan, ka rënë gjatë periudhës raportuese. Megjithatë, vazhdojnë të ndodhin incidente të rënda. Në një rast një grua rome e Kosovës, ishte lënduar me rastin e hedhjes së një granate në shtëpinë e saj. Gjithashtu në shtëpinë e një të kthyeri është gjetur një granatë e dorës e pashpërthyer, dhe e njëjta ka shpërthyer në të njëjtën shtëpi pas disa muajve më vonë.

Shembujt e ngacmimeve jo të rënda, provokimeve dhe abuzimeve vazhdojnë të ndodhin, por edhe raportimi i rasteve duket se është në rënjë. Popullata serbe e Kosovës në qytetin e Gjilanit pranon se janë bërë përmirësime në gjendjen e përgjithshme të sigurisë së tyre, sidomos sa i përket lirisë

së lëvizjes dhe nismave për tregëti<sup>8</sup>. Megjithatë ata i janë ankuar OSBE-së gjithashtu se shohin pakë patrulla të policisë nëpër lokalitetet tjera, por në çdo rast ata ngurrojnë që t'i raportojnë krimet para policëve shqiptarë të SHPK-së të cilët punojnë në stacionin policor të Gjilanit.

Shumica e serbëve të Kosovës në Gjilan, si këmbësorë lëvizin në rrugën e Prishtinës. Familjet serbe të cilat jetojnë në periferi të qytetit kryesisht lëvizin gjatë ditëve të tregut – të marteve dhe enjtëve. Lëvizja e automjeteve, madje edhe me tabelat e regjistrimit të Jugosllavisë, është mjaftë e lirëshme e sidomos gjatë orëve të ditës kur këto automjete lëvizin për në komunat fqinje apo matanë në Serbi. Shumica e serbëve të Gjilanit i kanë regjistruar automjetet e tyre me tabelat KS të regjistrimit dhe kjo ka shtuar shkallën e lëvizjes së lirë. Madje, popullata lokale serbe e qytetit ka filluar të shfrytëzojë edhe shërbimet taksi të udhëhequra nga shqiptarët për të udhëtuar nëpër qytet por edhe nëpër fshatrat fqinje e sidomos për në Shillovë.

Në një fshat shumë afër Gjilanit, në Makresh të Epërm, banorët e këtij fshati kanë deklaruar se gjendja e sigurisë është përmirësuar. Ata kanë mundësi dhe janë të gatshëm të udhëtojnë për në fshatrat fqinje të serbëve, për në Serbi dhe për në qytetin e Gjilan për tregëti. Në fshatrat e përziera si në Livoç të Epërm, serbët dhe shqiptarët aty kanë krijuar dialog dhe bashkëpunim formal dhe joformal, dhe punojnë bashkërisht në projektin e tyre të furnizimit me ujë, dhe lidhur me këtë, pa probleme të raportuara.

Sidoçoft, pjesëtarët e bashkësive më tepër të izoluar, siç është rasti me Paralloven, hezitojnë të largohen përtej fshatrave të tyre dhe gjithashtu më shpesh raportojnë për rastet e incidenteve të ngacmimeve më të lehta. Situata unike e cila ekziston në fshatin Cërnice, ndikon në banorët të cilët kanë përjësuar një varg incidentesh të sigurisë si dhe sulme vdekjeprurëse, dhe lëvizja e tyre zhvillohet vetëm gjatë orëve të ditës, dhe madje edhe atëherë, me një kujdes të madh.

Në vendbanimet tjera të pakicave, fshatarët duket se janë të kënaqur me shkallën e pranisë së policisë dhe ndërveprimit të tyre me bashkësinë. Njësitë e policisë për komunitete në Gjilan në mënyrë të rregullt i viziton lokalitetet e pakicave në regjion dhe ka krijuar një ekip të veçantë për t'u marrur me çështjet e pakicave. Ky ekip, në mes tjerash, ka nisur Projektin e vëzhgimit të fqinjësisë në lagjen e romëve në qytetin e Gjilanit, dhe ka realizuar një projekt të ngritjes së vetëdijes i cili kishte për qëllim njoftimin e nxënësve nga bashkësia serbe e Kosovës, me punën e policisë. Megjithatë, bashkësia e pakicës serbe vazhdon të shprehë paknaqësinë e saj mbi mungesën e rezultateve të hulumtimeve policore të krimeve të kryera kundër tyre.

#### *Novobërdë*

Gjatë periudhës të cilën e mbulon ky raport, në Novobërdë nuk kanë ndodhur incidente të rënda të sigurisë, dhe megjithë tendosje ndëretnike ka qenë e dukshme gjatë nëntorit të vitit 2002 pas suksesit të serbëve të Kosovës në zgjedhjet komunale, kjo komunë është e qetë. KFOR-i duket se e ka fituar besimin dhe se shqetësimet e shtruar më shumë kanë të bëjnë me qasjen në shërbimet publike se sa që kanë të bëjnë me sigurinë fizike. Sidoçoftë, reduktimi i pranisë së dukshme të KFOR-it, e ka dobësuar edhe perceptimin mbi sigurinë e fshatarëve në vendet siç janë Bostani dhe Jasenoviku. Udhëtimet jashtë fshatrave të pakicave janë shtuar paksa, por ende mbetet i kufizuar vetëm në udhëtimet e nevojshme, dhe kryesisht për në Gjilan apo Graçanicë. Automjetet private shfrytëzohen për udhëtime më të shkurta, ndërsa autobusët e UNHCR-së për rrugë më të largëta. Në shumë raste autobusët janë e vetmja alternativë sikur që është rasti me popullatën e Novobërdës e cila është e varfër dhe nuk posedon me automjete personale. Përkundër lëvizjes së

---

<sup>8</sup> Këto nisma të tregtisë janë organizuar nga UNHCR-ja. Banorët serb të Kosovës nga rrethina e Gjilanit barten me autobus për në qytetin e Gjilanit gjatë ditës së tregut. KFOR-i nuk e bën përcjellje, por e ka shtuar praninë gjatë këtyre ngjarjeve.

shtuar jashtë fshatrave, frika nga frikësimet e lehta ende ekziston dhe çdo vendim për të udhëtuar varet nga rreziku i llogaritur.

Grupet e pakicave duket se janë të knaquara me praninë e policisë nëpër fshatra, edhe pse ekziston paknaqësia për rastet të cilat kanë mbetur të pazgjidhura. SHPK-ja ka në veprim patrullat etnikisht të përziera, dhe fshatarët nuk kanë raportuar për vështirësi në komunikimin me ta apo ndonjë problem tjetër. Mirëpo, patrullimet policore bëhen vetëm me automjete dhe fshatarët raportojnë se policët rrallë herë ndalen për të ndërvepuar në mënyrë jozyrtare me popullatën. Për shkak se fshatarët nuk janë të lidhur me rrjetin telefonik dhe se mbulimi me rrjetin e telefonisë mobile është gjithashtu i varfër, kontaktimi i policisë është i vështirë. Popullata serbe e Bostanit ka raportuar gjithashtu se mbyllja e nënstacionit policor në Novobërdë i ka dobësuar ndjenjat e sigurisë për ta. Mirëpo, kah fundi i periudhës raportuese, prania e përhershme mbahet përmes “Zyrës raportuese të policisë” në Novobërdë.

### *Kamenicë*

Në qytetin e Kamenicës, popullata serbe e Kosovës tenton të mos largohet nga pjesa serbe e qytetit, kryesisht për shkak të frikës ndaj abuzimeve dhe frikësimeve. Por, serbët frekuentojnë në tregun etnikisht të përzier dhe nëpër shitoret e shqiptarëve të Kosovës në fqinjësi të katër lokaliteteve.

Bashkësitë e pakicave në komunën e Kamenicës mbetet e izoluar edhe pse ekziston një liri e kufizuar e lëvizjes. Banorët serb nëpër shumicën e fshatrave të komunës mund të udhëtojnë për në Kamenicë, Gjilan dhe Serbi. Këto udhëtime kryesisht bëhen gjatë orëve të ditës me përdorim të automjeteve pa përcjellje apo transportit publik, edhe pse KFOR-i kishte informuar OSBE-në se ende organizon përcjelljen për autobusët shkollorë të cilët udhëtojnë në mes të Kamenicës dhe një fshatrave për rreth.

Në përgjithësi banorët e bashkësive të vogla apo të atyre të cilët jetojnë nëpër skajet e fshatrave janë më të ndjeshmit ndaj frikësimeve dhe ngacmimeve. Mirëpo, brenda fshatrave, bashkësitë e pakicave ndihen relativisht të sigurta dhe mund t'i punojnë fushat e tyre.

Por fshati serb Kolloleq, i cili është i rrethuar nga venbanimet shqiptare, paraqet një përjashtim të dukshëm. Këtu shkalla e frikësimeve dhe ngacmimeve është e lartë dhe banorët e Kolloleqit frikohen t'i punojnë arat e tyre apo të udhëtojnë jashtë fshatit. Gjithashtu fshati fqinjë i serbëve Çarakovc, më heret i banuar nga 47 familje serbe të Kosovës gjatë vitit 2000, në tetor të vitit 2002 është braktisur tërësisht nga banori i fundit. Familjet e larguara kishin thënë se arsyeja kryesore për largimin e tyre ishte mungesa e sigurisë fizike, me shqetësimin e veçantë mbi praninë e ultë policore në atë hapsirë.<sup>9</sup> Largime të ngjajshme janë raportuar edhe në Kolloleq. Migrimi në këtë rajon është më i lehtë për shkak të afërsisë me vijën administrative kufitare me Serbinë.<sup>10</sup>

Përkundër shkallës së lartë të frikësimeve, incidenti më i rëndë gjatë periudhës raportuese kishte të bënte me një sulm me granatë në një shtëpi serbe në Kolloleq me 27 qershor 2002. Ky sulm i kishte shkaktuar lëndime të vogla pronarit të asajë pasurie, dhe bën pjesë në vargun e sulmeve ndaj të njëjtës pronë me granata dore të cilat kanë ndodhur me 12 dhe 13 shtator 2002. Me 22

<sup>9</sup> Duhet të përmendet se rinia e këtij fshati gjatë dekadave është larguar për shkak të depresionit ekonomik në këtë vend ndërsa shumica e tyre është larguar në vitin 1999, duke i lënë prindërit e moshuar të tyre.

<sup>10</sup> Fshatarët serbë kanë shqetësime mbi ekzistencën e tyre për shkak se nuk janë duke pranuar më ndihma në ushqim apo ndihmë sociale. Por, janë përmendur edhe shqetësimet e tyre mbi sigurinë fizike për shkak se fshatarët nuk ndihen të sigurtë që t'i punojnë arat e tyre dhe se bagëtia iu është vjedhur.

nëntor 2002, në sulmin më të ri, ishte hudhur një koktej i Mollotovit në grumbullin e drunjëve për nderzje jashtë pronës së njëjtë.

#### *Viti*

Serbët dhe kroatët e Kosovës udhëtojnë jashtë fshatrave të veta më shpeshë, por vazhdojnë të jenë objekt i sharjeve, ngacmimeve dhe frikësimeve. Posaçërisht autobusët të cilët bartin nxënësit serbë, nganjëherë gjuhen me gurë nga të miturit shqiptarë. Në lidhje me këto incidente, KFOR-i ka nisur një fushatë parandaluese të ngritjes së vetëdijes, e cila u ishte drejtuar prindërve të fëmijëve të involvuar.

Në qytetin e Vitisë, ndonëse gjendja e sigurisë nuk është përmirësuar dukshëm, pjesëtarët e pakicave demonstrojnë vendosmërinë e tyre për të ushtruar lirinë e tyre të lëvizjes. Si një pasqyrë e kësaj vendosmërie, udhëheqësit e bashkësive të fshatrave të pakiave të rrethinës së Vitisë kishin kërkuar që takimet javore me KFOR-in dhe policinë e UNMIK-ut të mbahen në Viti dhe jo në fshatin serb Vërbovc.

Pakica kroate e cila banon në një numrë fshatrasht të përiziera në rajonin e Vitisë, raporton ndryshime të rëndësishme të gjendjes së sigurisë. Edhapse ende ndodhin frikësimet dhe provokimet e shkallës së ultë, ata ndërveprojnë me shqiptarët fqinjë dhe lëvizin më lirshëm nëpër fshatrat e tyre dhe për në Viti.

Në fshatin serb në Kllokot, ka pasur një varg rastesh të incidenteve të dhunshme të cilat kanë ndikuar në pjesëtarët e kësaj bashkësie. Kjo përfshinë shkatërrimin apo dëmtimin e disa shtëpive serbe si rezultat i shpërthimeve të 31 korrikut 2002 së bashku me shpërthimin e minës tokësore me 15 tetor 2002 e cila kishte vrarë një grua serbe 43 vjeçare. Krahas kësaj, me 11 nëntor 2002, ishte zbuluar një minë tjetër tokësore në fushën afër asaj në të cilën kishte ndodhur shpërthimi vdekjeprurës.

Perceptimi i përgjithshëm i bashkësisë së pakicës mbi SHPK-në në rajonin e Vitisë është mjaft i dobët. Kjo nga fakti se policët e SHPK-së në këtë rajon janë kryesisht shqiptarë dhe gjithashtu ata konsiderohen si të papërvojë dhe për këtë më pakë efikas. Krahas kësaj, serbët dhe kroatët të cilët kanë telefonuar në stacionin policor të Vitisë, i kanë deklaruar OSBE-së se në disa raste polici shqiptar i cili i ishte përgjigjur thirrjes, kishte refuzuar të flasë serbo-kroatisht dhe e ka mbyllur telefonin. Si rezultat i kësaj, më shpesh krimet i raportohen KFOR-it se sa policisë, dhe shumë incidente të vogla as që raportohen fare.

Sidoçoftë patrullimet policore vazhdojnë të kalojnë nëpër rajonet e pakicave disa herë në ditë, dhe u përgjigjen thirrjeve të bëra. Në përgjithësi policët komunikojnë mirë me popullatën lokale edhapse banorët e fshatrave të Mogilës dhe Letincës raportojnë se policia thejeshtë vetëm kalon atypari pa komunikuar me popullatën. Bashkësia e serbëve beson se heqja e pikave statike të kontrollit të KFORit vetvetiu nuk e ngritur kërcënimin për siguri por heqja e tyre e ka zvogëluar shenjën e dukshme brojtëse dhe për këtë edhe ulur besueshmërinë e serbëve ndaj sigurisë së tyre.

#### *Ferizaj*

Në qytetin Ferizaj, ekziston një popullatë e madhe e ashkalinjëve të cilët jetojnë nëpër disa lagje dhe në fshatin Dubravë. Kjo bashkësi ka bërë një përparim të madh drejt integritit në strukturat komunale. Popullata e romëve është e koncentruar në dy lagje në qytetin e Ferizajit, dhe në mënyrë të konsiderueshme është pakësuar që nga koha e konfliktit. Ata pjesëtarë të bashkësisë së romëve të cilët nuk e flasin gjuhën shqipe gjinden nën shënjestër të frikësimeve. Mirëpo përderisa problemet e sigurisë për REA-ët janë relativisht të vogla, bashkësia serbe në Ferizaj gjindet nën mbrojtje permanente të KFOR-it dhe individët nuk mund dhe nuk janë të gatshëm të largohen pa

përcjellje, për shkak se mund të shndërrohen në objekt të ngacmimit. Sidoqoftë pjesëtarët e bashkësisë serbe mund të udhëtojnë pa përcjellje për në Shërpcë dhe gjithashtu të shkojnë marrin rrugë për në tregun e Gjilanit.

Pjesëtarët e bashkësisë boshnjake dhe gorane të Kosovës nuk janë të gatshëm të flasin publikisht gjuhën e vet (serbo-kroate) dhe për këtë arsye, anëtarët e familjeve të cilët nuk janë të rrjedhshëm në gjuhën shqipe nuk mund të kenë qasje në shërbimet elementare, përshtirë këtu edhe shëndetësin<sup>11</sup>. Këta boshnjakë dhe goranë më shumë udhëtojnë nëpër rajonet e shumicës gorane në Dragash, duke shfrytëzuar automjetet private.

### *Shtërpcë*

Komuna e Shtërpcës përafërsisht i ka 70% serbë dhe 30% shqiptarë të Kosovës. Ekziston edhe një popullatë e vogël e romëve. Pjesëtarët bashkësisë shqiptare i kanë disa probleme të sigurisë dhe mund të udhëtojnë lirisht nëpër rajonet serbe. Edhe pse bashkësia serbe kishte rezistuar ndaj kthimit të 26 të zhvendosurve shqiptarë në fshatin Biti e Ultë gjatë muajit maj të vitit 2002, pas kthimit të tyre nuk ka pasur incidente të dhunës.

Banorët serb të Shtërpces ende hezitojnë të udhëtojnë privatisht jashtë enklavës, dhe KFOR-i vazhdon të pranojë kërkesë për përcjellje. KFOR-i në muajin korrik 2002, kishte ndërprerë përcjelljen e karvaneve të serbëve nga Shtërpca prandaj serbët kishin filluar marrin përsipër rrezikun duke dalur nga enklava për udhëtime brenda apo jashtë Kosovës<sup>12</sup>.

### **Regjioni i Mitrovicës**

Problemet e sigurisë për pakicat mbeten të mëdha në një sërë lokalitetesh, mirëpo në përgjithësi situata është e qetë me disa incidente të vogla të sigurisë të raportuara kohëpaskohe. Shqetësimet fillestare në mesin e pjesëtarëve të bashkësive të pakicave sa i përket heqjes së pikave kontrolluese statike të KFOR-it duket se janë zbutur paksa. Në vetë qytetin e Mitrovicës, KFOR-i ka zvogëluar masat e sigurisë në “zonën e mirëbesimit”,<sup>13</sup> duke e hequr orën policore më 10 dhjetor 2002, dhe duke larguar tri pika kontrolluese të saj në të dyja anët e lumit Ibër. SHPK-ja për momentin është duke patrolluar nëpër pjesën tjetër të zonës së mirëbesimit. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe raportuese, policët e SHPK-së ishin vendosur edhe në pjesën veriore të Mitrovicës për herë të parë.

Nëpër disa zona, sikurse Gojbulë (komuna e Vushtrrisë) KFOR-i beson se strategjia e re pafiksuar ka ndihmuar në përmirësimin e gjendjes së sigurisë për disa pakica, për shkak se tani patrullat mobile janë në gjendje të mbulojnë tërë territorin përkatës dhe të reagojnë në rast të incidenteve që mund të ndoshin në terren. Sikur rregull e përgjithshme KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut duket të kenë diskutuar masat e sigurisë me bashkësitë e pakicave. KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut janë duke marrur pjesë rregullisht nëpër mbledhjet me bashkësitë e pakicave ku diskutohen çështjet e sigurisë, lirisë së lëvizjeve dhe çështjet e tjera. Krahas heqjes së pikave kontrolluese statike, KFOR-i është duke zbatuar një strategji të nivelit të ulët të paraqitjes së tyre, duke ndaluar apo zvogëluar përcjelljet e profilit të lartë të sigurisë.

---

<sup>11</sup> Ekizton vetëm një klinkë private shëndetësore në Ferizaj e cila i paranon pacientët jo-shqiptarë dhe të cilës i besojnë goranët dhe boshnjakët.

<sup>12</sup> KFOR-i përmes një kontrolli 24 orësh, të herëpashershëm, ka zbuluar se serbët e Kosovës udhëtojnë pa përcjellje për në Kaçanik, Ferizaj, Gjilan dhe vende tjera. Vetëm linja e autobusit Shtërpcë – Beograd që shkon nëpër portën 3 ende përcjelllet, ndërsa lëvizjet tjera për në Serbi përmes portës 5, për në Han të Elezit dhe Shkup, për në Gjilan tani mbrohen vetëm përmes sigurisë rajonale.

<sup>13</sup> ‘Zona e mirëbesimit’ është një rrip ndërmjet pjesës veriore dhe jugore të qytetit të Mitrovicës, e cila është kontrolluar në mënyrë strikte nga ana e KFOR-it.

### *Mitrovicë*

Komuna e Mitrovicës ngërthen në veti 49 fshatra. Vetë qyteti dhe du fshatra tjerë janë të përziera etnikisht, përderisa fshatrat tjerë kryesisht përbëhen nga shqiptarët e Kosovës. Që nga viti 1999 qyteti është i ndarë përgjatë lumit Ibër. Në pjesën jugore të saj, popullata përbëhet kryesisht nga shqiptarët e Kosovës, përderisa popullata e pjesës veriore përbëhet kryesisht nga serbët e Kosovës, duke përfshirë atyketu edhe shqiptarët e Kosovës, boshnjakët dhe romët. Pjesa e mbetur e shqiptarëve të Kosovës jetojnë tek Tri Kullat, Gushac, Suhodolli i Ulët dhe Mahalla e Boshnjakëve (boshnjakë/shqiptarë të Kosovës). Pjesa më e madhe e romëve të cilët kanë jetuar në pjesën jugore të qytetit tani jetojnë në qendrën kolektive në Lugun e Çesmit e cila gjendet në veri të qytetit apo në Depon e Romëve në Leposaviq. Gjithashtu kemi edhe turq të Kosovës të cilët jetojnë në të dyja anët e lumit. Mungesa e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes ende mbetet një pengesë e madhe në vendosjen e jetës normale në qytet. Pikat kontrolluese në rrugën kryesore në Suhodollin e Ulët ishin larguar ndërmjet 18 dhe 28 nëntorit, përderisa KFOR-i vazhdon të kryejë patrulla në këmbë në këtë zonë.<sup>14</sup>

### *Svinjarë*

Gjendja e sigurisë për serbët e Kosovës në Svinjarë mbetet e pandryshuar gjatë periudhës raportuese dhe nga ana e policisë përshkruhet si e qetë. Objektet e policisë në Svinjarë janë të thjeshta dhe atyre ju mungojnë pajisjet që e bëjnë atë vend të përshtatshëm për punë, dhe vendimi është marrë për të mbyllur atë objekt në të ardhmen e afërt, përderisa siguria duhet të ofrohet nëpërmjet të patrullave mobile. KFOR-i raporton mbi një bashkëpunim të mirë me policinë e UNMIK-ut pas heqjes së pikave kontrolluese të KFOR-it në nëntor të vitit 2002. KFOR-i vazhdon të kryejë patrulla si gjatë ditës ashtu edhe gjatë natës. Bashkësia serbe duket të ketë kuptuar dhe pranuar arsyeshmërinë e arranzhimeve të reja të sigurisë, dhe mbetet e kënaqur për sigurinë dhe mbrojtjen e re e cila u ofrohet. Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i vazhdon të ofrojë përcjellje të sigurisë për autobusët të cilët dërgojnë fëmijët serbë të Kosovës nga Svinjarë për në shkollë e cila ndoshet në pjesën veriore të Mitrovicës.

### *Vushtrri*

Në Vushtrri shumica e popullatës janë shqiptarë të Kosovës, me disa zona aty këtu të banuara me bashkësitë e pakicave serbe dhe të ashkalinjëve. Komuna në fjalë përbëhet nga 66 fshatra, 61 prej të cilave janë të banuara me shqiptarë dhe 5 të banuara me serb. Bashkësia e vogël e ashkalinjëve është e përqëndruar në afërsi të qendrës së qytetit. Pjesa e mbetur e serbëve jetojnë në pesë enklava të ndryshme në Gojbulë, Priluzhë, Miraqë, Sllatinë, Gracë dhe në fshatin e përzier etnikisht të Banjskës. Një sërë raportimesh mbi ngacmimet dhe sulmet kundër pjesëtarëve të bashkësisë serbe janë bërë gjatë tetë muajve të fundit.<sup>15</sup> Bashkësia e ashkalinjëve konsideron se gjendja e sigurisë është e mjerë duke pohuar se nuk është bërë ndonjë përmirësim i gjendjes së sigurisë gjatë 6 muajve të fundit edhe pse shkalla e vetëdijes në mesin e pjesëtarëve të KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut është rritur.<sup>16</sup> Policët e UNMIK-ut kryejnë patrulla, mirëpo aftësia për

<sup>14</sup> Në javët të cilat rezultuan me heqjen e pikave kontrolluese, 150 serbë ngritën bllokada nëpër rrugë në Suhodolli i Eprëm si shenjë proteste kundër siç pohohet ngacmimit të një gruaje serbe nga shqiptarët e Kosovës. Megjithatë, edhe pse situata ishte tejet e tensionuar gjatë kohës kur kishte ndodhur ky incident, KFOR-i komunikoi me banorët e atjeshëm për t'ju shpjeguar arranzhimet e reja të sigurisë, përderisa pikat kontrolluese të KFOR-it ishin hequr nga aty dhe tani gjendja në Suhodolli i Ulët është më e qetë.

<sup>15</sup> Muaji nëntor përshkohet me djegie të të lashtave, vjedhje të lopëve, prerje të paligjshme të drunjëve, nxjerrjen e paligjshme të rërës sikurse edhe me dy sulme. Bashkësia e pakicës serbe pohon se se shqiptarët e Kosovës i kanë kryer këto incidente.

<sup>16</sup> Bashkësia e kësaj pakice raporton për një ngacmim të vazhdueshëm nga ana e shqiptarëve të Kosovës, siç janë abuzimi gojor, abuzimi fizik, hudhja e gurëve apo fishekzjarreve apo madje edhe hudhja e granatave.

realizimin e patrullave të përziera të SHPK-së është e penguar nga mungesa e policëve serb dhe ashkalinjë pranë SHPK-së.

Pikat kontrolluese të KFOR-it në Gojbulë (fshat serb) janë hequr. Ky fshat është shume lehtë i arritshëm nga ana e shqiptarëve të Kosovës të cilët jetojnë në afërsi, gjatë së cilës ende vazhdojnë incidentet siç janë vjedhjet dhe dëmtimet e pronës në periferi të fshatit. Shërbimi i autobusëve i siguruar nga Këshilli danez për refugjatë i cili përshkon linjën prej Gojbulës për në Vushtrri, vazhdon mëtutje për në Mitrovicën veriore dhe gjuhet me gurë rregullisht nga ana e shqiptarëve të Kosovës, siç pohohet për shkak të kthimit të shqiptarëve të vijës së fortë nëpër shtëpitë e tyre në qytet. KFOR-i realizon patrulla mobile për të siguruar autobusin gjatë rrugëtimit të tij. KFOR-i gjithashtu ka arrestuar dy shqiptarë të Kosovës për shkak të hujës së gurëve mbi autobusin në fjalë. Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i gjithashtu vazhdon të ofrojë përcjellje të sigurisë për autobusët e shkollave nga Gojbulë për në Vushtrri.

Gjendja e sigurisë për një grusht të serbëve të Kosovës që jetojnë në Priluzhë, enklava më e madhe në këtë komunë, mbetet e qetë, edhe pse është shënuar një rritje e numrit të krimeve të raportuara në këtë fshat gjatë muajve të fundit. Banorët e Priluzhës kritikojnë policinë (të cilët veprojnë nga një nën-stacion në të cilën punojnë si policët e UNMIK-ut ashtu edhe ata të SHPK-së) për shkak të dështimit të saj për të parandaluar shkallëm e krimet. Marrëdhënia e tyre me policinë është keqësuar edhe mëtutje pas incidentit të 31 tetorit 2002, ku dy individë të cilët ishin arrestuar gjatë një bastisje në një lokal arritën që t'i ikin policisë pas intervenimit fizik nga ana e myshterinjëve të lokalit. Gjithashtu në këtë enklavë gjendet edhe një fshat i vogël i banuar me romë. Pikat kontrolluese të KFOR-it vazhdojnë të kontrollojnë hyrjet për në fshat, përderisa banorët e këtij fshati vazhdojnë të ankohen për izolimin e tyre dhe mungesën e lirisë së lëvizjes, dhe vazhdojnë të kërkojnë nga KFOR-i përcjelljet e sigurisë për udhëtimet e tyre me autobusë apo me tren jashtë enklavës.<sup>17</sup>

Pika kontrolluese ndërmjet Miraqit (fshat i dominuar me popullatë serbe) dhe Vidos ishte hequr në pranverë të vitit 2002. Edhe pse gjendja e sigurisë është duke u përmirësuar gradualisht, dhjetë banorë të moshuar të këtij fshati kanë shprehur shqetësimet e tyre në lidhje me shkuarjen e tyre për në arrat e punës. Ata gjithashtu ankohen për aktivitete kriminale siç janë prerja e paligjshme e drunjëve. Edhe pse KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut realizojnë patrulla të përbashkëta në këtë zonë, e cila është një terren tejet malor realizimi i sigurisë në këtë zonë bëhet edhe më i vështirë. 6 banorë të moshuar serbë të këtij fshati mbeten në Sllatinë, e cila lidhet me Banjskën (shih mëposhtë). KFOR-i raporton për ngacmime të vogla mirëpo të vazhdueshme kundër pjesëtarëve të këtij komuniteti të kryera nga ana e shqiptarëve të Kosovës, përderisa prania e KFOR-it në këtë zonë është e domosdoshme për të ofruar siguri për këta individë. Incidentet e tilla të vazhdueshme të sigurisë raportohen gjithashtu edhe nga serbët e Gracës, përderisa KFOR-i vazhdon të mbajë pikën kontrolluese statike dhe të kryejë patrulla në atë anë. Bashkësia e pakicës serbe në Banjskë mbeten të mbrojtur nga pikat kontrolluese të KFOR-it të vendosur në rrugën kryesore dhe nga patrullat mobile. Gjatë kohëve të fundit kanë ndodhur edhe disa incidente të tilla kundër pjesëtarëve të kësaj bashkësie. Të inkurajuar nga gjendja e tanishme e sigurisë, bujqit serbë kanë filluar për herë të parë pas tri vjetëve, në shtator të vitit 2002, të punojnë nëpër arrat e tyre të cilat ndodhen në periferi të fshatit. Patrullat e përziera të SHPK-së kanë filluar të pranohen pozitivisht nga banorët e fshatit.

### *Skenderaj*

Pjesa e mbetur e serbëve të kësaj komune jetojnë në fshatrat e Banjës dhe Suhogërrll, dhe në Manastirin e Deviqit. Njëra nga shqetësimet kryesore të banorëve të fshatit Banjës mbetet

<sup>17</sup> Romët e Kosovës kanë qasje në trenin multietnik i cili dy herë në ditë udhëton për në Zveçan.

zvogëlimi i numrit të përcjelljeve të sigurisë të realizuara nga KFOR-i për banorët e këtij fshati të cilët udhëtojnë nëpër Rudnik dhe qytezën e Skenderajit. Patrullat e përziera të SHPK-së të cilat mbulojnë territorin e Banjës dhe Suvogërlës përbëhen edhe nga policë serbë të SHPK-së që vijnë nga stacionet në Zubin Potok dhe policët shqiptarë të stacionit në Skenderaj. Banorëve serbë të Banjës dhe Suhogërlës duket se u mungon besimi në pjesëtarët shqiptarë të SHPK-së dhe gjithashtu ngrisin shqetësime se rastet e tilla nuk hetohen si duhet nga këta pjesëtarë të SHPK-së.

#### *Leposaviq*

Leposaviqi përbëhet nga 72 fshatra, 69 prej të cilave janë të banuara me serbë përderisa 3 prej tyre janë të banuara me shqiptarë. Shqiptarët e Kosovës jetojnë në Bistricë, Kushtovë dhe Cerajë. Kjo komunë është gjithahstu edhe nikoqire e një numri të romëve të cilët jetojnë si të zhvendosur, rreth 200 prej tyre të cilët jetojnë në “Depon e Romëve”. Ofrimi i sigurisë për pjesëtarët e këtyre bashkësive të pakicave pengohet për më tepër nga terreni i keq, mirëpo duke pasur parasysh izolimin e këtyre bashkësive të pakicave, kemi edhe raste të problemeve të sigurisë të cilat kanë lindur brenda përbrenda këtyre komuniteteve. Madje edhe banorët e Depos së Romëve, e cila gjendet në qendër të Leposaviqit shumë rrallë raportojnë për probleme të sigurisë, ku këto probleme më së shumti ndërlidhen me pamundësinë e tyre për të ushtruar religjionin. Për këtë arsye prania e KFOR-it është zvogëluar si pjesë e procesit të normalizimit. Megjithatë, banorët shqiptarë kërkojnë përcjelljet e sigurisë për të shkuar për në qytetin e Mitrovicës.

#### *Zveçan*

Komuna e Zveçanit përbëhet nga 45 vendbanime, prej të cilëve 3 prej tyre janë të banuara nga shqiptarët e Kosovës. Krahas kësaj, më shumë se 180 romë jetojnë në kampin e vendosur në fshatin Zitkocv. Gjendja në këtë fshat përshkohet me disa incidente me motive etnike, edhe pse romët raportojnë në mënyrë të vazhdueshme – mirëpo jo policisë – për ngacmime të cilat janë fillojnë që nga vjedhjet e lehta e gjerë të rrahjet dhe për këtë arsye ata i shmangen daljes nga kampi përpos nëse kanë nevojë patjetër të dalin nga atje. Pjesa e mbetur e shqiptarëve të Kosovës jetojnë në Boletin, Lipë dhe Zahë. Nuk jemi dëshmitar të ndryshimeve thelbësore në gjendjen e sigurisë në këtë zonë gjatë 6 muajve të fundit, e cila përshkohet me disa incidente të motivuara etnikisht.

Policët serbë të SHPK-së janë të vendosur në detyrë në stacionin e policisë në Zveçan në nëntor 2002. Pikat kontrolluese ndërmjet Boletinit (e banuar me shqiptarë të Kosovës) dhe Lipës (e banuar me serbë të Kosovës) është hequr që nga mesi i nëntorit, heqje kjo e cila ngrit shqetësime në mesin e banorëve shqiptarë të Boletinit të cilët frikësohen nga aktivitetet kriminale të serbëve të Kosovës, veçanërisht pas muzgut. Megjithatë, nuk kemi të bëjmë me incidente të mëdha gjatë 5 apo 6 muajve të fundit para heqjes së pikës kontrolluese. Një çështje më brengosëse është mungesa e lirisë së lëvizjes, veçanërisht e fëmijëve dhe studentëve të cilët dëshirojnë të gëzojnë qasje në arsimimim.

#### *Zubin Potok*

Komuna e Zubin Potokut përbëhet nga 64 fshatra, ku 63 prej tyre janë të banuara me serbë përderisa vetëm një është e banuar me shqiptarë. Pjesa e mbetur e shqiptarëve të Kosovës jetojnë në Çabër, mirëpo kemi edhe serbë tjerë të zhvendosur dhe disa refugjatë nga Kroacia të cilët jetojnë në këtë komunë. Gjendja e sigurisë në Çabër (e banuar me shqiptarë) është përmirësuar gjatë 6 muajve të fundit, e cila përshkohet me një ndërveprim të mirë ndërmjet komunitetit vendës dhe policisë së UNMIK-ut dhe KFOR-it. Pikat kontrolluese janë hequr dhe zëvendësuar me patrulla mobile të policisë, të cilat përfshijnë edhe policë shqiptarë të SHPK-së. Liria e lëvizjes mbetet një shqetësim i vazhdueshëm, dhe policia, nëse kërkohet një gjë e tillë nga ajo, ende ofrojnë transportim për ata banorë të cilët dëshirojnë të udhëtojnë për në Zubin Potok.



## **Rgjoni i Prishtinës**

### *Fushë Kosova*

Shkalla e incidenteve me motive etnike e cila është e drejtuar kundër pjesëtarëve të popullatës serbe dhe asaj romë në komunën e Fushë Kosovës mbetet e ulët. Edhe pse incidentet e izoluar ndodhin aty këtu, për shembull sulmi kundër një burri të moshuar serb i kryer nga pjesëtarë të komunitetit shqiptar më 22 tetor 2002, periudha raportuese përshkohet me një ruajtje të gjendjes stabile të sigurisë për bashkësitë e pakicave.<sup>18</sup> Numri i familjeve serbe që jetojnë në fshatin e Bresjes vazhdon të zvogëlohet, për shkak të familjeve të cilat e lëshojnë këtë fshat për shkak të problemeve të sigurisë si një faktor kontribues në këtë drejtim, mirëpo të cilët gjithashtu ankohen për një infrastrukturë dhe qasje të mjerë në shërbimet e ndryshme. Pika e fundit kontrolluese e KFOR-it e mbetur në komunën e Fushë Kosovës ishte hequr në korrik 2002, dhe ishte zëvendësuar nga patrullat në këmbë të KFOR-it.<sup>19</sup> SHPK-ja gjithashtu ka kryer një sërë patrullash të përziera gjatë 12 muajve të fundit në komunën e Fushë Kosovës. Patrullat e përziera vazhdojnë të veprojnë në mënyrë efektive, edhe pse popullatës serbe i mungon vullneti për të bashkëvepruar me pjesëtarët shqiptarë të SHPK-së. Policët serbë të SHPK-së, megjithatë, raportojnë për një shkallë të pranueshme të bashkëpunimit të tyre me bashkësinë shqiptare.

### *Gojbulë*

Edhe pse gjendja e sigurisë për pakicat RAE minority në komunën e Obiliqit mbetet stabile, shkalla e ulët e ngacmimeve ende mbetet problem. Çështja e ngacmimit, veçanërisht nëpër shkollë, vazhdon të adresohet nga zyrtarët e Policisë së Komunitetit të SHPK-së dhe UNMIK-ut në bashkëpunim me OJQ-të dhe administratorët e shkollave. Gjendja e sigurisë për ashkalinjtë dhe romët të cilët banojnë në fshatin Plemetin dhe kampin në komunën e Obiliqit mbetet stabile, mirëpo perspektiva e dobët ekonomike dhe sociale për këto bashkësi vazhdon të mbetet njëri nga shkaktoresh kryesor të situatës së tensionuar si në kuadër të këtyre bashkësive gjithashtu edhe ndërmjet tyre dhe popullatës shumicë.

### *Prishtinë*

Në komunën e Prishtinës popullata serbe më së shumti është e përqëndruar në Graçanicë. Gjendja e sigurisë për popullatën serbe në Graçanicë (e banuar me 98% popullatë serbe dhe 2% romë) ka mbetur stabile gjatë periudhës raportuese, me incidente të motivuara etnikisht të cilat janë të shpeshta mirëpo të lehta. Pikat kontrolluese të KFOR-it të cilat shërbejnë si mbrojtje për vetë fshatin e Graçanicës ishin larguar para fillimit të raportimit tonë, dhe si alternativë e kësaj janë zbatuar masa tjera të sigurisë nga ana e KFOR-it, policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së të cilat duket të japin rezultat. Patrullat e përziera të SHPK-së kanë vepruar në mënyrë tejet efektive në Graçanicë gjatë periudhës raportuese. Që nga 1 nëntori 2002, komanda e stacionit të policisë në Graçanicë është transferuar nga policia e UNMIK-ut në policinë e SHPK-së, nën udhëzimet e Këshilltarit Ekzekutiv të Policisë së UNMIK-ut. Vetë stacioni i policisë ishte rivendosur nga fshati i Graçanicës në vendbanimet e afërta shqiptare në Hajvali. Popullata RAE e Graçanicës duket se është e gatshme dhe e aftë të gëzojë qasje në stacionin e policisë dhe si rezultat i kësaj shihet një nismë e transferit të mëtutjeshëm të komandës edhe nëpër lokalitete tjera.

---

<sup>18</sup> Një shqetësim i rishfaqur, i cili ndikon kryesisht në pjesëtarët e bashkësisë serbe, mirëpo e cila ndikon gjithashtu edhe shqiptarët e Kosovës në një masë më të vogël, është vjedhja e bagëtisë. Pavarësisht rritjes së vëzhgimit dhe shkallës së sigurisë e cila ofrohet nga KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut, nuk janë zbuluar kryesit e këtyre veprave.

<sup>19</sup> Bashkësitë e pakicave fillimisht ishin tejet të kujdesshme pas zvogëlimit të pranisë së fiksuar të KFOR-it, mirëpo për shkak se nuk jemi dëshmitar të një shtimi të numrit të incidenteve të motivuara etnikisht pas fillimit të zbatimit të këtyre masave të reja, popullata pakicë ka filluar të përqafojë këtë ndryshim në gjendjen e sigurisë.

### *Lipjan*

Gjendja e sigurisë për popullatën pakicë në komunën e Lipjanit vazhdon të mbetet stabile gjatë tërë periudhës së raportimit, pa incidente serioze të dhunës etnike kundër pjesëtarëve të grupeve të pakicave. Si pjesë e strategjisë së “ç’fiksimit”, KFOR-i ka filluar me heqjen e pikave kontrolluese statike (si në qytezën e Lipjanit ashtu edhe fshatrat e banuar me pjesëtarë të pakicave anembanë komunës) duke i zëvendësuar ato me patrulla mobile të sigurisë, si rezultat i përkrahjes së dhënë nga policia e UNMIK-ut dhe SHPK-së. Pjesëtarët e bashkësisë serbe, RAE dhe boshnjake përfaqësohen në rradhët e policisë së SHPK-së të cilët veprojnë nga stacioni i policisë në Lipjan, ku 28 prej tyre janë serbë. Prania e policëve serbë të SHPK-së, sipas UNMIK-ut, inkurajon pjesëtarët e këtyre bashkësive (veçanërisht bashkësinë serbe) që të fillojnë t’i raportojnë krimet dhe të zhvillojnë një gatishmëti të shtuar tek ta sa i përket kërkimit të ndihmës nga ana e policisë.

Pjesëtarët e bashkësisë serbe në Lipjan/Lipljan vazhdojnë të frikohen nga ngacmimi dhe frikësimi dhe në përgjithësi i shmangen rrugëve kryesore kur të kalojnë prej një zone në tjetrën të banuar me serbë. Ndërveprimi ndërmjet bashkësisë serbe dhe asaj shqiptare mbetet e kufizuar. Megjithatë, që nga shatori 2002, bashkësia serbe në qytezën e Lipjanit e cila vazhdon të jetojë nën mbrojtjen e KFOR-it, ka filluar të gëzojë qasje nëpër dyqanet e shqiptarëve sidomos të shtuneve në mëngjes. Kjo nisje është realizuar në konsultim me udhëheqësit e bashkësive etnike dhe pronarët e këtyre lokaleve. KFOR-i vazhdon të ofrojë përcjellje të sigurisë për punëtorët serbë të fabrikave të cilët udhëtojnë nga Lipjani për punë në Fushë Kosovë, sikurse edhe për autobusët të cilët udhëtojnë për në Serbi nëpërmjet të Portës 3. Shfrytëzimi në rritje i tabelave të regjstrimit KS ka rritur lirinë e lëvizjes në mesin e banorëve serbë të komunës së Lipjanit.

Komuna e Lipjanit gjithashtu strehon një numër të madh të pjesëtarëve të bashkësië RAE, si në qytezën e Lipjanit gjithashtu edhe në fshatrat tjerë anembanë komunës siç janë Magurë, Dobrotini dhe Dobraja e Vogël. Ende vazhdojmë të jemi dëshmitar të incidenteve të vogla të ngacmimit të pjesëtarëve të kësaj bashkësie, veçanërisht të romëve të cilët flasin serbokroatisht.

Popullata kroate e kësaj ane e cila është e përqëndruar në fshatin Janjevë mbetet e aftë të lëviz lirisht nëpër tërë Kosovën dhe pjesëtarët e kësaj bashkësie kanë mundësi të përdorin gjuhën serbokroate gjatë punëve që i kryejnë me pjesëtarët e popullatës shumicë.

### *Shtime*

Gjendja e numrit të vogël të pakicës serbe të Kosovës në Shtime, mbetet posaçërisht shqetësuese.<sup>20</sup> Edhapse nuk janë dokumentuar incidente të rënda gjatë periudhës raportuese, ky komunitet është i përbërë kryesisht nga persona të moshuar të cilët drujnë nga ngacmimet dhe frikësimet, dhe për këtë, liria e tyre e lëvizjes është e kufizuar jashtëzakonisht shumë. Përderisa si duket, rastet e raportuara të ngacmimeve kundër popullatës serbe janë hulumtuar dhe përcjellur hollësisht, gjithashtu duhet të vërehet se përpjekjet e bëra nga zyrtarët komunal kanë pasur ndikim pozitiv në gjendjen e sigurisë në këtë komunë. Në anën tjetër, KFOR-i, dy herë në muaj ofron transport me autobus për qëllim të shitblerjes në qytetin e Lipjanit.

## **III. PROCESI I KTHIMIT TË PAKICAVE NGA PERSPEKTIVA E SIGURISË**

Analiza e statistikave të UNHCR-së mbi kthimin e pakicave, tregon se niveli i sigurisë fizike dhe liria e lëvizjes dallon varësisht nga pakica në fjalë, dhe lokaliteti i pakicës, gjë që paraqesin faktorë kyç të cilët ndikojnë në ritmin e procesit të kthimit. Numri prej 2.741 kthimeve të

<sup>20</sup> Kjo komunë gjendet nën përgjegjësinë e stacionit policor të Lipjanit, e cila e ka hapur një nënstacion për t’i shërbyer.

regjistruara të pakicave në vendin e tyre të origjinës gjatë vitit 2002 i ka tejkaluar kthimet e raportuara deri më tash. Për dallim nga viti 2000 kur 1.906 persona janë kthyer në vendin e tyre të origjinës, thuajse të gjithë këta janë serbë të kthyer nëpër enklavat mono-etnike, kthimet në vitin 2002 kanë qenë më të llojllojshme për kah përkatësia etnike dhe regjionale e tyre.

Mirëpo, këto të dhëna statistikore mund të jenë paksa mashtruese për shkak se ato sugjerojnë përmirësime më të mëdha se sa në të vërtetë kanë ndodhur. Shtimi i numrit të kthimeve për vitin 2002 duhet të shikohet në kontekst të një rëmje të përgjithshme të trendit të kthimeve, gjë që më së shumti shihet me rastin e serbëve të Kosovës. Shumë faktorë kanë ndikuar në këtë rëmje, përfshirë ata të sulmeve të dhunshme kundër bashkësive të pakicave në vitin 2000 dhe 2001 dhe gjendja jostabile e krijuar në regjion nga konfliktet në IRMJ dhe Serbinë Jugore. Faktori tjetër përcaktues ishte stërmbushja e enklavave mono-etnike, ku një numër i madh i të zhvendosurve kanë kërkuar strehim. Familjet serbe të zhvendosura nga këto lokalitete, kanë vazhduar të kthehen. Këto kthime janë inkurajuar nga siguria e cila ofrohet si rezultat i koncentrimeve të serbëve të Kosovës nëpër këto lokalitete. Duhet të vërehet se këto bashkësi mono-etnike të serbëve të Kosovës, janë kthyer për në fshatërat mono-etnike, apo në pjesët serbe të ndara të fshatërave apo qytetezave që kanë ekzistuar në periudhën para konfliktit.

Prandaj, shqetësimet e vazhdueshme dhe të justifikuar mbi sigurinë, preferenca për t'u kthyer në rajonet me koncentrim të familjeve serbe dhe ndjenja e nevojës për t'u siguruar nga KFOR-i, policia e UNMIK-ut apo SHPK-së, sqarojnë arsyen se pse shumica e kthimeve të serbëve realizohen më parë nëpër rajonet mono-etnike, se sa nëpër ato të përziera<sup>21</sup>, kështu që lirisht mund të thuhet se kushtet e sigurisë e përcaktojnë lokalitetin dhe shpejtësinë e kthimit.

Situata e tillë është parë në regjionin e Pejës, ku shpërndarja demografike para periudhës së konfliktit ka qenë e atillë që shumica e komuniteteve serbe të Kosovës kanë qenë relativisht të veçuara si në aspektin fizik poashtu edhe në aspektin e ndërveprimit me bashkësitë tjera etnike. Pas kthyerjeve në regjion, popullata e kthyer serbe ka riprodhuar gjendjen sikur në periudhën para konfliktit, të vendbanimeve serbe, duke u kthyer nëpër enklava mono-etnike apo fshatëra<sup>22</sup>. Pas kthimit të mirënjohur në luginën e Osojanit në Istog, të kthyerit kanë mbetur të izoluar duke replikuar gjendjen që ka ekzistuar para konfliktit. Ky izolim ka rezultuar gjithashtu edhe nevojën për t'u mbështetur me të madhe në sigurinë dhe përcjelljen nga ana e KFOR-it<sup>23</sup>. Arranzhimet e tilla të sigurisë, e kufizojnë lirinë e lëvizjes për të kthyerit dhe qasjen e tyre në shërbimet themelore, por edhe mundësitë për punësim jashtë fshatit të tyre. Problemet e sigurisë të të kthyerve janë rishfaqur me rastin e pensionerëve të fshatit të cilët janë sulmuar në qytetin e Pejës në tetor 2002<sup>24</sup>.

I kundërt me këtë është rasti i të kthyerve në fshatërat e afërta të Binxhës dhe Grapcit në komunën e Klinës. Menjëherë pas kthimit, vendosmëria e të kthyerve për të krijuar kontaktet me fshatërat fqinje të shqiptarëve, ishte lehtësuar përmes kontrollave më të buta të sigurisë nga KFOR-i.

---

<sup>21</sup>Faktorët siç janë: kushtet e rënda në zhvendosje (kushtet e përkeqësuar të jetesës, reduktimi apo ndërprerja e ndihmës humanitare, por edhe lodhja e nikoqirëve e cila është shprehur nga komuniteti mikëpritës) apo në disa raste edhe detyrimi për t'u kthyer nga vendet e Evropës Perëndimore, nga të kthyerit e të gjitha entiteteteve, janë cituar të jenë faktorët e fuqishëm shtytës, se sa përmirësimet e kushteve të përgjithshme apo sigurisë dhe lirisë së lëvizjes në Kosovë.

<sup>22</sup> 175 nga numri prej 177 personave të kthyer nëpër fshatëra të tilla.

<sup>23</sup> Për shënime më të hollësishme mbi të kthyerit e parë në Osojan, ju lutemi t'i referoheni vlerësimit të nëntë të përbashkët të OSBE/UNHCR mbi gjendjen e pakicave etnike në Kosovë.

<sup>24</sup> Për shtjellim të mëtejshëm të incidentit, ju lutemi lexoni pjesën e sipërme mbi regjionin e Pejës.

Ndërveprimi fillestar pozitiv, ka tendenca për t'u përkeqësuar. Jo vetëm që kontaktet janë pakësuar, por gjithashtu kanë ndodhur situata që ndërlidhen me sigurinë<sup>25</sup>

Sa i përket të kthyerve jo-serbë, romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit e Kosovës, në të shumtën e rasteve janë kthyer nëpër komunitetet e përziera përgjatë Kosovës. Këtu hyjnë shembujt e ashkalinjëve të kthyer në regjionin e Prishtinës, Magurë, Dobrajë të Vogël dhe qytetin e Prishtinës. Gjithashtu janë bërë kthime edhe në regjionet e dalluara etnike brenda komuniteteve të përziera, siç është rasti i të gjitha pesë komunave të regjionit të Pejës. Kthimet nëpër regjionet e përziera etnike, kërkon edhe për një punë më të intensifikuar policore nga ana e SHPK-së apo të UNMIK-ut. Përkundër përgatitjeve intenzive dhe të gjata, por edhe angazhimit inkurajues të zyrtarëve lokal, kthimet janë ballafaquar me incidente të sigurisë të cilat kishin nën shënjestër komunitetet rezidente të pakicave, por edhe ato të kthyer. Një shembull i mirë i kësaj është kthimi i ashkalinjëve në qytetin e Vushtrrisë, ku kanë ndodhur një varg incidentesh të sigurisë gjatë vitit 2002<sup>26</sup>.

Sfidat e vazhdueshme të sigurisë të pranishme në të gjitha kthimet, kanë potencuar nevojën e vënjes së prioritetit në çështjet e ndërtimit të mirëbesimit dhe dialogut ndëretnik, për qëllim të krijimit të shkallës minimale të stabilitetit para realizimit të kthimeve. Në mungesë të një dialogu të tillë, çështja e kushteve të sigurisë dhe lirisë së lëvizjes mbeten problematike. Mbështetja e madhe në KFOR-in dhe policinë e UNMIK-ut në atë rast është e madhe ashtu siç ka ndodhur me fshatin Osojan. Kthimet e tilla, përveç nëse të përcjellura me një përpjekje intenzive për pajtim, bëjnë që komunitetet të mbetet të rrezikuara ndaj dhunës apo ngacmimeve, menjëherë pasi që forcat ndërkombëtare ushtarake apo policore të reduktohen në nivelin e caktuar.

Atëherë kur çështjet e sigurisë mbeten të pazgjidhura, procesi i kthimeve ka gjasa të vogla të jetë i qëndrueshëm. Në një shembull tjetër, kthimi spontan i grupit të parë të 26 shqiptarëve të Kosovës në fshatin e tyre mono-etnik, por të braktisur të Bitisë së Ultë, në komunën e Shtërpçës me shumicë serbe, kishte hasur fillimisht në një kundërshtim të fuqishëm nga ana e banorëve të fshatit fqinjë serb me të njëjtin emër. Shqetësimet për sigurinë e të dyja komuniteteve kanë bërë që KFOR-i polako-ukrainas të imponojë kufizime të përkohshme ndaj lëvizjes brenda dhe për rreth fshatit<sup>27</sup>. Organizatat ndërkombëtare kishin intervenuar për të lejuar që të zhvendosurit shqiptarë të gëzojnë të drejtën e tyre për kthim. Si rezultat i kësaj, KFOR-i u pajtua të organizojë sigurimin i cili ishte efektiv por më pakë restriktiv për nga natyra. Në të njëjtën kohë, të kthyerit ndërmorrën nismën për të hyrë në dialog me serbët<sup>28</sup>. Bashkëpunimi i ngushtë në mes orgnaizatave civile dhe ushtarake, është kurorëzuar me dy rezultate të rëndësishme. Së pari, ka lejuar për kthimin. Së dyti, përkundër shqetësimeve fillestare në lidhje me brojtjen e të drejtave të të kthyerve spontan nga KFOR-i në këtë rast, gjendja ka shpër deri tek nisma e KFOR-it të SHB-ve, për të themeluar udhëzimet e KFOR-it për procedurat e kthimit të refugjatëve dhe personave të zhvendosur për rajonin operativ të Gjilanit.

<sup>25</sup> Kanë ndodhur situata kërcënuese, sikurse janë, shkrepjet me armë jashtë territorit të fshatit nga kryes të panjohur, por gjithashtu edhe sulme verbale.

<sup>26</sup> Për shembull, pas kthimit të tyre, të kthyerit ishin ngacmuar nga shqiptarët e Kosovës ndërsa pasuria e tyre është dëmtuar gjatë muajit maj 2002 menjëherë pas kthimit të tyre. lexo gjithashtu pjesën mbi Vushtrinë.

<sup>27</sup> Këto kufizime fillonin prej ndalimit të plotë të lëvizjeve deri në ofrimin e disa përcjelljeve të kufizuara.

<sup>28</sup> Kthimi i shqiptarëve ka ndikuar në banorët serbë të cilët ishin kundër kthimit të tyre, që këta të fundit të kuptojnë se të dy komunitetet kanë dobi prej kthimit. Më pas, kthimi i shqiptarëve të Kosovës në Bitinë e Ultë, u dhëshmu si një lloj nxitësi i fillimit të diskutimeve mbi kthimin e pakicave në Ferizaj, ku të kthyerit nga Bitia e Ultë kishin qenë të zhvendosur, por edhe për të kthyerit e parë serbë në luginën e Zhupës.

Gjatë vitit 2002, disa qeveri të Evropës Përendimore kishin konstatuar se kushtet e sigurisë janë përmirësuar në Kosovë sa për të filluar kthimi i një shkalle më të gjërë të pakicave jo-ersbe, gjatë verës së vitit 2003. Në përgjigje të kësaj, UNHCR ka kryer një sondazh mbi ndikimet që ky kthim mund të ketë në pakicat jo-serbe. Sondazhi u fokusua në kapacitetet thithëse të komuniteteve të vendosura dhe mbi raportet në mes të pakicës dhe popullatës shumicë në lokalitetet në të cilat kthimet ishin në proces e sipër. Krahas kësaj, shiqohej në rajonet në të cilat ekzistonin gjasat për kërcënimet të sigurisë dhe liriës së lëvizjes për të kthyerit dhe popullatën pakicë të mbetur. Ky sondazh konkludon se kthimet në komunitetet të cilat nuk kanë pasur pakica që nga viti 1999, dhe që janë të banuara vetëm me grupet shumicë, nuk janë lokalitete që qëndrueshme për kthim përveç nëse janë të përgatitura me kujdesë nga organizimi i dialogut ndëretnik para se të ndodhë vet kthimi. Përgjithësimet ende janë valide edhe pse ka përjashtime sikurse u përmend në rastin e të kthyerve shqiptarë në Bitinë e Ultë.

Në fund, kthimet e paplanifikuara madje edhe të shkallës më të ultë, nëpër rajonet e braktisura apo nëpër rajonet e banuara vetëm me popullatën shumicë, sipas të gjitha gjasave do të rezultojnë në zhvendosje dytësore për në rajonet e koncentruara ku vetëm se banon një numër më i madh i të zhvendosurve.

## **PJESA 2: QASJA NË DREJTËSI**

Qasja në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë këtu si drejtësinë penale ashtu edhe atë civile, është një lloj i posaçëm i qasjes në shërbimet themelore. Pakicat duhet të jenë të afta që fizikisht të gëzojnë qasje nëpër gjykata dhe duhet të sigurohet që rastet e tyre adresohen në mënyrë të drejtë dhe efektive. Me qëllim të sigurimit të qasjes dhe korrektësisë, pjesëtarët e bashkësive të pakicave duhet të përfaqësohen në mënyrë profesionale nëpër gjyqe. Që nga vlerësimi paraprak, Departmenti i Drejtësisë i UNMIK-ut ka ndërmarrë disa hapa drejt integritit të pakicave në gjyqësi dhe drejt dobësisë të sistemit paralel të gjyqeve.<sup>29</sup> Në të njëjtën kohë, shumë pakica ende janë duke treguar një mungesë të besimit në sistemin e drejtësisë të instaluar nga UNMIK-u.

### **I. INTEGRIMI GJYQËSOR/PUNËSIMI NËPËR GJYQE**

Pas shumë vështirësive diplomatike dhe teknike, UNMIK-u është treguar si mjaft e suksesshme në punësimin e një numri të mirë të gjykatësve dhe prokurorëve që vijnë nga rradhët e pakicave në kuadër të gjyqësisë. Një pjesë e madhe e “Dokumentit të përbashkët UNMIK – Jugosllavi” (Dokumenti i përbashkët), i cili është nënshkruar më 5 nëntor 2001, përqëndrohet në integrimin e pakicave në kuadër të gjyqësisë, dhe vërteton zotimin e UNMIK-ut drejt avansimit të multietnicitetit në gjyqësi duke punësuar më shumë gjyqtarë dhe prokurorë serbë në gjyqësi, dhe në këtë mënyrë drejt adresimit të shqetësimeve rrënjësore siç janë animet etnike. Në bazë të këtij dokumenti, UNMIK-u gjithashtu është pajtuar të “krijojë dhe punësojë një njësi të re në kuadër të DD-së e cila do të jetë përgjegjëse për avansimin e përpjekjeve në këtë fushë”. Njësia për Integrim Gjyqësor u krijua në kuadër të DD-së, dhe kishte tri qëllime kryesore: 1) integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve minoritar nëpër gjyqe; 2) lehtësimin e qasjes në gjyqe për pjesëtarët e pakicave që jetojnë nëpër enklava; dhe 3) adresimi i rasteve nëpër gjyqe në të cilat janë të përfshirë pjesëtarët e pakicave.

Procesi i integritit gjyqësor ishte mjaft i ngadalshëm, kryesisht për shkak të mosmarrëveshjeve diplomatike ndërmjet UNMIK-ut dhe Republikës së Serbisë. Në vazhden e implementimit të këtij Dokumenti, u bë mëse e qartë se për disa çështje thelbësore nevojitet një zgjidhje e menjëhershme, siç është fakti se a do të munden gjyqtarët dhe prokurorët e saporekrutuar serb të ruajnë sigurimin dhe beneficinet tjera sociale nga Republika e Serbisë. Më 9 korrik 2002, u nënshkrua Deklarata e përbashkët<sup>30</sup> ndërmjet Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Serbisë dhe Zëvendësit të PSSP-së për polici dhe drejtësi, me qëllim të lehtësimin të mëtutjeshëm të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve serb. Në bazë të kësaj marrëveshje, Drejtorati për çështje banesore dhe pronësore do të bëjë përpjekje të mëdha për zgjidhjen e të gjitha kërkesave pronësoro-juridike të cilat janë parashtruar nga aplikantët serbë; përderisa UNMIK-u do të sigurojë plotësimin e kushteve tjera, siç janë rekrutimi i stafit përkrahës nëpër gjyqe. Si pjesë e kësaj marrëveshje, Republika e Serbisë është e zotuar të ruajë beneficinet sociale dhe të drejtat pensionale për gjyqtarët dhe prokurorët në fjalë, dhe do t’ua kthejë të drejtën për t’u kthyer në ish postet e tyre në sistemin e drejtësisë serbe nëse ata vendosin t’ua lëshojnë Kosovën.

Kjo deklaratë e përbashkët ndihmoi në lehtësimin e procesit të aplikimit. Konkursët për gjyqtarë dhe prokurorë ishin pranuar mjaft mirë nga ana e pjesëtarëve të bashkësive të pakicave. Pas

<sup>29</sup> “Sistemi paralel i gjyqeve” i referohet gjyqeve paralele serbe të cilat vazhdojnë të veprojnë nën juridikcionin e Kosovës, përkundër faktit se vetëm gjyqet e UNMIK-ut kanë të drejtë të kenë juridikcion mbi Kosovën. (*Lexo Rezolutën e KS të KB-së* 1244). Për më shumë informata drejtohuni “Raportit të OSBE-së: Aktivitetet Paralele të Gjyqeve në Mitrovicën Veriore” të 31 majit 2002.

<sup>30</sup> “Deklarata e Përbashkët mbi Rekrutimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të Përkatësisë Etnike Serbe në Sistemin Multietnik të Drejtësisë në Kosovë”.

periudhës së aplikimit, Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës i rekomandoi 42 kandidatë Kuvendit të Kosovës për aprovim, ku 19 prej tyre ishin shqiptarë, 21 serbë (duke përfshirë këtu edhe 7 persona të zhvendosur që jetonin në Serbi), 1 boshnjak dhe 1 goran i Kosovës. Edhe pse Kuvendi i Kosovës dështoi të miratojë formalisht emërimin e këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve,<sup>31</sup> ku shumica prej tyre dhanë betimin më 12 dhjetor 2002 para Zëvendësit të PSSP-së. Përpjestimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të përkatësisë së ndryshme etnike duhet të reflektojë raportin ndërmjet popullatës shumicë dhe asaj pakicë.<sup>32</sup>

Së bashku me integrimin dhe punësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve minoritar, shumë gjykata janë hapur në loacionet e banuara me bashkësitë e pakicave. UNMIK-u ka themeluar gjyqet komunale dhe për kundërvajtje në Leposaviq dhe Zubin Potok, shumica prej të cilave janë hapur zyrtarisht më 13 janar 2003. Krahas kësaj, një Departament i Gjykatës Komunale të Ferizajit dhe një gjykatë për kundërvajtje duhet të hapet në mars të vitit 2003. Si rezultat i kësaj janë hapur një sërë konkursesh për staf përkrahës nga 1254 prej tyre që punojnë në tërë Kosovën.<sup>33</sup> Departamenti i administratës gjyqësore (DAGj),<sup>34</sup> me përkrahjen e DD-së, për momentin është duke punuar në plotësimin e konkurseve për staf përkrahës, gjatë së cilës shumë pjesëtarë të bashkësive të pakicave janë inkurajuar të aplikojnë. Në nëntor 2002, një listë e konkurseve ishte shpallur, duke përfshirë disa pozita për gjyqet në Leposaviq dhe Zubin Potok. Serbët e Kosovës në komunat veriore shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me konkurset e shpallura në atë kohë. Për shembull, “Deklarata e përbashkët” nuk mbulonte stafin përkrahës. Shumë kandidatë për këto poste kishin punuar më parë në kuadër të sistemit paralel të gjyqeve, dhe nuk ishte e qartë se a do të vazhdojë republika e Serbisë të paguajë pensionet dhe sigurimin social të tyre. Me qëllim të dhënies së përgjigjes adekuate ndaj shqetësimeve të tilla dhe sqarimit të këtyre posteve në mënyrë të detajuar, në nëntor të vitit 2002, Seksioni për Integrim Gjyqësor dhe DÇGj-së organizoi një sërë mbledhjesh në Kosovën veriore me kandidatët e mundshëm.

Për shkak se përpjekjet për integrimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit përkrahës që vijnë nga rradhët e pakicave janë në zhvillim e sipër, UNMIK-u mbetet përgjegjës për të siguruar që të gjithë ata që punësohen nëpër këto gjyqe të kenë mundësi të shkojnë në punë të sigurtë dhe të punojnë në një mjedis të sigurtë. Deklarata e Përbashkët përmban dispozita mbi sigurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të saporekrutuar, e cila thekson se UNMIK-u do të ofrojë mbrojtje për këta gjyqtarë në bazë të vlerësimeve individuale të kërcënimit. OSBE-ja do të përcjell për së afër zbatimin e këtij procesi. Në anën tjetër, stafi përkrahës i gjyqeve duhet të mbrohet, sidomos stafi i cili duhet të udhëtojë nga enklavat. Në këtë drejtim jemi dëshmitar të një sërë përmirësimesh të vogla. Një shembull i mirë në këtë drejtim është edhe ai i gjykatës komunale në Rahovec, ku është i punësuar vetëm një punëtor serb si roje e sigurisë. Dy serbë tjerë u punësuan në mars të vitit 2001 në pozita të stafit përkrahës, mirëpo nuk kishin mundur të fillojnë punën për shkak të mungesës së përcjelljes gjatë udhëtimit të tyre. DÇGj-ja adresoi këtë problem duke e angazhuar një vozitës serb për të transportuar anëtarët serb të stafit për në punë dhe anasjelltas. Për shkak të kësaj, dy prej tyre të cilët ishin punësuar në vitin 2001 do të duhet përfundimisht të

<sup>31</sup> Në seancën e Kuvendit të Kosovës të 14 nëntorit 2002, Kuvendi shtyu diskutimin mbi emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për shkak se Komiteti për çështje gjyqësore kishte kërkuar në mënyrë të përsëritur shënime mbi biografinë e tyre. Me qëllim të mënjanimin të vonesave të tilla të panevojshme në këtë proces, PSSP-ja vazhdoi t’i emëroi ata në bazë të pushtetit të tij rezervuar.

<sup>32</sup> Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve për momentin është 326. Baraspesha gjinore është 81 gjyqtarë femra dhe 245 meshkuj, dhe nga ky numër i përgjithshëm 293 janë shqiptarë, 16 serbë dhe 17 vijnë nga rradhët e pakicave tjera (turqit, boshnjakët, romët). Numri i përgjithshëm i prokurorëve janë 47. Shtatë (7) prokurorë janë femra dhe 40 meshkuj. Baraspesha gjinore është 43 shqiptarë, 1 serbë dhe tre nga pakicat tjera kombëtare (turqit, boshnjakët, dhe romët).

<sup>33</sup> Raporti javor i DD-së, 31 janar 2003.

<sup>34</sup> Departamenti vepron nën Ministrinë e Shërbimeve Publike.

fillojnë me punën. Duke e thënë këtë nuk mund të gjejmë ilaç në të gjitha problemet. Në të njëjtën gjykatë janë katër gjyqtarë porotë serbë, të cilët deri më tani kishin marrë pjesë në vetëm një gjykim. Kryetari i gjyqit i tha OSBE-së se ata kanë qenë të ftuar zyrtarisht që të ulen si anëtar të kolegjit mirëpo nuk i janë përgjegjur kësaj ftese për shkak se sipas tij, ata ende nuk e ndiejnë vetën mirë në këtë mjedis dhe ende frikohen se atmosfera kundër tyre është armiqësore.<sup>35</sup>

## II. QASJA FIZIKE NË GJYQE DHE OBJEKTET E PARABURGIMIT

Njëri nga problemet më të mëdha në qasjen publike në drejtësi mbetet vetë qasja fizike në gjyqe. Që nga vlerësimi, gjendja e sigurisë është përmirësuar, mirëpo prapëprapë ende ndryshon nga regjioni në regjion. Qasja në gjyqe në komunën e Mitrovicës mbetet shumë problematike si nga aspekti logjistik gjithashtu edhe nga ai i sigurisë. Gjendja është tejet unike për shkak se gjyqet janë të vendosura në pjesën veriore të komunës të banuar kryesisht me serbë. Përderisa serbët nuk përballen me ndonjë problem sa i përket qasjes fizike në gjyqe, shqiptarët ballafaqohen me më shumë probleme dhe për këtë arsye ata duhet të shfrytëzojnë transportin e siguruar nga policia e UNMIK-ut për të shkuar nëpër gjykatore. Kjo mund të vështirësojë situatën edhe më shumë, për shkak se kemi vetëm disa transportime që kryhen brenda ditës, përderisa në disa ditë tjera nuk kemi transportim për shkak të problemeve të sigurisë. Përpos stafit të rregullt të gjykatave të cilët merren nga shtëpitë e tyre dhe dërgohen në punë dhe anasjelltas në të njëjtën kohë, nuk ekziston ndonjë orar rutinor dhe njerëzit të cilët duhet të shkojnë nëpër gjykatore shpeshherë duhet të presin në stacionin e policisë për disa orë të tëra. Për shqiptarët e Kosovës dhe boshnjakët të cilët jetojnë në Kosovën veriore është edhe më vështirë për shkak se ata së pari duhet të shkojnë në jug, dhe pastaj të presin autobusin për të shkuar në veri. Ashkalinjtë e Kosovës të cilët jetojnë në Mitrovicë si duket nuk përballen me probleme të sigurisë sa i përket qasjes fizike nëpër gjykata, mirëpo për momentin ata kanë vetëm dy lëndë civile të cilat janë në procedurë e sipër.

Për dallim nga Mitrovicë, transportimi i pakicave nëpër gjyqet e vendosura në komunat tjera bëhet në mënyrë ad hoc, me sukses i cili ndryshon nga vendi në vend. Në Vushtrri, transportimi i pjesëtarëve të pakicës serbe nga enklavat bëhet me kërkesë dhe bashkëpunim të policisë. Së këndejmi, bashkëpunëtorët profesional nëpër gjyqe gjithashtu shkojnë nëpër enklava të serbëve dhe kryejnë punët e tyre administrative aty për aty, siç janë vulosja e kontratave apo kryerja e formaliteteve tjera gjyqësore. Kryetari i Gjyqit për Kundërvajtje në Vushtrri informoi OSBE-në se gjyqtarët kohëpaskohe udhëtojnë për në enklava për të kryer dëgjimin e dëshmitarëve apo mbajtjen e seancave, dhe së këndejmi kjo lihet në pushtetin diskrecional të këtyre gjykatësve dhe si rezultat i kësaj nuk posedojmë me shifra përkatëse. Sidoqoftë, banorët e enklavave janë duke u bërë gjithnjë e më tepër më të vetëdijshëm sa i përket qasjes në shërbimet gjyqësore dhe pranimi i sistemit gjyqësor nga ta duket të rritet dita ditës. Në anën tjetër të spektrit, serbët e komunës së Skenderajit refuzojnë të pranojnë masat e sigurisë për qasjen në gjyqe. Sipas Kryetarit të Gjykatës Komonale në Skenderaj, vitin e kaluar gjykata dëgjoji vetëm dy raste në të cilat serbët e Kosovës ishin të përfshirë, dhe të dyja ato kishin të natyrë penale. Në rastet e tilla, edhe pse kryetarët e gjykatave bën arranzhime me policinë sa i përket çështjes së sigurisë, avokati mbrojtës mbështeste faktin mbi mungesën e sigurisë dhe kërkoi që të mbyllet rasti. Gjykata dhe Prokuroria u pajtuan që t'i dëgjojnë rastet në gjykatën e Mitrovicës, mirëpo të pandehurit nuk i përmbaheshin urdhërave për thirrje në gjyq dhe ishin shpallur fajtor në mungesë.<sup>36</sup>

Gjendja e qasjes fizike nuk ka ndërruar shumë në regjionin e Pejës. OSBE-ja është informuar se pjesëtarët e bashkësive RAE dhe boshnjake në këtë regjion nuk ballafaqohen me ndonjë problem

<sup>35</sup> OSBE-ja nuk ishte në gjendje të kontaktojë me gjyqtarët porotë.

<sup>36</sup> Ky rast gjithashtu demonstroi se si argumenti mbi sigurinë e pamjaftueshme mund të keqpërdoret si pjesë e një strategjie të mbrojtjes me qëllim të ikjes së dënimit.



sa i përket qasjes në shërbimet gjyqësore, përderisa për banorët e enklavave serbe përcjellja e sigurisë nga ana e KFOR-it është e domosdoshme. OSBE-ja mësoi se banorët serbë të enklavës së Osojanit të komunës së Istogut/Istok kanë mundësi t'i parashtrorjnë kërkesat në gjyqe nëpërmjet të zyrës së UNMIK-ut. Në Gorazhdevc, ankesat apo kërkesat nëpër gjykata mund të bëhen qoftë nëpërmjet zyrës së UNMIK-ut, policisë së UNMIK-ut apo ndonjë personi tjetër i cili e ka siguruar përcjelljen nga KFOR-i (dhe atë nëse bëhet lajmërimi tri ditë mëparë). Banorët serbë të enklavës së Biqës në komunën e Klinës raportojnë se janë duke u përballur me vështirësi sa i përket arranzhimit të përcjelljeve të sigurisë për në gjykata. Udhëheqësi i fshatit shprehi shqetësimin se KFOR-i caktoi vetëm dy ditë të javës si ditë kur mund të bëhet transportimi i banorëve për në Klinë.

Në regjionin e Prizrenit, pakicat nga komunat e Prizrenit dhe Dragashit, duke përfshirë këtu edhe goranët, turqit, romët, boshnjakët dhe një numër të vogël të serbëve të Kosovës, kanë qasje në gjyqe pa problem. Gjendja në të cilën jetojnë shumë serbë në komunën e Rahovecit mbetet e njëjtë: ata nuk mund të dalin nga enklavat e tyre pa përcjellje. Sidoqoftë, serbët e Kosovës janë duke parashtruar gjithnjë e më shumë ankesa pranë Gjyqit Komunal në Rahovec, përderisa policia duket se është duke i'u përgjigjur mirë thirrjeve për përcjellje nga ana e tyre.

Në regjionin e Gjilanit, serbët më së shumti banojnë në komunën e Shtërpçës e cila bie nën juridikcionin e Gjyqit Komunal në Ferizaj. Për shkak të lirisë së kufizuar të lëvizjes, serbët e Kosovës dhe romët nuk kanë mundësi t'i qasen fizikisht gjyqeve, përderisa numri i rasteve minoritare që dëgjohen dhe gjykohen është shumë i vogël. OSBE-ja është e informuar se policia e UNMIK-ut nuk ofron transportim për të dyshimtit dhe dëshmitarët për në seancat dëgjuese dhe gjykime, mirëpo vetëm ekzekuton vendimet gjyqësore siç janë urdhër arresti nëse personi nuk paraqitet në gjyq. Këto çështje do të adresohen pasi që të hapen Departamenti i veçantë i Gjyqit Komunal në Ferizaj dhe Gjyqi për Kundërvajtje në Shtërpçë. Në regjionin e Prishtinës, ende ekzistojnë probleme sa i përket qasjes në gjyqe sidomos për serbët që jetojnë në Graçanicë. UNMIK-u është duke e adresuar këtë problem duke organizuar një autobus të gjyqit i cili do të bënte vijën e rregullt prej Graçanicës për në Prishtinë. Dy zyrtarë për ndërlidhje të gjyqeve janë punësuar të cilët do të punojnë në Graçanicë dhe të cilët do të japin ndihmën e tyre në çështjet administrativo-juridike dhe ato të transportimit.

Sikurse qasja në gjyqe, qasja në qendrat e paraburgimit nga ana e anëtarëve të familjeve të paraburgosurve minoritar mbetet një problem i hapur. Vështirësitë me të cilat përballen këto familje minoritare që janë kryesisht të natyrës së lirisë së kufizuar të lëvizjes kanë ndikim të madh në realizimin e të drejtës së të paraburgosurit për të gëzuar qasje në botën jashtë burgur e cila garantohet si me ligjin vendës gjithashtu edhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Asnjë transport i mbrojtur dhe i qëndrueshëm nuk organizohet për familjet e serbëve të Kosovës të cilët vizitojnë të paraburgosurit serb në regjionet e banuara me shqiptarë. Shumica prej tyre duhet të realizojnë transportimin e tyre për në gjykata vetë dhe duhet të gjejnë vetë zgjidhje të ndryshme ad hoc. Incidenti i sigurisë i cili ndodhi më 8 prill 2002 në pjesën veriore të Mitrovicës<sup>37</sup> ndikoi në masë të madhe në mundësinë e vizitave të familjeve shqiptare të paraburgosurve që gjindeshin në qendrën e paraburgimit në pjesën veriore të qytetit. Në javët pas këtij incidenti, nuk u organizua kurrfarë transportimi. Që nga atëherë transportimi i familjeve shqiptare i përcjellë nga njësitë speciale të policisë është rivendosur, mirëpo një herë në javë përderisa para incidentit ky shërbim ofrohej dy herë në javë.

---

<sup>37</sup> Incidenti përbëhej nga një përplasje e dhunshme ndërmjet të popullatës serbe dhe policisë së UNMIK-ut. Lexo komunikatën për shtyp të UNMIK/PSSP-së të 9 prillit 2002.

Qasja e avokatëve minoritar në qendrat e paraburgimit është përgjithësisht e mirë. NjSP-ja ofron përcjellje për transportin e avokatëve serb në objektet e paraburgimit dhe gjyqet të cilat ndodhen në zonat e banuara me popullatë shumicë shqiptare. Qasja e avokatëve shqiptarë në qendrat e paraburgimit të cilat ndodhen në Mitrovicë realizohet nëpërmjet të transportit të organizuar nga vetë policia e UNMIK-ut i cili nisët nga stacioni i policisë dhe gjykata që ndodhet në jug të qytetit. Vizitat që i'u bëhen të paraburgosurve shqiptarë nga ana e avokatëve të tyre është e ndikuar përkohësisht nga incidenti i 8 prillit të vitit 2002. Përkundër disa ankesave, avokatët zakonisht e pranojnë se kanë mjaft kohë për t'i parë klientët e tyre dhe për të përgatitur mbrojtjen e tyre. Qendra burimore për përkrahje të mbrojtjes penalo-juridike (CDRC)<sup>38</sup> gjithashtu ofron transport të rregullt për avokatët minoritar, veçanërisht kur këta avokatë nuk posedojnë kohë të mjaftueshme për të kërkuar transport me përcjellje nga ana e policisë.

### III. STRUKTURAT PARALELE

Ekzistimi i gjyqeve paralele anëmbanë Kosovës vazhdon të ketë ndikim në qasjen në drejtësi nga ana e pjesëtarëve të pakicës serbe, dhe problemet siç janë përputhja e kompetencave dhe rreziku i dyfishtë edhe sot e kësaj dite dokumentohen nga ana e OSBE-së.<sup>39</sup> Njëra nga efektet e cila mëtohet të arrihet nëpërmjet të programit të UNMIK-ut për integrim gjyqësor do të jetë edhe ç'instalimi i njëkohshëm i gjyqeve paralele. Krijimi i gjykatave komunale dhe për kundërvatje në Zubin Potok dhe Leposaviq, do të forcojë jurisdikcionin e UNMIK-ut ndaj komunave veriore, ndërsa fenomeni i gjykatave paralele do të fillojë të zbehet. Punësimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit përkrahës për këto gjyqe do të bëhet në përpjestim të drejtë me përbërjen etnike të popullatës. Sipas kësaj, vetëm gjyqtarët serbë do të kenë mundësi të emërohen në gjyqet e reja të instaluar në veri. Gjithashtu pritët se integrimi i gjyqtarëve serb në gjykatën e Mitrovicë do të dobësojë sistemin paralel të gjyqeve në Zveçan.

Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë drejt heqjes së strukturave paralele, sidomos në largimin e "rojeve të urës" në pjesën veriore të Mitrovicës.<sup>40</sup> Disa nga anëtarët e këtij formacioni dyshohet të kenë qenë të përfshirë në një sërë frikësimesh dhe sulmesh kundër pjesëtarëve të grupeve të ndryshme etnike dhe vetëm një numër i vogël i këtyre rasteve është hetuar apo ndjekur penalisht në mënyrë efikase. Kjo periudhë raportuese pa një sërë ndjekjesh penale të inicuar kundër udhëheqësve apo anëtarëve të këtyre strukturave për siç pohohet kryerjen e veprave penale kundër KFOR-it dhe UNMIK-ut, përderisa hetimet ende janë në zhvillim e sipër. Më 2 korrik 2002 një serb i Kosovës, ish anëtar i strukturës së rojeve të urës, u shpall fajtor për dëmtimin e një automjeti të UNMIK-ut gjatë së cilës atij i'u shqiptua dënimi me kusht prej 1 vjetësh. Më 10 dhjetor 2002 një serb i Kosovës, ish anëtar i strukturës së rojeve të urës, u shpall fajtor për pjesëmarrjen në një sulm kundër një automjeti të KFOR-it, vepër kjo e cila rezultoi në lëndimin e ushtarëve gjatë natës ndërmjet 27-28 dhjetorit 2001. I pandehuri ishte dënuar me 8 muaj burg. Më 12 dhjetor 2002 një serb tjetër i Kosovës, udhëheqës i njërit nga divizionet e rojeve të urës, u shpall fajtor për vepër penale të pjesëmarrjes si udhëheqës në një tubim me qëllim të kryerjes së akteve të dhunshme, e cila ndërlidhet me trazirat që ndodhën në pjesën veriore të Mitrovicës më

<sup>38</sup> Një OJQ e themeluar nga OSBE-ja e cila ofron ndihmë për avokatët mbrojtës vendës të Kosovës.

<sup>39</sup> Lexo analizat juridike dhe vlerësimin mbi këto çështje në *Vlerësimin e nëntë të OSBE-së/UNHCR-SË mbi gjendjen e pakicave kombëtare në Kosovë - shtator 2001 deri në prill 2002* (mëtuje Vlerësimi i nëntë). Rastet tjera që ngërthejnë në veti rrezikun e dyfishtë janë vëzhguar nga ana e OSBE-së gjatë periudhës së tanishme të raportimit.

<sup>40</sup> Për informata tjera, referencë është raporti iformativ i OSBE-së mbi strukturat paralele të sigurisë në veriun e Mitrovicës të datës 31 maj 2002.

21 qershor 2000. Ai gjithashtu u shpall fajtor për posedim të paligjshëm të armëve dhe pjesëmarrje në tubim të organizuar me qëllim të kryerjes së akteve të dhunshme e cila ndërlidhet me trazirën e cila kishte ndodhur më 8 prill 2002. Të dyja këto trazira rezultuan në lëndime të policëve dhe dëme të pronës së UNMIK-ut. I pandehuri u dënua me gjithsejt 18 muaj burg.

### **PJESA 3: DISKRIMINIMI DHE QASJA NË SHËRBIMET THEMELORE**

Diskriminimi vazhdon të paraqes një pengesë të madhe në aftësinë e pakicave për të jetuar një jetë të arsyeshme në Kosovë. Siç shpjegohej në vlerësimin paraprak, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë,<sup>41</sup> me qëllim apo pa qëllim, diskriminimi parandalon pakicat nga qasja në shërbimet themelore, punësim, arsimim, dhe pengon krijimin e kushteve për një zgjidhje të drejtë sa i përket kthimit. Sa i përket kushteve të pakicave që duhet përmirësuar, praktikrat diskriminuese, veçanërisht ato të organeve qeveritare, duhet të identifikohen dhe eliminohen, dhe pjesëtarëve të pakicave duhet t'ju ofrohen mjete juridike efikase për të dresuar diskriminimin kundër tyre. Përkundër përparimit inkurajues të bërë në nivel politik drejt realizimit të këtyre qëllimeve që nga vlerësimi i kaluar, diskriminimi mbetet një realitet sidomos në aspektin praktik, për shkak se rekomandimet e nxjerra nga vlerësimi i kaluar nuk janë zbatuar fare. Për më tepër, mjetet juridike efektive duhet të krijohen, dhe praktikrat diskriminuese duhet të eliminohen. Në vend të kësaj, diskriminimi i reziston qasjes në shërbimet themelore dhe ashpërsohet me probleme të vazhdueshme të lirisë së lëvizjes dhe rënjosjen e strukturave paralele.

Megjithatë, janë arritur mjaft zhvillime pozitive gjatë periudhës raportuese, sidomos sa i përket zotimit politik drejt adresimit të çështjeve brengosëse që kanë të bëjnë me pakicat apo çështjet që janë të bëjnë me diskriminimin në nivel të vendim dhe politikë marrjes. Një shembull i mirë në këtë drejtim është puna e kryer dhe rezultatet e arritura në nivel të grupit punues të përbërë nga më shumë agjenci – Bordi këshilldhënës për komunitetet (BKK) – i cili ishte formuar në dhjetor 2001 për të ofruar udhëzime, këshilla dhe rekomandime për PSSP-në mbi mbrojtjen dhe integrimin e pakicave në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe ligjet dhe politikat jo diskriminuese.<sup>42</sup> BKK-ja vazhdon të hartojë politika mbi punësimin e pakicave në sektorin publik nëpërmjet të Grupit punues mbi punësimin e pakicave dhe ka qenë e përfshirë në promovimin e konceptit të Pakos së ligjeve antidiskriminuese. BKK-ja ka ofruar një forum nëpërmjet të të cilit do të identifikoheshin dhe formuloheshin politikat efektive në fushat tjera që kanë të bëjnë me gjendjen e pakicave kombëtare, mirëpo mbetet të lexoet se a do të shëndrrohen përpjekjet e tilla në veprime pozitive përmirësuese në kuadër të ministrive dhe drejtorateve përkatëse.

OSBE-ja konsideron se një hap i rëndësishëm në njohjen, eliminimin, dhe ofrimin e mjeteve efektive përmirësuese kundër praktikave të tilla diskriminuese është miratimi i një Pakoje të Ligjeve për antidiskriminimin, e cila ishte hartuar dhe propozuar fillimisht nga OSBE-ja të shërbejë si një model i legjislacionit i cili duhet të miratohet. Ky ligj ka tri funksione: (1) konsolidimi dhe sforcimi i ligjit ekzistues diskriminues duke e pruar atë në pajtim me standardet e tanishme evropiane kundër diskriminimit;<sup>43</sup> (2) promovimi i uniformitetit në gjykimin e rasteve

<sup>41</sup> Në këtë kontekst, diskriminimi i drejtpërdrejt mund të përshkruhet me situatën e cila ndodh kur një individ apo grupë e saj trajtohet në mënyrë më pak të favorshme në baza të përkatësisë etnike, përderisa diskriminimi i tërthortë i referohet politikave apo praktikave të cilat janë të disajnuara për të qenë të paanshme mirëpo të cilat në mënyrë efektive ndikojnë negativisht në një individ të veçantë apo grup të një përkatësie etnike, ndoshta për shkak të dështimit për të marrë parasysh rrethanat e veçanta të atij grupi.

<sup>42</sup> ABC(orig) - BKK-ja udhëhiqet nga Zëvendësi i Parë i PSSP-së përderisa funksioni i sekretarit kryhet nga ana e Zyrës së UNMIK-ut për kthimin dhe komunitetet (ORC). Anëtarësia e saj përfshin Zyrën e PSSP-së dhe kryesuesit apo zëvendës kryesuesit e Shtyllave të UNMIK-ut, përfaqësuesit e KFOR-it, UNHCR-së, UNICEF-it, OHCHR-së, WHO-së, IOM-it, OCHA-së, ICRC-së dhe Këshillit të Evropës. Bashkësia e OJQ-ve ndërkombëtare ka përcjellur me kujdes punën e këtij trupi nëpërmjet të delegatit të Alenancës për të Drejta dhe Tolerancë (ADT).

<sup>43</sup> Një konformitet i tillë paraleloet me nenin të Rregullores së UNMIK-ut 1999/1 e ndryshuar, “mbi autoritetin e administratës së përkohshme në Kosovë,” i 25 korrikut 1999 dhe kapitujt 3 dhe 4, të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9, “mbi Kornizën Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.”

për shumicën e formave të diskriminimit; dhe (3) ofrimi i mjeteve efektive përmirësuese për viktimat e formave të ndryshme të diskriminimit, sikurse edhe shqiptimi i sanksioneve efikase, proporcionale dhe bindëse për adresimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Pas miratimit të konceptit për posedimin e një ligji të tillë BKK-ja dhe Grupi punues mbi të drejtat e njeriut i përbërë nga më shumë agjenci që përfaqësojnë shtyllat e ndryshme të UNMIK-ut,<sup>44</sup> ky projekt i'u dorëzua zyrës së kryeministrit dhe Zyrës së këshilltarit ligjor të PSSP-së për konsideratë. Për momentin vetë Kryeministri i ka dhënë prioritet finalizimit të këtij ligji.

## I. QASJA E BARABARTË NË ARSIMIM

Në fushën e arsimit, që nga vlerësimi i kaluar, jemi dëshmitar të vetëm atyre zhvillimeve pozitive (përfshirë këtu edhe hartimi i politikave) të cilat shkojnë në drejtim të krijimit të një sistemi arsimor efikas i cili do të ishte në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për arsimimin e pjesëtarëve të pakicave.<sup>45</sup> Transportimi apo qasja fizike nëpër shkolla mbetet ende një çështje brengosëse si për nxënësit ashtu edhe për mësimmësuesit që vijnë nga rradhët e bashkësive të pakicave.<sup>46</sup> Përkundër rekomandimeve të bëra në Vlerësimin e kaluar, ende nuk është përpiluar apo zbatuar nga ana e UNMIK-ut apo Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në konsultim me policinë e UNMIK-ut, SHPK-në dhe KFOR-in, ndonjë plan gjithëpërfshirës i cili do të ofronte transportim të sigurtë për nxënësit e pakicave. Kjo mangësi nënkupton se për shkak të pengesave të vazhdueshme në lirinë e lëvizjes dhe në gjendjen e sigurisë, shumë ndënës të pakicave mbeten pa qasje të sigurtë dhe të qëndrueshme në arsimim, e cila gjë ka ndikim të drejtpërdrejt në ndarjen e bashkësive në baza etnike.<sup>47</sup> Me një dorëzim dhe decentralizim të përgjegjësive të tilla për transportim tek komunat, përcaktimi i standardeve/politikave të gjera kosovare mund të luajë rol kyç në ofrimin e këtij transportimi dhe do të sigurojë se fëmijët e të kthyerve të mundshëm do të gëzojnë qasje të arsyeshme në arsimim.<sup>48</sup>

### **Strukturat paralele të arsimit dhe efekti i tyre mbi të drejtën për arsimim**

Transportimi jo adekuat dhe jo i sigurtë dhe problemet tjera të përgjithshme të sigurisë përjetësojnë krijimin e një sistemi paralel të arsimit në zonat e banuara me serbë, dhe diskurajojnë përfshirjen e nismave për integrimin e pakicave në sistemin arsimor në Kosovë. Për shembull, prindërit serbë në Rahovec refuzuan t'i regjistrojnë fëmijët e tyre në një shkollë të përziera e cila ishte një nismë tejet e suksesshme<sup>49</sup> për shkak siç pohojnë ata të problemeve të sigurisë. Në një

<sup>44</sup> IPWGHR-ja është një grup punues i Komitetit mbikëqyrës për të drejtat e njeriut, i themeluar si një organ i nivelit të lartë të cilit i është dhënë mandati për të shqyrtuar legjislacionin dhe praktikën e UNMIK-ut për të parë se a janë në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut. IPWGHR-ja shqyrtoi dhe aprovoi ligjin si të pajtueshëm me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

<sup>45</sup> Lexo "Rekomandimet e Hagës përkitazi me të Drejtat për arsimim të pakicave kombëtare" të nxjerra në tetor 1996 nga një grup i ekspertëve ndërkombëtar me kërkesë të Komisionerit të Lartë të OSBE-së mbi pakicat kombëtare. Lexo fusnotën 27 të vlerësimit të nëntë. E drejta për qasje në arsimim garantohet në mënyrë të drejtpërdrejt me nenin 2, Protokollin 1 i KEDNj-së nëpërmjet të Kornizës Kushtetuese.

<sup>46</sup> Për një analizë të plotë të çështjeve të transportimit, lexoni vlerësimin e nëntë, paragrafet 45-49.

<sup>47</sup> Në regjionin e Prizrenit, kjo ka rezultuar më shumë në nxitjen e ndarjes në baza etnike sesa në integrim. Për shkak të mungesës së vazhdueshme të transportimit, zyrtarët në luginën e Zhupës apo rajonin e Gorës janë duke shqyrtuar mundësinë e ofrimit të mësimave satelit në nivel të shkollave të mesme për nxënësit boshnjak dhe ata goranë, përkundër kualitetit më të ulët të objekteve shkollore.

<sup>48</sup> Tërheqja e planifikuar graduale e KFOR-it dhe zvogëlimi i vazhdueshëm i policisë së UNMIK-ut e bën të domosdoshme hetimin e transferit të kësaj përgjegjësie SHPK-së.

<sup>49</sup> Për një diskutim më të plotë në lidhje me nismat për shkolla të përziera, ju lutem lexoni Vlerësimin e Nëntë, paragrafet 55-8. Të realizuara në një objekt të ri shkollor të ndërtuar nga në një lokacion ndërmjet zonës së banuar me popullatën shumicë dhe lagjeve të banuara me pjesëtarë të pakicave, kjo nismë për

përpjekje për të adresuar sistemin paralel të arsimit dhe identifikimin e zgjidhjeve për standardet e përbashkëta arsimore dhe integrimin e bashkësive, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe simotra e saj në Beograd janë angazhuar në diskutime, mirëpo edhe përkundër këtyre diskutimeve nuk është shënuar ndonjë përparim i dukshëm.

### **Arsimimi në gjuhën amtare**

Vetëm disa përmirësime të kufizuara dhe jo sistematike në qasjen në arsimimin në gjuhën amtare kanë ndodhur që nga përpilimi i Vlerësimit të kaluar dhe çdo përparim i shënuar ishte falë nismave në nivel lokal. Edhe pse e drejta e çdo personi i cili i përket një pakice për të mësuar në gjuhën amtare paraleloet qartë edhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut sikurse edhe në Kornizën Kushtetuese të Kosovës,<sup>50</sup> asnjë udhëzim mbi politikën që duhet zhvilluar në nivel qendror nuk është nxjerrur apo zbatuar në këtë çështje. Kjo duket të ketë kontribuar në qasjet e ndryshme në arsimim të cilat mbretërojnë në vendet e ndryshme anembanë Kosovës. Për shembull, MASHK-ja ende pritet të jap përgjigjen e saj në kërkesën e bërë nga bashkësia romë në Prizren më 12 shtator 2002 për arsimimin, kulturën dhe historinë në gjuhën romë në vitin e fundit të shkollës së mesme. Sidoqoftë, fëmijët romë në Mitrovicë të cilët shkojnë në kopshte të fëmijëve apo institucione tjera parashkollore kanë mundësi të mësojnë në gjuhën romë si pjesë e programeve të sponsoruara nga OJQ-të e ndryshme ndërkombëtare. Pakica turke në qytetin e Prizren-it, mund të ndjekin mësimet në gjuhën amtare si në nivel të shkollave fillore gjithashtu edhe të atyre të mesme. Së këndejmi për të gjithë ata pjesëtar të pakicës turke të cilët dëshirojnë t'i ndjekin mësimet në nivelin e arsimimit superior dhe të cilët dëshirojnë të bëhen mësues, Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës nuk ofron klasë as në gjuhën turke e as në atë serbokroate. Mos ofrimi i një opcioni të tillë do të ndikojë në vetë arsimimin në gjuhën turke si në nivel të shkollës fillore ashtu edhe në atë të shkollave të mesme.<sup>51</sup>

Në të vërtetë, përderisa gjendja me të cilën përballet bashkësia boshnjake në komunën e Gjakovës ilustron, se pamundësia e pjesëtarëve të pakicave që të gëzojnë qasje në arsimim në gjuhën e tyre amtare do të mund të rezultojë në një asimilim të detyruar. Në kohën kur është përpiluar vlerësimi paraprak, prindërit boshnjak nuk kishin shprehur gatishmëri t'i dërgojnë fëmijët e tyre të cilët nuk flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe në shkolla shqipe, duke e argumentuar këtë me faktin se kjo do të ndikojë negativisht në arsimimin e tyre. Në anën tjetër, as arsimimi në gjuhën serbokroate nuk ishte në dispozicion. Nuk është vërejtur asnjë përparim gjatë periudhës raportuese në fjalë. Sipas një përfaqësuesi boshnjak, nuk ishte arritur koncensus sa i përket arsimimit në gjuhën serbokroate, duke pasur parasysh kufizimet në resurse dhe numrin e vogël të nxënësve. Në vend të kësaj, prindërit duket të kenë pranuar arsimimin në gjuhën shqipe, duke e arsytuar atë se ajo do të përmirësojë gjasat e tyre për punësim në të ardhmen.

Në përgjithësi, qasja në arsimim në gjuhën amtare të pakicave mbetet një çështje sporadike anembanë Kosovës. Mungesa e përmirësimeve të dukshme qoftë në nivel të politikave gjithashtu edhe në atë të praktikave të zhvilluara ende ekziston dhe si e tillë mund të pengojë edhe mëtutje mundësinë e fëmijëve minoritar që të gëzojnë qasje në arsimim. Për më tepër, kjo do të ketë ndikim të madh në arritjen e kushteve për kthim.

---

momentin ngërthen në veti një pjesëmarrje aktive të 392 nxënësve shqiptar, rom dhe egjiptas pa shfrytëzuar masa rigorozë të sigurisë, siç janë përcjelljet.

<sup>50</sup> Lexo kapitullin 4, neni 4.4 i Kornizës Kushtetuese i cili thotë se: Bashkësitë dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për "... (b) arsimim në gjuhën e tyre amtare." Lexo fusnotën 33, Vlerësimi i nëntë.

<sup>51</sup> Njëzet e tre (23) nga gjithsejt 46 mësime të cilët flasin turqisht në Kosovë janë të moshës mbi 60 vjeçare dhe janë gati të dalin në pension.

## **Nevojat e veçanta arsimore për bashkësitë RAE**

MASHK-ja nuk ka hartuar ndonjë plan gjithëpërfshirës për adresimin e nevojave të veçanta arsimore të pjesëtarëve të bashkësive RAE, e cila gjë ishte avokuar mjaft nga vlerësimi paraprak.<sup>52</sup> Në vend të kësaj, plotësimi i nevojave arsimore të bashkësive RAE mbetet në varësi të nismave të ndërmarra nga organizatat ndërkombëtare dhe ato joqeveritare, të cilat vetëm në raste të caktuara gëzojnë përkrahje nga ana e MASHK-së. Në regjionin e Mitrovicës, kopshtet e fëmijëve dhe institucionet parashkollore të cilat janë krijuar dhe veprojnë nën mbikëqyrjen e OJQ-ve në vendbanimet e romëve kanë shtuar numrin e fëmijëve rom të cilët i ndjekin mësimet e tyre nëpër shkolla filllore. Një shkollë verore dymujore e dedikuar për 36 fëmijë ashkalinjë të moshës prej 6 deri në 14 vjet ka dhënë rezultate të ngjashme. Organet qeveritare janë të përfshira në inicimin e orëve mësimore “shtesë” për fëmijët RAE në qytetin e Prizrenit dhe në Suharekë/Suva Reka me qëllim të integritit të studentëve në shkolla filllore dhe në shkollën e mesme teknike në veçanti. Krahas kësaj, pas intervenimit të OSBE-së, Zyra e UNMIK-ut për zhvillim të arsimit në Prizren regjistroi 17 fëmijë RAE nëpër shkollat përkatëse. Përkundër këtyre përpjekjeve që vlejné të lavdërohen, MASHK-ja nuk ka arritur të plotësojë nevojat arsimore të fëmijëve në mënyrë sistematike dhe koherente.

## **II. QASJA E BARABARTË NË PUNËSIM**

Vlerësimi i kaluar përqëndrohej më shumë në natyrën fundamentale të të drejtës për qasje në punësim, për shkak se ndikon në çështjen se a do të vendos një pjesëtar i pakicave të qëndrojë apo kthehet në Kosovë. Kjo gjithashtu përputhet edhe me faktorë të tjerë, siç janë siguria dhe liria e lëvizjes, aftësia për të komunikuar në gjuhën e shumicës dhe praktikatat tjera diskriminuese.<sup>53</sup> Gjerësa qasja në sektorin privat të punësimit nuk është diskutuar gjërësisht në këtë pjesë, qasja e kufizuar e pakicave në këtë sektor është shqetësuese. Pas miratimit të Pakos së ligjeve antidiskriminuese, pritet që diskriminimi në këtë sektor të adresohet si duhet.

Një fushë kryesore në të cilën janë përqëndruar shumica e politikave të nivelit qëndror është edhe ajo e qasjes së pakicave në punësim në sektorin publik.<sup>54</sup> Edhe pse sektori publik paraqet burimin kryesor të punësimit për pakicat në Kosovë, ky sektor për momentin punëson më pak se një përqind të pjesëtarëve të bashkësive të pakicave.<sup>55</sup> Përpjekjet e ndërmarra kohëve të fundit janë të përqëndruara në zbrapsjen e praktikave diskriminuese të punësimit në kuadër të sektorit publik. Në veçanti, Grupi punues i BKB-së mbi punësimin e pakicave<sup>56</sup> ka ndihmuar shumë zyrën e Kryeministrit në hartimin e një programi të diskriminimit pozitiv për IPV-të dhe ka inkurajuar në masë të madhe zbatimin e ligjit mbi Shërbimin Civil në Kosovë, Regulloren e UNMIK-ut 2001/36.<sup>57</sup> Deri më tani, këto përpjekje kanë ngecur paksa, dhe ato përshkohen vetëm disa përmirësime të vogla në qasjen e pakicave në punësim si në nivel qëndror ashtu edhe në atë të komunave.

Një rekomandim i Vlerësimit paraprak ishte edhe promovimi i politikave të diskriminimit pozitiv në praktikatat e punësimit nga ana e Ministrisë së Shërbimeve Publike.<sup>58</sup> Kah fundi i qershorit

<sup>52</sup> Për një analizë më të plotë të këtyre nevojave, ju lutem lexoni Vlerësimin e nëntë, para. 64-8.

<sup>53</sup> Lexo paragrafet 69-76 të Vlerësimit të Nëntë.

<sup>54</sup> Qasja në punësimin në sektorin privat nuk është e shtjelluar fare në këtë pjesë. Pritet që diskriminimi në punësimin në kuadër të sektorit privat do të adresohet nëpërmjet Pakos së Ligjeve mbi Antidiskriminimin.

<sup>55</sup> “Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë” (Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi UNMIK-un), i 13 janarit 2003, para.33.

<sup>56</sup> Grupi Punues është krijuar nga BKB-ja dhe ka për detyrë të nxjerr rekomandime të posaçme për IPV-të dhe UNMIK-un mbi atë se si duhet përmirësuar qasjen në punësim për pjesëtarët e bashkësive të pakicave.

<sup>57</sup> E nxjerrë më 22 dhjetor 2001.

<sup>58</sup> Lexo rekomandimin e parë nën “Punësimin”, Vlerësimi i Nëntë.

2002, një program i diskriminimit pozitiv për shërbimin civil, “Përfaqësimi proporcional i bashkësive etnike,” i cili ishte hartuar nga ana e Zyrës këshilldhënëse për mundësi të barabarta dhe barazi gjinore në kuadër të Kryeministrit, ishte miratuar në parim nga vetë PSSP-ja, Zyra e Kryeministrit dhe BKB-ja. Ky program propozon që shifrat e përfaqësimit proporcional duhet të përcaktohen për secilën bashkësi me qëllim të sigurimit të qasjes së barabartë të pakicave në punësimin në kuadër të sektorit publik. Kur të llogaritet, shifrat e përfaqësimit proporcional përcaktojnë përqindjen minimale dhe maksimale të punëtorëve të shërbimit civil për secilën bashkësi të pakicave e cila është e pranishme në kuadër të komunës përkatëse.<sup>59</sup> Duke shfrytëzuar shifrat e tilla si një udhëzim, programi është i dizajnuar që të nxis mekanizmat e brendshëm ndërkombëtar të cilët do të monitorojnë mënyrën e punësimit dhe do të vërtetojnë se a është dështuar në plotësimin e kuotës minimale dhe maksimale apo janë tejkaluar ato. Marrja e shënimeve të tilla për të përcaktuar shifrat (kuotat) e përfaqësimit proporcional, të cilat do të jenë të pranueshme nga të gjitha bashkësitë, është treguar të jetë mjaft e vështirë. Kjo gjendje ka kontribuar në ngecjen e procesit të zbatimit të këtij programi.<sup>60</sup> Së këndejmi, përkundër përkrahjes së fuqishme të dhënë në nivel qendror dhe pranimit të problemit të tillë si një problem kyç, për momentin nuk është duke funksionuar ndonjë program i diskriminimit pozitiv në kuadër të IPV-ve.

Megjithatë, është shënuar një përparim i dukshëm në këtë drejtim nëpërmjet të nxjerrjes së Urdhëresës Administrative 2003/02<sup>61</sup> e cila e zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë. Rregullorja 2001/36 parasheh kornizën e nevojshme ligjore për ndalimin me ligj të diskriminimit në kuadër të shërbimit civil,<sup>62</sup> përderisa Urdhëresa Administrative mundëson zbatimin e përfaqësimit proporcional të komuniteteve. Ajo përcakton procedurat e rekrutimit dhe kushtet e punësimit, sikurse edhe kodin e mirësjelljes dhe rregullat për procedurat disiplinore që mund të fillohen kundër nëpunësve civil. Urdhëresa Administrative është një hap i madh drejt promovimit të qasjes së barabartë në punësim për pjesëtarët e bashkësive të pakicave në kuadër të sektorit publik.

Pajtueshmëria me këto udhëzime që kanë të bëjnë me punësimin e pakicave në kuadër të shërbimit civil,<sup>63</sup> është rritur në masë të madhe në kuadër të IPV-ve, siç janë MASHK-ja (27%) dhe Zyra e Kryeministrit (16.5%). Ministrinë tjera siç është ajo për Ekonomi dhe Financa (0% e stafit minoritar; 28 nga 57 pozitat janë të plotësuar), janë ende shumë lag arritjes së pragut të

---

<sup>59</sup> Shifrat janë të llogaritura duke u bazuar në më shumë faktorë, duke përfshirë edhe shifrat e regjistrimit të popullsisë dhe rezultatet e votimit.

<sup>60</sup> Programi është hartuar me qëllim që të lansohet nëpërmjet të Urdhëresës Administrative për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36. Lexo pjesën vijuese për sqarime të mëtutjeshme. Duhet të ceket gjithashtu se Urdhëresa Administrative kërkon një Udhëzim Administrativ të lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike e cila përcakton procedurat dhe kriteret e mëtutjeshme për zbatimin e plotë të programit të diskriminimit pozitiv (Neni 10.3, i Urdhëresës Administrative).

<sup>61</sup> E nënshkruar nga PSSP-ja më 25 janar 2003.

<sup>62</sup> Neni 2.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 përcakton parimet e mosdiskriminimit, përfaqësimit të barabartë dhe multi-etnik, sikurse edhe trajtimin e barabartë të nëpunësve civil, si parime kryesore. Në shtojcën e kësaj rregullore janë të përcaktuara dispozitat e kodit të mirësjelljes të Shërbimit Civil, e cila përfshin parimet e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të drejtat e komuniteteve sikurse edhe kryerja në mënyrë të paanshme e punëve në kuadër të këtij shërbimi.

<sup>63</sup> Lexo Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë Kapitulli 4 (4.4): “Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për: (...) (d) gëzuar mundësi të barabarta sa i përket punësimit nëpër organet publike të të gjitha niveleve (...)” Lexo mëtutjue Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, Kapitulli 2 neni 2.1 (h): “Përfshirja: rekrutimi në të gjitha nivelet e Shërbimit Civil do të reflektojë karakterin multi-etnik të Kosovës dhe nevojën për një përfaqësim të barabartë të të gjitha komuniteteve në Kosovë.”



përcaktuar me Regulloren e UNMIK-ut 2001/19<sup>64</sup> për një nivel minimal të pranueshëm të punësimit të pakicave në nivel qendror. Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK-ja), e cila vepron nën shtyllën e dytë të UNMIK-ut mbi administratën civile, bën me dije se nga gjithsejt 3,775 të punësuar në kuadër të IPV-ve, vetëm 199 të punësuar janë me origjinë serbe, përderisa 80 janë me origjinë sllavo-muslimane, 47 janë turq, 22 vijnë nga rradhët e bashkësive RAE communities dhe 7 janë nga grupet tjera etnike. Këto shifra përbëjnë një shkallë të përfaqësimit jo të kënaqshëm të pjesëtarëve të bashkësive të pakicave në sektorin publik të punësimit në nivel qendror. Ato tregojnë se ka shumë pak dëshmi se secila ministri, duke përfshirë këtu edhe Ministrinë e Shërbimeve Publike, i ka përfillur rekomandimet e Kryeministrit të vitit 2002 për zbatimin e programit të Përfaqësimit Proporcional, apo se janë zbatuar masat për sigurimin e qasjes së barabartë në punësim në kuadër të administratave komunale.

Sa i përket punësimit të pjesëtarëve të pakicave në kuadër të strukturave komunale, shënimet e dorëzuara nga 23 komuna dhe të raportuara nga ZÇK-ja<sup>65</sup> tregojnë se në kuadër të shifrave të përgjithshme, 3,352 anëtar të stafit janë të punësuar nëpër komuna të ndryshme e kanë identifikuar vetën si serbë përderisa 1,014 prej tyre si pjesëtar të bashkësive të tjera<sup>66</sup>, përderisa 11,969 të punësuar janë shqiptar.

Megjithëse disa pjesëtarë të pakicave kanë gjetur punë në kuadër të sektorit publik, çështjet e sigurisë dhe restriksionet mbi lirinë e lëvizjes i kufizojnë mundësitë e punësimit të tyre në sektorin publik, dhe sidomos në atë privat. Serbët e Kosovës, megjithatë, janë kthyer në ambientet kryesisht rurale apo gjysëm rurale ku mund të merren me bujqësi, sa për të jetuar, varësisht nga qasja në tokën punuese<sup>67</sup>. Ata të cilët janë punësuar, kryesisht këtu e kanë arritur në sektorin publik, respektivisht në ambulancat lokale, shkollat lokale, SHPK, UNMIK apo përmes projekteve të gjenerimit të të ardhurave të financuara nga bashkësia ndërkombëtare, dhe të gjithë prej tyre brenda parametrave të sigurisë në kuadër të komunitetit apo fshatit të tyre. Për dallim nga kjo, të kthyerit romë, ashkali dhe egjiptas, kryesisht janë kthyer në rajonet urbane apo gjysëm urbane, kryesisht duke iu kthyer sektorëve ku kanë punuar para konfliktit, gjegjësisht ndërtimitarisë dhe tregëtisë<sup>68</sup>. Mirëpo asnjë nga këta të kthyer nga këto tri komunitete të pakicave por edhe të serbëve të Kosovës, nuk kanë mundur të kthehen në sipërmarrjet shoqërore<sup>69</sup>.

### III. QASJA E BARABARTË NË SHËRBIMET SOCIALE

Sistemi i shërbimeve sociale, e cila konsiderohej se mezi funksiononte gjatë vlerësimit të kaluar, vazhdon të veprojë si mëparë me shumë pak ndryshime. Qendrat për Punë Sociale (QPS-le) vazhdojnë të përballen me mungesën e aftësisë për të ofruar shërbime të plota nëpër zona të banuara me pakica, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të oficerëve për mbrojtje sociale të dedikuar për këto zona dhe mungesa e vullnetit tek punëtorët social të zonave të banuara me popullatë shumicë për të udhëtuar në rajonet e banuara me minoritar. Megjithatë janë shtuar

<sup>64</sup> Neni.4.2: “Anëtarët e Shërbimit Civil do të rekrutohen nga të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë në baza të kualifikimeve profesionale, të qenurit kompetent dhe meritës pas një konkurrimi të drejtë dhe të hapur. Përfaqësimi i bashkësive të pakicave në kuadër të përbërjes së Shërbimit Civil në të gjitha nivelet do të jetë në mënyrë të përafërt i barabartë me përfaqësimin e bashkësive të pakicave në kuvend.”

<sup>65</sup> ZÇK-ja, Profili Etnik i Stafit të paguar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nëpër komuna, dhjetor 2002.

<sup>66</sup> Bashkësitë tjera etnike përfshijnë boshnjakët e Kosovës, turqit, romët, ashkalinjtë, egjiptasit, goranët dhe kroatët.

<sup>67</sup> 82% të kthimeve të serbëve kanë ndodhur në rajonet rurale apo gjysëm rurale, me përjashtim të regjionit të Gjilanit dhe Prizrenit.

<sup>68</sup> Disa romë, ashkalinjtë dhe egjiptas të kthyer kanë përfituar nga projektet për gjenerimin e të ardhurave të financuara nga OJQ-të, por asnjë në kuadër të sektorit publik.

<sup>69</sup> Qasja ka qenë problematike në raport me Postën dhe telekomin e Kosovës (PTK) dhe KEK-un.

kontaktet ndërmjet punëtorëve të QPS-le që punojnë në zonat e banuara me popullatë shumicë dhe të atyre që punojnë nëpër enklava. Në disa raste, Oficerët për Komunitetet Lokale të UNMIK-ut kanë ndihmuar mjaft gjatë mbajtjes së mbledhjeve ndërmjet drejtorëve të QPS-le dhe punëtorëve social që vijnë nga enklavat ku janë diskutuar dhe shkëmbyer përvojat e ndryshme ndërmjet të kolegëve që punojnë zonat e banuara me popullatë shumicë.<sup>70</sup> Shembujt pozitiv të bashkëpunimit ndërmjet QPS-le që ndodhen në zonat e banuara me popullatë shumicë dhe të atyre që punojnë nëpër zonat e banuara me minoritar bazohen në nismat individuale të vetë zyrtarëve të QPS-le sesa si një pjesë e një strategjie të koordinuar e cila zbatohet si në nivel qëndror gjithashtu edhe në atë lokal. Në Rahovec, për shembull, QPS-ja ka një zyre në të ashtuquajturën “lagje të serbëve”. Personi i cili është përgjegjës për atë zyre, një serb i Kosovës, dhe Drejtori i QPS-së në Rahovec, shqiptar i Kosovës, kanë punuar si kolegë për një kohë të caktuar dhe disa herë në javë takohen për të koordinuar çështjet e ndryshme. Një bashkëpunim i veçantë ekziston edhe ndërmjet stafit të QPS-së i cili punon në pjesën jugore dhe atij që vepron në pjesën veriore të Mitrovicës.

Roli i Zyreve të Komuniteteve Lokale në ofrimin e qasjes së barabartë në ndihmën sociale për pjesëtarët e pakicave vazhdon të jetë qenësor. Në disa komuna ZKL-të janë përgjegjëse për realizimin e pagesave mujore të ndihmës sociale,<sup>71</sup> e cila në planin afatgjatë paraqet një zgjidhje jo të qëndrueshme. OSBE-ja pranon ankesa të shumta edhe nga punëtorët social të cilët veprojnë në zonat e banuara me minoritar në lidhje me nevojën e trajnimit të tyre mbi çështjet e mbrojtjes sociale, dhe kanë kërkuar vizita më të rregullta nëpër zyret e QPS-le të hapura në zonat e banuara me pjesëtarë të pakicave nga ana e drejtorit të QPS-së, e cila do të përmirësojë mekanizmat për ndërtimin e ekipeve dhe shkëmbimin e informatave në mesin e punëtorëve të QPS-së.

Vlerësimi i kaluar shtjellonte çështjen e sigurimit të resurseve adekuate për shërbimet mobile të qasjes. Gjendja në këtë drejtim është përmirësuar vetëm në mënyrë sipërfaqësore, duke pasur parasysh se kemi tri fshatra shqiptare në Zveçan, tri fshatra shqiptare të largëta në Leposaviq dhe zonat e izoluara në veri të Mitrovicës<sup>72</sup> të cilat vazhdojnë të jenë të mbuluara nga QPS-le të cilat ndodhen në jug të qytetit. Vizitat që janë bërë nga ekipet për qasje këtyre zonave janë të parregullta dhe kanë rezultuar në një numër të shqiptarëve të Kosovës të cilët janë detyruar të udhëtojnë për në pjesën jugore të qytetit për t’u regjistruar në kuadër të skemës për ndihmë sociale apo për të mbledhur pagesat mujore të ndihmës së tyre sociale. Gjendja është veçanërisht e vështirë për personat e paaftë apo të moshuarit të cilët nuk do të kenë mundësi t’i vizitojnë QPS-le. Si një shembull i resurseve të pakëta të cilat ndikojnë në punën e QPS-le në zyret e Graçanicës, ku tri punëtorë social të kësaj zyre e kanë vetëm një automjet dhe për shkak të kësaj janë në pamundësi të mbulojnë zonat rurale madje edhe ato urbane të kësaj komune. Gjendja u keqësua më tutje me ndalimin e vizitave shtëpiake të bëra nga punëtorët social në shtëpitë e minoritarëve që jetojnë në Prishtinë, pas përfundimit të programit të përcjelljeve nga ana e

---

<sup>70</sup> Në Skenderaj, drejtori shqiptar i QPS-së u takua me punëtorin social serb të punësuar në një fshat serb të Banjës dhe Suhogërlës.

<sup>71</sup> Për shembull, në fshatrat serbe të Banjës dhe Suhogërlës (Skenderaj), ZKL-ja mbledh paratë nga bankat në qytet dhe u’a dorëzon ato punëtorëve social serb që punojnë në fshat, të cilët mëpastaj janë përgjegjës për shpërndarjen e mëtutjeshme të pagesave. Në Vushtrri, ZKL-ja personalisht shpërndan pagesat mujore të ndihmës sociale, duke i vizituar përfituesit e kësaj ndihme që gjenden në zonat e banuara me pjesëtarë të pakicave në kuadër të komunës.

<sup>72</sup> Lipa, Boletini dhe Zhaha në komunën e Zveçanit; Koshutovës, Bistricës dhe Cerajë në komunat e Leposaviqit; Kodra e Minorëve, Mahalla e Boshnjakëve, Tri Kullat, Suhodolli i Ulët në Mitrovicën veriore.

KFOR-it.<sup>73</sup> Një shqetësim i veçantë është edhe zvogëlimi i numrit të vizitave të bëra nga ekipet mobile të QPS-le në fshatin Plemetin dhe kampin që gjendet në të. Madje edhe në Gojbulë, ku drejtori i QPS-së ka treguar një zotim të pashoq në dhënien e përkrahjes për pjesëtarët e pakicave, punëtorëve të QPS-së i'u mungon vullneti për të bërë vizita të rregullta mobile, për shkak se siç pohojnë ata serbët e Kosovës gëzojnë një liri më të mirë të lëvizjes në krahasim me vitin e kaluar dhe si rezultat i kësaj mund të vijnë vetë në QPS.

Sa i përket procesit të reregjistrimit në kuadër të skemës së ndihmës sociale (SNS), më parë ishte raportuar se pakicat ishin përjashtuar nga plotësimi i kërkesave për riaplikim<sup>74</sup> për shkak se QPS-le ende nuk e kanë aftësinë që të sigurojnë qasjen tek pjesët e ndryshme të popullatës, përderisa pjesëtarët e pakicave nuk kanë mundësi të shkojnë në QPS për shkak të problemeve të sigurisë. OSBE-ja vlerësoi me kujdes përmirësimet e përgjithshme të bëra nga QPS-le në ngritjen e vetëdijes në mesin e përfituesve të ndihmës sa i përket plotësimit të kërkesave për reregjistrim. Një numër i madh i pakicave duket se kanë dijeni për procedurën e aplikimit, përderisa QPS-le deklarojnë se kanë dhënë udhëzimet e duhura për procedurën e riaplikimit të gjithë përfituesve të ndihmës sociale. Megjithatë, një shqetësim i veçantë mbetet sa i përket rasteve të përfituesve që janë të izoluar nëpër shtëpitë e tyre të cilët nuk mundën të bazohen në vizitat shtëpiake nga punëtorët e QPS-le qoftë për shkak se jetojnë në zonat e banuara me pakica apo për shkak se vendndodhja e shtëpive të tyre është e panjohur për stafin e QPS-së. Një shembull pozitiv ku QPS-le kanë arritur të mbulojnë më mirë personat e reregjistruar në Prizren, ku pjesëtarët e pakicave të cilët nuk kanë mundësi të shkojnë në objektet e QPS-së trani vizitohen nga ekipet mobile. Asnjëra nga rekomandimet e vlerësimit të fundit se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është duke e monitoruar efektin e kërkesave të parashtruara për reregjistrim apo për eliminimin e praktikave të tërthorta diskriminuese, nuk është zbatuar gjër më tani.

Një zhvillim i rëndësishëm në fushën e qasjes në mirëqenien sociale është edhe realizimi i të drejtës për të shfrytëzuar gjuhën amtare gjatë qasjes në shërbimet e mirëqenies sociale.<sup>75</sup> MPMS-ja është në proces të përgatitjes së programit për të siguruar shenja uniforme për QPS-le anembanë Kosovës. Të gjithë formularët e QPS-le janë të shtypur në nivel qendror dhe u shpërndahen të gjitha zyreve komunale të QPS-le, duke lejuar një uniformitet sa i përket dokumenteve në gjuhët zyrtare në nivel lokal. Për shembull, në një QPS në pjesën jugore të Mitrovicës, shenjat si brenda ashtu edhe objektit janë të shtypura në gjuhën shqipe, serbokroate dhe angleze. Për më tutje, në Prizren, Dragash, dhe Rahovec, përfituesit e QPS-le i pranojnë informatat dhe vendimet si në gjuhën shqipe dhe serbokroate. Disponibiliteti i dokumenteve zyrtare dhe materialeve informative në gjuhët zyrtare është bërë një rregull në të gjitha QPS-le. Sidoqoftë, në Skenderaj QPS-ja e cila gjendet në një ndërtesë private, ka mbishkrimet në hyrje të ndërtesës vetëm në gjuhën shqipe dhe angleze, përderisa në Vushtrri, drejtori i kësaj qendre heziton të vendosë çfarëdo mbishkrimi në lokalet e kësaj qendre. Më tej, në Prizren, vetëm

---

<sup>73</sup> Sipas ZKL-së, është propozuar se ekipet e QPS-le do të bëjnë vizitat shtëpiake serbëve të Prishtinës, mirëpo ky propozim ishte refuzuar si nga punëtorët serb gjithashtu edhe ata shqiptarë, të cilët pohojnë se përfituesit e ndihmës sociale nuk do të ndihen mirë me këtë zgjidhje.

<sup>74</sup> Përfituesit e kategorisë së parë të ndihmës sociale duhet të reregjistrohen (dhe rikualifikohen) për ndihmë sociale çdo 6 muaj. Procesi i njëjtë zbatohet çdo tre muaj për përfituesit e kategorisë së II-të.

<sup>75</sup> Dispozitat kryesore të ligjit të zbatueshëm të cilat mbrojnë të drejtën për përdorimin e gjuhës amtare gjatë qasjes në shërbimet publike mund të gjinden në nenin 9.1, 9.3, dhe 9.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë. Këto dispozita janë në pajtim me paragrafet 2 dhe 3 të nenit 10 të Pjesës III të Kartës Evropiane për gjuhët rajonale apo të pakicave, e cila është e inkorporuar në kuadër të ligjit të zbatueshëm në Kosovë më përkatësisht në paragrafin 3.2 (g) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9. Dispozitat në fjalë gjithashtu janë në pajtim me nenin 10(2) të Konventës Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare.

materialet informative janë të shtypura edhe në gjuhën turke, e jo edhe kopjet e vendimeve dhe dokumenteve të tjera të shtypura në të kaluarën.<sup>76</sup>

#### IV. QASJA E BARABARTË NË KUJDESIN SHËNDETËSOR

E drejta për kujdes shëndetësor adekuat mbetet një çështje thelbësore për pakicat të cilat vazhdojnë të përballen me probleme sa i përket qasjes në objektet e kujdesit shëndetësor. Në fshatrat e ndryshëm të izoluar anembanë Kosovës, shkuarja në barnatore është e kufizuar edhe pse shpërndarja e barnave është përmirësuar. Siç është theksuar në vlerësimin e kaluar, niveli i ulët i vetëdijes vazhdon të ekzistojë sa i përket të drejtës për qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe listës së barnave të cilat ofrohen falas nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.<sup>77</sup>

Çështjet që kanë të bëjnë me mungesën e lirisë së lëvizjes dhe sigurisë vazhdojnë të pengojnë qasjen e pjesëtarëve të pakicave në kujdesin shëndetësor. Në veri të Mitrovicës, shqiptarët gëzojnë qasje në kujdesin shëndetësor nëpërmjet të zgjidhjeve tjera alternative pra siç është qasja në ambulancat e UNMIK-ut ku teknikët mjekësor janë në dispozicion çdo ditë përderisa pediatrët/mjekët janë të gatshëm të vizitojnë pacientët çdo javë. KFOR-i organizon transportimin për pacientët të cilët kërkojnë trajtim mjekësor në spital. Në Svinjarë, një fshat i përzier në pjesën jugore të Mitrovicës, qasja në kujdesin shëndetësor për bashkësinë serbe është e siguruar nëpërmjet të vizitave javore të bëra nga një mjek i KFOR-it grek. Propozimi për themelimin e një ambulate e cila do të vihej në shërbim të të dyja këtyre bashkësive etnike pret realizimin e saj që më shumë se një vit. Në Osojan, Qerkolez<sup>78</sup> dhe në Istog, kujdesi shëndetësor primar ofrohet nëpërmjet të ambulancave në të cilat punojnë një mjek i praksës së përgjithshme dhe një numër i infermiereve (të cilët paguhen nga Ministria e Shëndetësisë në Beograd). Në rastet kur kujdesi shëndetësor sekondar është i nevojshëm, KFOR-i spanjoll realizon përcjelljet e sigurisë për pacientët deri në spitalin në pjesën veriore të Mitrovicës. Pajisjet mjekësore të cilat janë në dispozicion në dy ambulancat janë të thjeshta me furnizime të pakëta të barnave. Në Shtime, 20 serbët e mbetur preferojnë më shumë të shkojnë në shtëpinë e shëndetit në Graçanicë sesa në ndonjë shtëpi të shëndetit në Shtime.

Që nga vlerësimi i kaluar, u vërejt se një sërë nismash janë ndërmarrë drejt ofrimit të zgjidhjeve monoetnike sa i përket problemeve të kujdesit shëndetësor për dallim nga ofrimi i kujdesit shëndetësor të integruar në Kosovë i cili do të ishte në gjendje t'ju shërbejë të gjithë pjesëtarëve të bashkësive të pakicave.<sup>79</sup> Për shembull, në veri të Mitrovicës kujdesi shëndetësor vazhdon të mbetet nën kontroll të Ministrisë së Shëndetësisë në Beograd përkundër pranisë së objekteve shëndetësore të UNMIK-ut ( me mjekët të cilët pranojnë nga dy paga nëse vizitojnë enklavat në jug). Një çështje brengosëse është perceptimi mbi mungesën e sigurisë të cilën e ka popullata shqiptare në komunat veriore dhe ajo serbe e cila jeton në komunat jugore, kur të vizitohen nga mjekët e përkatësisë tjetër etnike.

Problemet e posaçme me të cilat ballafaqohen bashkësitë RAE sa i përket qasjes në kujdesin shëndetësor mbeten ende një çështje e cila duhet trajtuar me kujdes. Në Mitrovicë, bashkësia rome banon nëpër kapme, të cilat ndodhen në një distancë të caktuar nga ambulancat më të

<sup>76</sup> Lexo nenin 9.5 të Rregullores 2000/45, "Statuti i komunës do të hartojë dispozitat e detajuara për përdorimin e gjuhëve të bashkësive etnike siç paralexohen me këtë nen, duke marrë parasysh përbërjen e bashkësive etnike në kuadër të komunës." Një ekzaminim i detajuar i statuteve të komunave tjera tregon për një shkallë të ulët të pajtueshmërisë së tyre me këtë dispozitë.

<sup>77</sup> Udhëzimi Administrativ 9/2000 i Departamentit të UNMIK-ut për Mjedisin dhe Planifikimin Hapësinor.

<sup>78</sup> Osojani është një zonë ku është realizuar kthimi i organizuar. Që nga fillimi i verës 2001, përafërsisht 300 serbë janë regjistruar aty. 85 serbë jetojnë në enklavën e Cërkolezit.

<sup>79</sup> Lexo paragrafin 85, Vlerësimi i nëntë.

afërta<sup>80</sup> dhe madje edhe atëherë kur ata kanë qasje në kujdesin shëndetësor, shumica prej tyre nuk kulifikohen për ndihmë mjekësore për shkak se nuk posedojnë me dokumentacionin e kërkuar apo librezat shëndetësore. Numri i pjesëtarëve RAE të cilët shkojnë nëpër spitale apo shtëpi të shëndetit për të kërkuar ndihmë mjekësore mbetet i vogël,<sup>81</sup> edhe në raste të sëmundjeve të rënda. Për shembull, gjatë kryerjes së ekzaminimeve mjekësore për fëmijët ashkalinjë të cilët duhet të reregjistrohen nëpër shkolla, mjekët arritën përfundimin se 5 nga 8 fëmijët ashkalinjë lëngojnë nga sëmundjet ngjitëse. Sa i përket gjendjes së veçantë në të cilën gjenden bashkësitë RAE të cilat banojnë në kampin në Plementin<sup>82</sup>, e cila mëparë raportohej si e paqëndrueshme,<sup>83</sup> ajo është përmirësuar me hapjen e ambulantave përkatëse në atë kamp. Ambulanta ofron shërbime ditore të kujdesit shëndetësor nga infermieret, dhe kujdes dhëndetësor i cili ofrohet një herë në javë nga mjeku i praksës së përgjithshme dhe mjekët specialistë. Sa i përket kujdesit shëndetësor sekondar, pacientët dërgohen në shtëpinë e shëndetit në Obiliq apo në spitalin e Prishtinës, me transportin i cili sigurohet nga ambulatat e shtëpisë së shëndetit në Obiliq apo nga Komiteti Amerikan për Refugjatë (KAR).<sup>84</sup> ZKL-ja në Obiliq raportoi se pjesëtarët RAE të kampit të Plementinit e ndiejnë vetën më të sigurtë të shkojnë në shtëpinë e shëndetit në Obiliq apo të kërkojnë ndihmë mjekësore nga ambulanta e kampit. Vlerësimi paraprak i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë të sigurojë informata të mjaftueshme sa i përket kujdesit shëndetësor nëpërmjet të fushatës për ngritjen e vetëdijes për bashkësitë RAE. Megjithatë, gjer më tani nuk është zhvilluar ndonjë fushatë për ngritjen e vetëdijes, përderisa Karta për të drejtat e pacientëve, e sponsoruar nga vetë Ministria e cila ngërthen në veti një dispozitë mbi “ofrimin e kujdesit shëndetësor pa diskriminim”, mbetet ende në formën e projektit (draftit).

Një çështje shtesë, e cila nuk është mbuluar nga vlerësimet e kaluara, është edhe qasja në shëndetësi e personave të paaftë që vijnë nga rradhët e pakicave. Problemet e formës siç janë objektet e pazhvilluara të kujdesit shëndetësor të cilat janë në dispozicion për këta pjesëtarë të pakicave edhe më tepër rriten për shkak të mungesës së rampave, ashensorëve, dhe toaletëve për personat e paaftë.<sup>85</sup> Vizitat shtëpiake nga mjekët nuk janë bërë një praktikë e zakonshme, dhe së këndejmi nga personat e paaftë kërkohet që të kenë edhe një shoqërues me veti në rastet kur udhëzohen për të kërkuar ndihmë mjekësore shtesë në spital apo institucionet tjera shëndetësore.

Një përmirësim nga vlerësimi i kaluar është edhe përdorimi i gjuhës amtare gjatë qasjes në kujdesin shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë ka shpërndarë rregulloren e zbatueshme dhe qarkoren informative (6/2002) mbi përdorimin e gjuhëve në objektet e kujdesit shëndetësor të gjithë drejtorëve të spitaleve dhe shtëpive të shëndetit në Kosovë.<sup>86</sup> Megjithatë, zbatimi i

---

<sup>80</sup> Kampi Zhitkovac gjendet diku rreth 3 km larg ambulantës në Zveçan; përderisa qendra kolektive në Banjskë gjendet 15 km larg nga po e njëjta ambulantë. Kampi i romëve në është rreth 1 km larg ambulantës komunale. Në kampin rom në Mitrovicë sapo është hapur një ambulantë.

<sup>81</sup> Kjo informatë është e bazuar në shënimet e mbledhura nga OSBE-ja gjatë intervistave me pjesëtarë të ndryshëm të bashkësive RAE, nga mbledhjet e mbajtura me zyrtarë shëndetësor apo me organizatat vendëse dhe ato ndërkombëtare.

<sup>82</sup> Në kampin e Plementinit banojnë rreth 150 familje, 60% prej të cilëve janë ashkalinjë, 32% romë dhe 8% serbë apo grupe të tjera të vogla etnike. Standardi jetësor i këtyre njerëzve është tejet i ulët përderisa këta njerëz janë shumë rë varur nga ndihma dhe përkrahja e jashtme.

<sup>83</sup> Lexo paragrafin 85 të Vlerësimit të Nëntë.

<sup>84</sup> Një OJQ ndërkombëtare mbikëqyr me punën e këtij kampi.

<sup>85</sup> Në spitalin e Prishtinës, për shembull, vetëm njësisia e emergjencës dhe ajo e maternitetit kanë kalime të veçanta për karrocet e invalidëve.

<sup>86</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/10 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale thekson në nenin 2(a) se “Departamenti mund të bëjë rekomandime mbi hartimin e politikave Këshillit të Përkohshëm Administrativ nëpërmjet të Zëvendësit të PSSP-së për Administratë Civile përkritazi me, inter alia: (a) strategjinë e përgjithshme për zhvillimin e një kujdesi shëndetësor dhe

paqëndrueshëm i politikës mbi përdorimin e gjuhëve,<sup>87</sup> arsyetohej nga ana e drejtorëve me mungesën e nxitjes së rrezikut që mund t'i kërcënohet zyrtarëve shëndetësor apo dëmtimin e pronës dhe mungesën e resurseve dhe njohurive mbi procedurat përkatëse. Objektet e kujdesit shëndetësor primar në vendet si në Prizren, Dragash dhe Rahovec janë shembuj të zbatimit të paqëndrueshëm të legjislacionit të zbatueshëm mbi përdorimin e gjuhëve në shërbimet publike. Në Dragash, mbishkrimet informative janë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe atë serbe, përderisa dokumentet e hartuara janë në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe. Në Rahovec, zyrtarët shëndetësor sapo kanë filluar me zbatimin e përdorimit të gjuhës serbe në objektet e kujdesit shëndetësor primar. Në Prizren, Drejtori i Drejtoratit për Shëndetësi përkrah në mënyrë të vazhdueshme përpjekjet e OSBE-së për zbatimin e përdorimit të gjuhës serbe dhe turke në shtëpitë e shëndetit, krahas asaj shqipe, mirëpo asnjë rezultat pozitiv nuk është arritur gjer më tani. Në spitalin e Prizrenit, përderisa shumica e mbishkrimeve janë në gjuhën shqipe dhe atë serbe, dokumentet fillestare shtypen vetëm në gjuhën shqipe. Drejtori në fjalë theksoi se pritet të shtypen dokumentet e reja në gjuhën shqipe dhe sebe, mirëpo përkundër këtij zotimi shumë pak është arritur sa i përket përdorimit të gjuhës turke. Në Mitrovicë, është shënuar një përparim shumë i vogël në komunikimin e shkruar në kuadër të objekteve të kujdesit shëndetësor primar si në pjesën veriore ashtu edhe në atë jugore të qytetit.

---

mirëqenie sociale jodiskriminuese, efikase, transparente dhe të përgjegjshme në Kosovë, i cili do të respektojë dinjitetin njerëzor dhe do të adresojë nevojat e grupeve të rrezikuara të popullatës dhe personave të tjerë në kuadër të popullatës të cilët mund të jenë të rrezikuar.”

<sup>87</sup> Sipas zyrtarëve shëndetësor, qendra e re e shëndetit mental në Mitrovicën jugore ka të gjitha komunikimet e shkruara përfshirë këtu edhe mbishkrimet dhe formularët e shtypur dhe materialin tjetër informativ si në gjuhën shqipe gjithashtu edhe në atë serbe.

## **PJESA 4: TË DREJTAT PRONËSORO-BANESORE**

Si një prej parakushteve për kthimi të qëndrueshëm të pakicave në Kosovë, është ai që pjesëtarët e këtyre bashkësive duhet të jenë në gjendje të realizojnë të drejtat e tyre pronësore.<sup>88</sup> Realizimi efektiv i të drejtave pronësore kërkon ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga shteti (në Kosovë, veprimet këto të cilat bëjnë pjesë në kuadër të detyrimeve të UNMIK-ut dhe organeve të saj përkatëse, sikurse edhe të IPV-ve dhe subjekteve të saj përkatëse), të cilat do të bartin me veti implikime si në nivelin politik gjithashtu edhe në atë buxhetor. Edhe pse realizimi i pamjaftueshëm i të drejtave pronësore i cili ndërlidhet me çështjet që kanë të bëjnë me qasjen në pronë apo mekanizmat ankimor, organet përkatëse kanë detyrim pozitiv të sigurojnë këtë qasje si nëpërmjet të reformave legjislative gjithashtu edhe nëpërmjet të veprimeve ekzekutive/zbatuese.<sup>89</sup> “Qasja” mund të definohet si një aspekt i cili në veti ngërthen tri fusha kryesore: vetëdijësimin për të drejtat ligjore, qasja fizike në organet përkatëse gjyqësore dhe ekzekutive, dhe përfundimisht, pasi që të fitohet qasja fizike, kemi edhe aftësinë e organeve përkatëse për të siguruar realizimin e këtyre të drejtave.

### **I. DREJTORATI PËR ÇËSHTJE PRONËSORE DHE BANESORE (DÇPB) DHE KOMISIONI PËR ANKESA DHE PARASHTRESA PËR ÇËSHTJE BANESORE DHE PRONËSORE (KAPÇB)**

Njëra prej pengesave kryesore në procesin e kthimit dhe mbojtjen e pakicave është edhe qasja në pronat e tyre banesore, apo të “shtëpive të tyre”.<sup>90</sup> Komisioni për ankesa dhe parashtresa për çështje banesore dhe pronësore (KAPÇB) dhe Drejtorati (DÇPB) ishin themeluar me qëllim të rikthimit dhe vërtetimit të të drejtave pronësoro-banesore, të cilat ose ishin humbur si rezultat i diskriminimit apo forcës apo kishin mbetur në pronësi të paqartë për shkak të transaksioneve joformale.<sup>91</sup> Në bazë të mandatit të tyre, DÇPB-ja dhe KAPÇB-ja kanë autoritet që të bijnë vendimet për dëbimin e uzurpuesve të paligjshëm të pronës dhe për kthimin e të drejtave pronësore bartësve ligjor të këtyre të drejtave (qoftë pronarëve, poseduesve, apo bartësve të drejtës për banim).

Mandati i DÇPB-së dhe KAPÇB-së në lidhje me okupimet e kundërligjshme<sup>92</sup> është posaçërisht kritik për kthimin e qëndrueshëm të pakicave. Në veçanti brenda rajoneve urbane, është okupuar në mënyrë të kundërligjshme një pjesë e konsiderueshme e pronave të pakicave të zhvendosura, çofshin ato shtëpi apo banesa, pjesërisht edhe për qëllim të parandalimit të kthimit të tyre. Një numër i atyre që i kanë okupuar këto prona nuk i kanë braktisur ato edhe pse ndihmën për

<sup>88</sup> Të drejtat pronësore janë një grup i të drejtave duke përfshirë këtu edhe të drejtën për të qenë pronar, për të shitur dhe shfrytëzuar pronën. Ato janë të pranura edhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt janë të zbatueshme në Kosovë. Lexo, për detaje të mëtutjeshme, raportet e OSBE-së mbi Gjendjen Pronësore në Kosovë, janar 2001 dhe shkurt 2002. Lexo gjithashtu Vlerësimin e nëntë, faqet 30-38.

<sup>89</sup> Lexo *Airey kundër Irlandë*, 6289/73, 10 shtator 1979, paragrafi 32-33, *Blentiç kundër Republikës Serbe*, CH/96/17, 5 nëntor 1997, paragrafi 25.

<sup>90</sup> Lexo *Kevesheviq kundër Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës*, CH/97/46, 10 shtator 1998, paragrafi 42 dhe *M.J kundër R.S.*, CH/96/28, 7 nëntor 1997, paragrafi 32 i cili mbështet faktin se e drejta për kthim në shtëpi përfshin si të drejtën pronësore (Neni 1, Protokollin I, KEDNj-ja) dhe e drejta për të pasur shtëpi/vendbanim (Neni 8, KEDNj). Lexo gjithashtu *Qipron kundër Turqisë* (25781/94), 10 maj 2001.

<sup>91</sup> Neni 1.2, Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23.

<sup>92</sup> Duhet të theksohet se disa okupime të kundërligjshme (“të pronës) mund të bijnë jashtë kompetencave të DÇPB-së, pra në kompetencë të gjykatave të rregullta.

rindërtim e kanë pranuar<sup>93</sup>. Në kuadër të mandatit të tyre DÇPB-ja dhe KAPÇB-ja, luajnë rolin crucial në lehtësimin e kthimeve të pjesëtarëve të pakicave nëpër shtëpitë e veta<sup>94</sup>. Prandaj për shkakun se shumë pakica vuajnë nga okupimi i kundërligjshëm i pronave banesore të tyre, vetëdijësimi mbi qasjen fizike në DÇPB dhe KAPÇB dhe operacionet efikase të tyre, janë elementet kryesore për mbrojtjen efikase të pakicave dhe të drejtave të tyre pronësore por edhe të lehtësimit të kthimit të tyre të qëndrueshëm<sup>95</sup>.

OSBE-ja pranon përparimin e shënuar nga DÇPB-ja dhe KAPÇB-ja që nga vlerësimi i kaluar si në aspektin e zgjerimit të aktiviteteve të tyre gjithashtu edhe në ndarjen e resurseve përkatëse. Përkundër këtij përparimi të qartë, i cili është mëse i dukshëm sidomos tani nën udhëheqësinë e re të DÇPB-së dhe KAPÇB-së, niveli i vetëdijësimit tek bashkësitë e pakicave dhe qasja fizike në mekanizmat e DÇPB-së dhe KAPÇB-së mbetet ende i paqëndrueshëm dhe në disa aspekte edhe jo adekuat.<sup>96</sup> Për shembull, qasja e personave të zhvendosur të cilët jetojnë jashtë Kosovës duken të jetë përmirësuar që nga vlerësimi i kaluar. Në Mal të Zi, është hapur një zyrë fushore satelite dhe janë krijuar ekipet mobile për të pranuar ankesat, ndërsa zyret fushore të cilat veprojnë në Beograd, Nish dhe Kraljevë të Serbisë do të mbeten të hapura deri në dhjetor 2002. DÇPB-ja gjithashtu ndërmorri një fushatë të vetëdijësimit me qëllim të informimit të opinionit publik mbi zgjatjen e afatit për parashtrim të kërkesave pranë këtij trupi. Parashtruesit e kërkesave jsh të Kosovës gjer më tani kanë parashtruar 15,615 ankesa (66% i numrit të përgjithshëm të ankesave të parashtruara), duke bërë me dije se personat e zhvendosur jashtë Kosovës për momentin gëzojnë një qasje të përmirësuar dhe një njohuri më të mirë në lidhje me mekanizmat në dispozicion që nga vlerësimi i kaluar.<sup>97</sup> I tillë ishte edhe rasti në Mal të Zi, kur pas fillimit të veprimit të DÇPB-së në këtë vend 1,692 ankesa ishin parashtruar vetëm gjatë 6 muajve të fundit. Së këndejmi, kufizimet në resurse mund të stopojnë këtë përparim edhe gjetiu. DÇPB-ja pritet të hapë një zyre edhe në IRJM për të mbledhur ankesat kryesisht nga refugjatët RAE.<sup>98</sup> Për këtë arsye, përderisa jemi dëshmitar të përmirësimeve të arritura në qasjen fizike dhe vetëdijësimin e personave të zhvendosur në Kosovë, mungesa e resurseve njerëzore dhe fizike për DÇPB-në vazhdon të cungojë realizimin e të drejtave pronësoro-banesore.

---

<sup>93</sup> Partnerët implementues dhe komunat nuk kanë mundësi të sigurojnë që ata të cilët kanë pranuar ndihmën për rindërtim të lirojnë ato prona. Në fshatin Potok të Podujevës, përfaqësuesi i fshatit i ka raportuar OSBE-së se shtatë përfitues të kësaj ndihme asnjëherë nuk kanë hyrë në shtëpitë e tyre të rindërtuara. Në qytetin e Prizrenit, shumë përfitues vazhdojnë të okupojnë ilegalisht pronën, përkundër pranimit të ndihmës për rindërtim. Disa shqetësime janë ngritur në GPK të Lipjanit ku tetë familje shqiptare të cilat kanë pranuar ndihmën për rindërtim për fshatin Dobrajë e Vogël ende mëtojnë të qëndrojnë si të zhvendosur në Plemetin dhe të mos kthehen.

<sup>94</sup> Në kontekst të dëbimit pas pranimit të ndihmës për rindërtim, marrëveshja tripartite përmes së cilës udhëzimet e UNMIK-ut për rindërtim të shtëpive 2002, obligojnë lejimin e ndihmës për rindërtim me obligimin e përfituesit të liroj pronën e okupuar një muaj pas përfundimit të rindërtimit. Marrëveshja tripartite riafirmon kompetencat e DÇPB-së dhe thekson në nenin 8 se nëse përfituesi nuk e liron pronën, komisionin mund të nxerrë urdhërin për dëbim. Nëse përfituesi nuk e merr në posedim shtëpinë e ridnërtuar, neni 8 gjithashtu e autorizon DÇPB-në që atë pronë ta vendosë nën administrim të saj dhe ta ndajë për shrytëzim të përkohshëm deri në atëherë kur përfituesi e lajmëron DÇPB për qëllimin e tij/saj për t'u kthyer.

<sup>95</sup> Për vlerësimin e operacioneve të DÇPB/KAPÇB-se, lexo Vlerësimin e nëntë.

<sup>96</sup> Gjatë periudhës raportuese, DÇPB-ja nuk hapi ndonjë zyre të re në Kosovë, mirëpo ruajti ato në Prishtinë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë. Deri më 4 shkurt 2003, kur u hap zyrja në Prizren, zyrja në Pejë mbulonte edhe regjionin e Prizrenit. DÇPB-ja ka 15 anëtar ndërkombëtar dhe 150 vendës.

<sup>97</sup> Në kohën e vlerësimit të kaluar, 6,726 ankesa ishin mbledhur jashtë Kosovës.

<sup>98</sup> Një marrëveshje ndërmjet DÇPB-së dhe UNMIK-ut mbi veprimin e një zyre të tillë ende mbetet ende në implementim e sipër.



Brenda Kosovës, niveli i vetëdijësimit dhe qasjes fizike të pjesëtarëve të pakicave në mekanizmat e DÇPB-së/KAPB-së nuk duket të jetë përmirësuar dukshëm që nga vlerësimi i kaluar. Numri i ankesave të pranuar pranë këtij organi brenda Kosovës paraqet vetëm 34% (8,053 ankesa) të numrit të përgjithshëm të ankesave të parashtruara pranë DÇPB-së/KAPB-së, duke bërë me dije se disa elemente të qasjes mbeten joadekuate dhe pengojnë realizimin efikas të të drejtave pronësore si të popullatës pakicë gjithashtu edhe të asaj shumicë. Sa i përket mekanizmave për pranimin e ankesave jashtë Kosovës, resurset fizike dhe njerëzore të DÇPB-së/KAPB-së duket të kenë ndikuar edhe në pranimin e ankesave brenda Kosovës<sup>99</sup>. Deri në hapjen e zyres së DÇPB-së në Prizren,<sup>100</sup> zyra regjionale e DÇPB-së në Pejë është përgjegjëse për regjionin e Pejës dhe për Mal të Zi.<sup>101</sup> Edhe pse zyra arriti të pajiset me numër më të madh të automjeteve, zvogëlimi i numrit të stafit përgjysmë dhe ndërrimi i kryesuesit të zyrës tri herë që nga vlerësimi i kaluar, ndikon në cungimin e vazhdueshëm të operacioneve të këtij autoriteti. Rrethanat e tilla pengojnë si në sigurimin e ekipeve mobile të DÇPB-së dhe në realizimin e një fushate për ngritjen e vetëdijes në mesin e pjesëtarëve të pakicave.

Një fushatë e gjerë e ngritjes së vetëdijes për tërë Kosovën e cila u realizua nga OSBE-ja tregonte mbi aspekte të ndryshme dhe nivele të ndryshme influencuese të mekanizmave të DÇPB-së/KAPB-së. E realizuar ndërmjet 20 dhe 26 nëntorit 2002, fushata në fjalë arriti t'i informoi rreth 175 përfaqësues të RAE, serbëve dhe boshnjakëve në 15 lokalitete të ndryshme anembanë Kosovës<sup>102</sup> mbi mandatin dhe funksionin e DÇPB-së/KAPB-së, si dhe mbi të drejtat pronësorobanesore të pjesëtarëve të bashkësive të cilave i'u takojnë.<sup>103</sup> Përderisa një fushatë e tillë plotësonte fushatën e gjerë informative të DÇPB-së e dedikuar për të informuar opinionin e gjerë publik mbi shtyrjen e afatit për parashtrimin e kërkesave, ende ekziston një konfuzion në mesin e pjesëtarëve të pakicave se kush mund të parashtrorë kërkesë pranë DÇPB-së dhe ku mund të parashtrohen kërkesat e tilla. Krahas kësaj, udhëheqësit e bashkësive RAE të cilët për momentin banojnë në qendrat kolektive në Leposaviq dhe Zitkovc (Zveçan) treguan një mungesë të interesimit për procesin e parashtrimit të kërkesave pranë DÇPB-së/KAPB-së për shkak se shumica e shtëpive të tyre (të cilat ndoshen në "mahallën e romëve" në Mitrovicë) ishin

<sup>99</sup> Për shembull, në regjionin e Prishtinës, në të cilin hyn zyra fushore e Graçanicës, pranimi është më i madhi në Kosovë (mbi 3.800 ankesa, 16% të numrit të përgjithshëm të tyre). aty ku resurset vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme, pra nuk është parë ndonjë progres. Shifrat e numrit të lëndëve të pranuar në regjionin e Pejës dhe Prizrenit në mënyrë të qartë e ilustrojnë këtë deficit. Që nga 14 dhjetori 2002, vetëm 178 ankesa (0.8% të nr, të përgjithshëm) ishin pranuar në regjionin e Pejës ndërsa 130 (0.5%) janë mbledhur në regjionin e Prizrenit.

<sup>100</sup> Zyrtja ishte hapur më 3 shkurt 2003 pas ndërmarrjes së përpjekjeve të përbashkëta nga ana e DÇPB, OSBE-së dhe Këshillit Norvegjez për Refugjatë për t'i adresuar shkeljet e të drejtave pronësore në këtë regjion.

<sup>101</sup> Mungesa e një pranie efikase të DÇPB-së në regjionin e Prizrenit ka ndikuar në nivelin e qasjes së parashtruesve të kërkesave në këtë institucion. Përpjekjet *ad hoc* për të përmbytur zbrastësirat e mundshme nënkuptonin se resurset e DÇPB-së duhej të barteshin dhe operacionet e panevojshme të reduktohen. Resurset nga regjioni i Prishtinës ishin ndarë për zyrën në Prizren, dhe si rrjedhojë e kësaj u kërkua nga zyra e DÇPB-së për regjionin e Mitrovicës të mbulojë edhe komunën e Gillogovcit, e cila zakonisht mbulohej nga zyra në Prishtinë.

<sup>102</sup> Ky ishte një projekt i përbashkët i Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimit të Ligjit dhe Departamentit për Demokratizim të OSBE-së. Përfaqësuesit dhe udhëheqësit e bashkësive të pakicave ishin informuar në Gjakovë, Rahovec, Gjilan, Kamenicë, Mitrovicë, Vushtrri, Leposaviq, Zveçan, Prizren, Ferizaj, Graçanicë (Prishtinë), Shtërpce, Fushë Kosovë, Plemetin (Obiliq).

<sup>103</sup> Gjithashtu janë bërë përpjekje për t'a ngulitur në mendjen e udhëheqësve të bashkësive të pakicave domosdoshmërinë e parashtrimit të kërkesave nga ana e pjesëtarëve të bashkësive të cilave i'u përkasin me qëllim të realizimit të të drejtave pronësore.

shkatërruar.<sup>104</sup> Prapeseprapë, në Mitrovicë, fushatat e tilla informative tregonin për një mungesë të qasjes së pjeësëtarëve RAE në mekanizmat e DÇPB-së madje edhe në këtë regjion të plotësuar mirë me resurse përkatëse, dhe si rrjedhojë e kësaj kryesuesi i zyrës së DÇPB-së në Mitrovicë u pajtua që të formojë një ekip mobil i cili do të mbulononte të gjitha vendet e banuara me pjesëtarë të bashkësive RAE.

Sa i përket efikasitetit të DÇPB-së dhe DÇPB-së në procedimin e kërkesave, shpejtësia me të cilën kryhej ky proces dhe procesi i ekzekutimit të vendimeve mbetej ende jo i përshtatshëm. Nga gjithsejt 23,668 kërkesa, vetëm 1,856 kërkesa (8 % e numrit të përgjithshëm të kërkesave të parashtruara) janë zgjidhur qoftë nga DÇPB-ja apo nga KAPB-ja,<sup>105</sup> përderisa vetëm 621 vendime për dëbim janë ekzekutuar kundër okupuesve të paligjshëm (227 vendime administrative për dëbim të DÇPB-së,<sup>106</sup> 254 vendime të ekzekutuara për dëbim të KAPB-së dhe 140 lëshime vullnetare të pronave të okupuara në mënyrë të paligjshme<sup>107</sup>).

Një aspekt i veprimeve të DÇPB-së me ndikim të madh në kthimin e pakicave është edhe statusi i 4,275 rasteve të pronave të zbrazëta apo të paligjshme të cilat ende mbeten nën administrimin e DÇPB-së. Për momentin vetëm 2,268 prona janë nën administrimin e DÇPB –së, dhe nga ky numër vetëm 771 prona u janë ndarë familjeve të zhvendosura apo të rrezikuara në bazë të skemës së lejeve të përkohshme humanitare.<sup>108</sup>

Në përgjithësi, përkundër përparimit të shënuar që nga vlerësimi i kaluar, qasja në DÇPB dhe KAPB së bashku me veprimet e tyre mbeten të pamjaftueshme dhe jo të përshtatshme për sigurimin e një mbrojtje efektive të të drejtave pronëso-ro-banesore të pakicave e cila do të lehtësonte kthimin e tyre.<sup>109</sup>

Duhet të vërehet se nuk janë të vetmet, vështirësitë brenda DÇPB dhe KAPB dhe mekanizmat e tyre që krijojnë probleme për ata të cilët dëshirojnë të kthehen në pronat e cilat janë të okupuara. Dëmtimet pas ekzekutimit të dëbimeve dhe shkatërrimi i pasurisë gjithashtu edhe ngacmimet janë shqetësuese në këtë drejtim. Për shkak të kohës së gjatë që prej ekzekutimit të dëbimit deri në riposedimin fizik të pronës nga titullari i saj, ndodhin plaqkitje dhe shkatërrime të pronës. Krahas kësaj, personat që kanë okupuar ilegalisht pronën i kanë ngacmuar titullarët e kthyer të asaj prone. Në maj të vitit 2002 në Vushtrri, pjesëtarët e komunitetit shumicë kanë kërkuar të holla për “mbrojtje”, përderisa personat e dëbuar nga prona e okupuar kanë kërkuar dëmshpërblim nga pronari i kthyer për shka të përmirësimeve që ata kanë bërë në pronën e kthyer. Dukuritë e tilla

---

<sup>104</sup> OSBE-ja dhe UNHCR-ja mbronin idenë e parashtrimit të kërkesave pavarësisht nga kushtet në ish shtëpitë e tyre me qëllim të formimit të dëshmvive ligjore të cilat do të parandalonin ndërtimin e paligjshëm në tokat e tyre. Rekomandimet e tilla u pranuan edhe nga ana e DÇPB-së.

<sup>105</sup> 1,148 vendime të KAPB-së, 708 vendime të DÇPB-së.

<sup>106</sup> Lexo Regulloren e UNMIK-ut 2000/60, neni 12.6.

<sup>107</sup> 123 persona i lëshuan pronat e okupuara para marrjes së vendimit administrativ të DÇPB –së dhe dhe 14 para ekzekutimit të vendimit për dëbim të KAPB-së.

<sup>108</sup> Lexo Regulloren e UNMIK-ut 2000/60, neni 12.4.

<sup>109</sup> Në shtator 2002, përfaqësuesit e bashkësisë boshnjake në Pejë deklaruan se problemet pronëso-ro-juridike, së bashku me papunësinë, mbeten pengesat kryesore për kthimin e pjesëtarëve të kësaj bashkësie. Një përfaqësues i zemëruar nga fakti se bashkësia e tij nuk ishte duke i pranuar fondet e premtuara për mbështetjen e të kthyerve, deklaroi se numri i madh i pronave të okupuara në mënyrë të paligjshme dhe mungesa e fondeve për rindërtimin e shtëpive të shkatërruara kishte diskutuar pjesëtarët e komunitetit të tij për t’u kthyer. Pamundësia e DÇPB-së/KAPB-së që të realizojë dëbimin e menjëhershëm të okupuesve të paligjshëm ka ndikuar në mënyrë negative në marrjen e vendimeve për t’u kthyer nga ana e personave të zhvendosur.

theksojnë nevojën për një koordinim të shtuar në mes të DÇPB-së dhe KAÇPB me policinë në lidhje me dëbimet, por edhe një zgjuashmëri më të madhe në anën e organeve të zbatimit të ligjit.

## II. KADASTRI

Që nga vlerësimi i kaluar, qasja e përgjithshme në kadastrë për pjesëtarët e pakicave është përmirësuar mjaft.<sup>110</sup> Në shumicën e regjioneve, dokumentet e reja kadastrale lëshohen në të trija gjuhët zyrtare dhe shumica e stafit të lartë të Zyrës Kadastrale Komunale janë në gjendje të komunikojnë edhe në gjuhët joshqipe (serbokroate apo turke). Qasja fizike e pakicave në Zyrën Kadastrale Komunale në regjionin e Gjilanit është përmirësuar mjaft, me ZKK-në në Viti e cila e ka punësuar një punëtor serb dhe ZKK-në në Kamenicë drejtori i së cilës është gjithashtu serb. Në regjionin e Prizrenit, pjesëtarët e bashkësisë RAE në Rahovec pohojnë se gëzojnë qasje të lirë në ZKK-në, përderisa në komunën e Mitrovicës, individët serb dhe RAE mund t'i qasen ZKK-së nëpërmjet të zyrës satelit e cila gjendet në pjesën veriore të qytetit.

Së këndejmi, incidentet vazhdojnë të ndodhin dhe pjesëtarët e pakicave vazhdojnë të përballen me probleme sa i përket fitimit të qasjes fizike në kadastrë. Për shembull, në komunën e Pejës, bashkësitë RAE dhe organizatat ndërkombëtare të cilat veprojnë në emër të tyre janë ballafaquar me shumë probleme sa i përket qasjes deri tek hartat e sakta kadastrale për zonën RAE "Kristali". Një problem i ngjashëm<sup>111</sup> ishte edhe rasti kur ishin kërkuar hartat kadastrale për qëllime të identifikimit të vendeve të mundshme për kthim të serbëve në Sigë dhe Brestovik. Shumë pjesëtarë të pakicave janë përballur me vështirësi apo edhe me refuzim të qasjes në ZKK-të nëpër komunat multietnike, siç janë Lipjani dhe Fushë Kosova.

Problemet e tilla sa i përket qasjes fizike përshkohen nga mungesa e vazhdueshme e një shërbimi funksional kadastral, e cila ndikon në të gjitha komunitetet në Kosovë. Edhe pse është nxjerrur një rregullore për të formuar regjistrin funksional të paluajtshmërive,<sup>112</sup> kjo rregullore nuk mund të zbatohet përderisa nuk nxirret legjislacioni plotësues dhe përderisa shërbimi kadastral të mos bëhet funksional në mënyrë të plotë. Për shembull, disa shënime kadastrale për Kosovë mbeten ende në Serbi. Si rezultat i negociatave ndërmjet UNMIK-ut dhe Qendrës Koordinuese për Kosovë dhe Metohi (QKKM) qeveritë e Serbisë dhe Malit të Zi janë duke ndërmarrë hapa drejt vendosjes së bashkëpunimit teknik me qëllim të riformimit të sistemit kadastral në Kosovë, bashkëpunim ky i cili do të fokusohet në çështjet e bartjes së shënimeve kadastrale për Kosovën sistemit kadastral të Kosovës. Krahas kësaj, siç qëndron situata për momentin, ZKK-të nuk ruajnë të njëjtat lloje të dokumenteve dhe shënimeve të cilat janë të nevojshme për vërtetimin e të drejtave pronësore. Një problem tjetër i cili doli në shesh gjatë vlerësimit të kaluar, është edhe origjinaliteti i dokumenteve kadastrale dhe qëndrueshmëria (besueshmëria) e shënimeve kadastrale. Arrestimi i dy zyrtarëve të lartë të ZKK-së në Prishtinë në shtator 2002 për korrupsion ngrit dyshime rreth vërtetësisë (saktësisë) së transakcioneve pronësore të regjistruara në komunë gjatë tri viteve të fundit.<sup>113</sup>

<sup>110</sup> Lexo Vlerësimin e Nëntë, faqe 33, paragrafi 105-6.

<sup>111</sup> Shumica e ZKK-ve ruajnë listat poseduese sikurse edhe shënime mbi tokat dhe pronat shoqërore, si dhe kopjet e planeve ndërtimore. Shumica e ZKK-ve posedojnë me kopjet e kontratave të vërtetuara në gjyq mbi shitblerjen e pronave të paluajtshme. Për banesat, megjithatë, nuk ekziston ndonjë regjistër i tillë, për shkak se sistemi i tanishëm nuk e parasheh një gjë të tillë.

<sup>112</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2002/22, mbi Shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Themelimin e Regjistrin të të Drejtave Pronësore, 20 dhjetor 2002.

<sup>113</sup> Më 8 tetor 2002, pas konsultimit të DD-së dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), administratori komunal i KB-ve urdhëroi ngrirjen e regjistrimit të të gjitha transakcioneve pronësore të cilat janë ndërmarrë gjatë tri viteve të fundit përderisa AKK-ja të mos e themelojë Komisionin për Auditim i cili do të vërtetonte ligjshmërinë e tyre. ZKK-ja ishte rihapur për publik më 24 tetor 2002.

### III. NDËRTIMI I PALIGJSHËM DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

Siç është përmendur në vlerësimin e kaluar, mungesa e lirisë së lëvizjes të pakicave dhe ekzpozimi i tyre ndaj dukurisë së diskriminimit i bën ata të rrezikuar nga problemi i ndërtimit të paligjshëm dhe shfrytëzimi i tokës, apo ndërhyrja e paligjshme në të drejtat e tyre pronësore.<sup>114</sup> Pakicat janë veçanërisht të rrezikuara nga shfrytëzimi i paligjshëm i tokës bujqësore. Një shfrytëzim i tillë i tokës pengon mundësinë e bartësve të të drejtave pronësore në kthimin e tyre të qëndrueshëm. Që nga vlerësimi i kaluar, është shënuar një përparim i vogël në përmbytjen e zbratësirave ligjore në kornizën ligjore, siç janë mekanizmat jo adekuat administrativ për ankesa si në nivel qendror gjithashtu edhe në atë komunal dhe mungesa e mjeteve efikase juridike të cilat do t'i sfidonin ndërhyrjet e tilla në të drejtat pronësore.<sup>115</sup> Gjithashtu nuk është vërejtur ndonjë përparim i dukshëm në parandalimin e shfrytëzimit të paligjshëm të tokës bujqësore.

Efekti i këtyre zbratësirave është parë në komunën e Pejës, kur bashkësia RAE e cila ishte zhvendosur nga zona “Kristali” në qytetin e Pejës, ishte përpjekur t'i qaset tokave të tyre. Përderisa bartësve të të drejtave pronësore që vinin nga rradhët e bashkësisë RAE u ishin refuzuar kërkesat për leje për ndërtim në tokat e tyre, atyre shqiptar u ishte dhënë kjo leje në të njëjtën zonë, gjatë së cilës ndërtimet e paligjshme nga popullata shumicë vazhduan edhe mëtej. Bartësve RAE të të drejtave pronësore u ishte refuzuar kërkesa për leje ndërtimore nga komuna varësisht nga zona e qytetit në të cilën ndodheshin ato, përderisa aplikantëve shqiptar u ishte miratuar kërkesa për leje në të njëjtat zona. Komuna, varësisht nga zona përkatëse, refuzoi t'i marr në konsideratë ankesat kundër vendimeve të saj. Mëpas, me vendim të komunës të marrë në shtator 2000, u premtua se kundër vendimeve për ndërrimin e zonave ndërtimore mund të përdoren mjetet juridike nëpërmjet të administrtorit komunal të UNMIK-ut. Deri më sot, rreth 100 raste të regjistruara të ndërtimeve të paligjshme ende mbeten të pazgjidhura. Siç e ilustron edhe ky rast, mungesa e vazhdueshme e efikasitetit ndikon negativisht në aftësinë e pjesëtarëve të pakicave për t'ju qasur pronave të tyre dhe me këtë të realizojnë të drejtën e tyre për kthim.

### IV. RREGULLORJA MBI RREGJISTRIMIN E KONTRATAVE PËR SHITBLERJEN E PATUNDSHMËRIVE NË ZONAT E VEÇANTA GJEOGRAFIKE TË KOSOVËS (DHE URDHËRESA ADMINISTRATIVE 2001/16 DHE 2002/4

Shitja sistematike e patundshmërive të cilat u takojnë pakicave, çoftë vullnetare apo nën presion, ka pasoja potencialisht përkeqësuese mbi kushtet e jetesës për bashkësitë gjegjëse të pakicave dhe në mënyrë të tërthortë, mbi të drejtën e refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t'u kthyer në ato bashkësi. Si përgjigje ndaj këtij fenomeni, UNMIK-u e ka shpallur rregulloren 2001/17<sup>116</sup>. Para dhe pas kësaj shpalljeje, kjo rregullore është ballafaquar me kritika dhe spekulime<sup>117</sup>. Druhej se kjo do të parandalonte regjistrimin e pronës dhe për këtë do të shpiente në transaksione kladestine të pronës, të cilat do të anashkalonin sistemin e rregullt gjyqësor. Për më tepër, kjo ngrit shqetësimin se kufizimet e imponuara ishin shkelje e të drejtës së tjetërsimit të lirë të pronës, dhe gjithashtu se ishte diskriminuese.

<sup>114</sup> Lexo Vlerësimin e Nëntë, faqe 33, paragrafi 107.

<sup>115</sup> *Ibid*, paragrafi 108-111.

<sup>116</sup> Mbi shënimet nga rregullorja 2001/17, lexo vlerësimin e nëntë të rradhës.

<sup>117</sup> Lexo: Këshilli norvegjez për refugjatë (NRC): Rregullorja 2001/17 – Kërkesa për shqyrtim të pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare mbi kufizimet e lejuara ndaj tjetërsimit vullnetarë të pronës private banesore, 14 shtator 2001 dhe Raportin special të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë nr. 29 tetor 2001.

Sidoçoftë, rregullorja nuk e ndalon shitjen në përgjithësi. Ajo urdhëron që shitjet e tilla të rishqyrtohen nga institucioni tjetër, jashta gjykatave, për të konstatuar nëse kjo kontratë është lidhur drejtë dhe nëse kjo shitje reflekton blerjen sistematike të pasurisë në pronësi të pakicës. Në lidhje me këtë, rregullorja nuk mëton të shërbejë si një kufizues i shitjeve të patundshmërisë në pronë të pakicave, por përkundrazi, si një mjet e nevojshëm për mbrojtjen e intersave legjitim të pakicave.

Nevoja për t'u regjistruar kontratat mbi shitëblerjen para administratorit komunal, mund të gjenerojë një ndërhyrje të panevojshme dhe rëndë ndaj të drejtave pronësore sipas KEDNj-ut. Gjykata evropiane ka konstatuar se legjet kombëtare mbi shpronësimin janë jofleksibile, duke theksuar se parashtruesit e ankesave janë lënë "në gjendje të pasigurisë sa i përket fatit të pronave të tyre", pasi që ligjeve gjegjëse ju mungonte mjete juridik kundër procedurës së tejzgjatuar të shpronësimit dhe nuk parashikonin mundësinë e kërkesës për kompenzim. Këto zbrastësira në ligjin kombëtar, i kanë bërë parashtruesit e kërkesave t'i nënshtrohen "barrës individuale dhe të tepruar"<sup>118</sup>. Në bazë të argumentimeve të Gjykatës evropiane, OSBE-ja ka konstatuar se përkundër që kjo rregullore ka themeluar procesin e rishqyrtimit dhe atë ankimor, kjo ngarkon në mënyrë të tepruar të drejtat pronësore juridike të pronarëve nga pakicat, e që gjithashtu i mungon mundësia e kompenzimit të këtyre individëve për ndërhyrjen në gëzimin e të drejtave të tyre. kjo ngarkesë/barrë duket se është individuale dhe joproporcionale kur të baraspeshohet me qëllimin legjitim të rregullres, ndërsa rasti në vijim është mjaft ilustrativ në këtë drejtim.

Rasti ishte nisur me 11 mars 2002 nga dy individë të cilët kanë kërkuar nga administratori komunal në Lipjan, që të regjistrojë kontratën mbi shitëblerjen,<sup>119</sup>. Me 28 mars 2002, administratori ka refuzuar regjistrimin e kontratës mbi bazat e sigurisë: *ky transakcion do të rrezikont lirinë e lëvizjes për serbët në Lipjan*. Me 5 prill 2002, palët e kanë paraqitur kërkesën për rishqyrtim, me ç'rast pala serbe (shitësi i arshshëm) kishte parashtruar arsyet shëndetësore për realizimin e këtij transakcioni. Ai dhe gruaja e tij ishin të vjetër dhe të sëmurë (sidomos gruaja e tij) dhe ai nuk kishte mundësi më që të përkujdesej për të. Ai dëshironte të largohej dhe të shkojë në Serbi te i biri i tij i vetëm. Ata nuk kishin të holla të mjaftueshme për të paguar shpenzimet e nevojshme shëndetësore dhe spitalore. Me 16 prill 2002, megjithë njohjen e vështirësive të qiftit të moshuar serb, administratori e kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim<sup>120</sup> duke e bazuar vendimin e tij në mendimin e KFOR-it mbi çështjet e sigurisë. Me 8 maj 2002, shqiptari i Kosovës u ankua para kolegjit kundër vendimit të administratorit komunal<sup>121</sup> duke argumentuar se të dyja palët e këtij transakcioni janë njohur në mes veti për 30 vite me rradhë dhe gjithnjë kanë pasur raporte të mira, dhe se shumë shqiptarë tanimë janë vendosur në fqinjësi për të banuar. Pala serbe kishte deklaruar para kolegjit gjyqësor se vlerësimi i sigurisë i cili është bërë për këtë rast nuk është i saktë, pasi që pasuria e tij nuk gjindet në rrugën e cila është shfrytëzuar nga pjesëtarët e bashkësisë serbe gjatë lëvizjeve të tyre prej një pjese të komunës në pjesën tjetër<sup>122</sup>. Sidoçoftë kolegji gjyqësor i është përmbajtur argumenteve të administratorit komunal, gjegjësisht se "është kruciale që të ruhet rruga kritike (ku gjindej shtëpia) si një rrugë e banuar kryesisht nga serbët, për të siguruar kalim të lirë dhe të sigurtë për serbët në fqinjësi dhe ata që jetojnë më tej në jug në lagjen serbe në pjesën veriore të qytetit"<sup>123</sup>. Me 5 korrik 2002, kolegji e refuzoi ankesën<sup>124</sup>.

<sup>118</sup> Lexo European Court of Human Rights, Sporong and Lonroth judgement, A Series no. 52, para. 73.

<sup>119</sup> Shqiptari i Kosovës – blerësi dhe serbi i Kosovës – titullari momental i pronës.

<sup>120</sup> AKKB-ra ka përsëritur të njëjtat arsye sikur në rastin A..

<sup>121</sup> Lexo nenin 7 të rregullores 2001/17 të UNMIK-ut.

<sup>122</sup> Lexo deklaratën e serbit të Kosovës para trupit gjykues në seancën e mbajtur me 10 qershor 2002.

<sup>123</sup> Lexo deklaratën e administratorit komunal gjatë dëgjimit të sipërpërmendur.

OSBE ka dokumentuar rastet të cilat vënin në pah se rregullorja nuk i shërben qëllimit fillimisht të parashikuar. Përfaqësuesit e UNMIK-ut nëpër komunat e Prishtinës, Obiliqit dhe Fushë Kosovës, kanë raportuar se kjo rregullore nuk ka ndikim aq të rëndësishëm në shitëblerje, për shkak se të gjitha shitëblerjet e rëndësishme ishin kryer para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Për shembull, në fshatin Nëntë Jugoviqët, 50% e pronës banesore janë shitur qyshë para hyrjes në fuqi të rregullores. Në Fushë Kosovë dhe në Obiliq, statistikat e UNHCR-së në lidhje me shkuarjen/largimin e serbëve të Kosovës, tregojnë se më shumë janë bërë më shumë shkëmbime të pronës se sa kontrata të dorëzuara për regjistrim, duke vënë në pah shfrytëzimin e transaksioneve joformale.

Një shqetësim tjetër në lidhje me rregulloren buron nga mënyra e implementimit të saj, sidomos nga refuzimet nga ana e PSSP-së ndaj kërkesave të administratorëve komunal nga komuna të ndryshme të Kosovës për të caktuar “hapësira speciale gjeografike”(HSGj) shtesë<sup>125</sup>. Disa komuna të cilat nuk kanë HSGj në fushat e tyre të përgjegjësisë, i kanë kërkuar PSSP-së që të caktojë këso lloj hapsirash në kuadër të regjioneve të tyre. Për shembull, komuna e Ferizajt nuk ka HSGj në territorin e vet. Që nga gushti 2001, kjo komunë i ka dorëzuar PSSP-së tri kërkesa të tilla. Megjithatë, të gjitha kërkesat janë refuzuar pa dhënë sqarime mbi këtë dhe përkundër një numri të konsiderueshëm të shitëblerjeve ndëretnike të pasurisë të cilat janë kryer në komunën e Ferizajt<sup>126</sup>. Propozimi për të përfshirë qytetin e Prishtinës nën këtë skemë të HSGj është dorëzuar tri herë por të gjitha kërkesat janë refuzuar. Komuna e Prizrenit në shtator të vitit 2001 e ka dorëzuar kërkesën por gjithashtu edhe kjo është refuzuar.

Një fenomen tjetër i cili ka penguar implementimin efikas të rregullores është mungesa e resurseve për administratorin komunal për përcjelljen e transaksioneve dhe për të rishqyrtuar shitjet e dyshimta në mënyrë adekuate. Reduktimi i stafit të UNMIK-ut ka ndikuar në numrin dhe llojin e të punësuarve të aftë për të kryer në mënyrë efikase rishqyrtimet dhe të hetojnë kontratat e refuzuara. Për më tepër, OSBE-ja është e shqetësuar me të kuptuarit e dobët të rregullores, si nga ana e opinionit publik, poashtu edhe të zyrtarëve komunal. Është imperative që të sigurohet se gjykatat, autoritetet lokale dhe administratori komunal të kuptojnë në tërësi këtë rregullore.

Edh pse tokat bujqësore nuk janë të përfshiera në sfondin e kësaj rregulloreje, zhvillimet në aspektin e shitëblerjeve ndëretnike të tokës bujqësore kanë dhënë arsye plotësuese për shqetësim. OSBE-ja ka vërejtur se këto shitëblerje të tokave bujqësore, jo vetëm që u a ndërprejnë qasjen bujqëve nga pakicat në tokën e tyre të vlefshme për shfrytëzim bujqësor, por edhe mund të izolojnë në mënyrë efikase bashkësitë e pakicave, për shkak se këto toka zakonisht janë të shtriera përgjatë rrugëve në hyrje dhe dalje të bashkësive të pakicave. Ashtu siç qëndronë puna me kushtet e tanishme, në disa regjine tanimë janë kryer disa blerje sistematike të tokës bujqësore të pakicave, duke sugjeruar praktikat dhe zhvillimet të cilat kanë ndodhur me pronën banesore. Vlenë të përmendet se toka bujqësore është një indikator esencial ekonomik për kthimin e qëndrueshëm të bashkësive të pakicave, prandaj me rëndësi të madhe është transparenca ndaj transaksioneve ndëretnike të cilat përfshijnë këtë tokë.

---

<sup>124</sup> Sipas administratorit komunal të Lipjanit, ky transakcion ka mundur të jetë kryer në mënyrë jozyrtare, pasi që në dhjetor përfaqësuesit komunal kanë vërejtur se ajo shtëpi ishte e zbrazur. Nuk është bërë asnjë verifikim.

<sup>125</sup> Lexo, analizën e bërë në vlerësimin e nëntë, paragrafi 123.

<sup>126</sup> Zyra e këshilltarit ligjor është përgjigjur për tri herë me rradhë se kërkesat e dorëzuara nuk i plotësonin kriteret sipas nenit 1.2 lit. (a) dhe (b). Gjykata e Ferizajit, ka raportuar se 536 prona të serbëve dhe malazezëve të Kosovës (banesa, toka, lokale afariste, etj) janë transferuar në pronësi të shqiptarëve të Kosovës – në mesin e të cilave 182 sosh janë prona banesore – që nga hyrja në fuqi e rregullores.

Një zhvillim i ri në adresimin e ngeçjes së rregullores, ka qenë themelimi i grupit punues ABC, për ta rishtqyrtuar këtë rregullre. Është arritur përfundimi se ekziston nevoja e rritjes së numrit të HSGj, posaçërisht në hapësirat urbane nga të cilat kanë ikur pakicat dhe në të cilat ende nuk ka filluar procesi i kthimit. Vendet sikur qyteti i Prishtinës, i cili përmbanë një numër të madh të banesav të okupuara, paraqet një ambient armiqësor të kthyerit potencial. Këto rrethana paraqesin një presion të konsiderueshëm ndaj pronarëve nga pakicat që më parë t'i shesin pronat se sa të presin për procedurën e DÇPB për zgjidhjen e kontesteve mbi pronësinë dhe posedimin e pronës. Ky grup punues gjithashtu ka njohur fakin se për të siguruar implementimin e plotë të kësaj rregulloreje, është jetike që administratori komunal të ketë mundësi të monitorojë, hetojë dhe të përcjellë shitjet e dyshimta, përmes procesit të rishqyrtimit apo procedurës ankimore. Për këtë shkak, duke ditur për reduktimin e stafit të UNMIK-ut, kapacitetet e administratorit për t'i përmbushur përgjegjësitë e veta sipas kësaj rregulloreje nuk duhet të komprometohen. Grupi punues gjithashtu ka rekomanduar ndryshimin e rregullores. Kjo nënkupon rekomandimin e amandamentit i cili mbulon edhe tokën bujqësore. Ky amandament mund t'i shërbejë interesit të njëjtë publik i cili e ka shfaqur domosdoshmërinë për rishqyrtimin e pronës banesore, gjegjësisht mbrojtjen e të drejtave pronësore të të gjitha bashkësive, pa marrë parasyshë përkatësinë etnike, nga taktikat e parregullta apo detyruese të shitëblerjes.

## V. RINDËRTIMI DHE KTHIMI

E drejta e refugjatëve dhe të zhvendosurve për t'u kthyer dhe ushtruar të drejtat e tyre, varet nga ndarja e ndihmës për rindërtim. Shumë prona të pakicave janë shkatërruar si në rajonet urbane poashtu edhe rurale, çoftë gjatë konfliktit apo menjëherë pas tij, dhe në disa raste shkatërrimi ka vazhduar edhe gjatë periudhës pas konfliktit<sup>127</sup>. Në të vërtetë niveli i këtyre shkatërrimeve nëpër këto fshatëra mund të argumentohet se ndërlidhet me praninë e komunitetit pakicë.

Siç është theksuar në vlerësimin e kaluar, pakicat edhe pse në përgjithësi të informuara mirë për ekzistimin e ndihmës për rindërtim, dhe mekanizmat për relizimin e saj, prapë kanë hasur në vështirësi për ta fituar këtë<sup>128</sup>. Përpjestimi aktual i shtëpive të rindërtuara brenda bashkësive të pakicave është shumë më i vogël se ai i bashkësive të shumicës, të cilët normalisht kanë qasje më të lehtë dhe kanë burime më të mëdha financiare. Për shembull, në regjionin e Mitrovicës, shumica e madhe e shtëpive të rindërtuara nuk i takojnë përfituesve nga pakicat. Në Deçan, para këtij sezoni rindërtues, 55% e shtëpive të shkatërruara të popullatës shumicë janë ndërtuar në krahasim me 6-7% të atyre që u takojnë popullatës pakicë.

### **Qasja e pakicave në ndihmën për rindërtim**

Që nga vlerësimi i fundit e këndeje, qasja e pakicave në procesin e rindërtimit duket së është përmirësuar. Në përgjithësi, në kuadër të Komiteteve Komunale Banesore (KKB-re), të cilat e miratojnë ndarjen e shumicës së ndihmës për rindërtim, duket se interesat e bashkësive të pakicave përfaqësohen në mënyrë më konsistente përmes pranisë së zyrtarit për bashkësitë lokale të UNMIK-ut apo zyrtarit të bashkësive komunale, si anëtarë me të drejtë vote. Tre përjashtime të dukshme nga kjo ishin, KKB-re të Fushë Kosovës, Obiliqit dhe Ferizajit, në të cilat nuk ishte siguruar përfaqësimi i interesave të bashkësive të pakicave. Si rezultat i kësaj mungese të përfaqësimit u zvogëluar alokimi i ndihmës për bashkësitë e pakicave. Në Ferizaj, të vetmit pjesëtarë të pakicave të cilëve u është ndarë ndihma, ishin 3 ashkalinjë të Kosovës (më pak se 5%

<sup>127</sup> Për shembull, Mahalla Rome në komunën e Mitrovicës dhe "Kristali" në Pejë, ishin rrafshuar pas konfliktit. Në Vushtrri, me 10 maj 2002 janë plaqkitur dhe shkatërruar shtëpi të ashkalive të kthyer.

<sup>128</sup> Lexo vlerësimin e nëntë faqe 34-35 paragrafet 112-122.

të alokimeve për pakicat)<sup>129</sup>. Ndonjëherë, megjithë përfaqësimin e pranishëm, pakicave nuk iu është ndarë ndihma. Në Gllogovc, asnjë nga pakicat nuk kanë përfituar nga ndihma për rindërtim.

Të shumtën, progresi i arritur në ndarjen e ndihmës për rindërtim për pakicat, mund t'i atribuohet iniciativave ndërkombëtare dhe jo vendëse. Për shembull, ashtu siç përmendet në vlerësimin e fundit, AER ka kërkuar që 10% e ndihmës së dhuruar për rindërtim t'u ndahet përfituesve nga pakicat. Ky i fundit gjithashtu ka vënë në disponim për pakicat edhe fonde shtesë. Këto nisma bërën që KKB-re të përzgjedhin përfituesit nga pakicat të cilët përndryshe nuk do t'i kishin marrë në konsiderat, qoftë për shkak të konsideratës politike apo për shkak të pragut të rrezikshmërisë<sup>130</sup>. Avokimi aktiv i ZKL-le për përfituesit nga pakicat gjithashtu ka ndihmuar procesin të përzgjedhjes. Një shembull tjetër është Prizreni, ku shumica e pjesëtarëve të pakicave nuk kanë ditur për mundësinë e qasjes në ndihmën për rindërtim.<sup>131</sup> Pakicat në Prizren kanë përfituar nga ndihma për rindërtim kryesisht përmes programit zviceran “Caritas”, i cili i ka rindërtuar 57 shtëpi për romët në këtë komunë.

Shqetësime e nënvizuara në vlerësimin e mëparshëm ende mbeten, e që qasja e pakicave në ndihmën për rindërtim kohë pas kohe pengohet edhe nga bashkëpunimi i mangët në mes të OJQ-ve ndërkombëtare implementuese të programit dhe autoriteteve komunale siç janë KKB-re. Për shembull, në regjionin e Pejës, partneri implementues i AER-it “CRDAID” për një moment të caktuar dukej se i diskualifikonin përfituesit për shkak të mungesës së provave kadastrale edhe pse provat alternative janë të pranueshme sipas Udhëzimeve të UNMIK-ut mbi rindërtimin e shtëpive 2002 (Udhëzimet). Gjithashtu CRDAID ka rezultuar që të ofrojë ndihmë për familjet e REA-ve nga rajoni i Kristalit në Pejë dhe jo duke u bazuar në çështjet e rrezikshmërisë, por në atë se statusi pronësor i këtyre familjeve ishte tepër i zbehtë. Përveç pesë përfituesve nga ky rajon, të cilët posedonin dokumente pronësore juridike, dhe të cilët ishin miratuar, CRDAID vazhdoi të rezistojë dhe të injorojë vendimin duke u thirrur në pronësinë e pavërtetuar dhe problemet e sigurisë. Dy rastet e përjashtuara në fund u përfshinë në program<sup>132</sup>.

### **Qasja e pakicave dhe zbatimi i Udhëzimeve të UNMIK-ut mbi rindërtimin e shtëpive**

Krahas pengesave të nënvizuara në vlerësimin e fundit, pakicat që mëtonin të përfitojnë ndihmën në rindërtim dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre pronësore juridike, kishin hasur në pengesa për shkak të mosdhënjes së peshës juridike për Udhëzimet të cilat e udhëheqin procesin e rindërtimit<sup>133</sup>. Ashtu siç shkruhet në to, këto Udhëzime parashikojnë një sistem gjithpërfshirës për mbrojtjen e të drejtave pronësore, procedurë të rregullt, dhe kthim në shtëpi, por nuk posedojnë ndonjë kompetencë obligative.

Ky sistem është ndërtuar rreth një organi “rekomandues, bashkërendues dhe miratues” brenda komunës, në shumicën e rasteve është KKB-re<sup>134</sup>. Siç parashihet me Udhëzimet, anëtarësia e

<sup>129</sup> Në fakt këto KKB-re takohen vetëm tre herë në vit, dhe pa informuar kryesia zyrtarin e UNMIK-ut për bashkësitë lokale, si anëtarë i KKB-re.

<sup>130</sup> Në disa komuna, siç janë ajo e Skenderajt, Deçanit, Pejës dhe Klinës, pragu i “indikatoreve të gjendjes së rëndë sociale” i shfrytëzuar për vlerësimin e rrezikshmërisë është dashur të ulet për t'u përshtatur me kuotën prej 10% të AER-it.

<sup>131</sup> Në komunën e Prizrenti, prej 49 rasteve të pakicave të njohura për komunën, veëm 10 raste ishin të parashtruara para KKB-re për t'u vlerësuar.

<sup>132</sup> Me 18 nëntor 2002, janë vandalizuar dy lokacione të përfituesve për ndërtim.

<sup>133</sup> Këto Udhëzime janë nxjerrë nga Ministria e ambientit dhe planifikimit hapsionor, - Divizioni i banimeve dhe rindërtimeve.

<sup>134</sup> Në nenin 2.3.3, Udhëzimet lejojnë anashkalimin e KKB-re atëherë kur të shqyrtohen projektet e pakicave. Një opcion i tillë duhet të bëhet me vendimin e administratorit të UNMIK-ut, të koordinohet me zyrtarin për bashkësitë lokale, dhe KKB-re duhet të informohet mbi procesin.



KKB-re, përfshinë edhe drejtoritë relevante të komunës,<sup>135</sup> siç janë, ajo e urbanizmit dhe kadastrale, që nevojitet për përzgjedhjen e përfituesve dhe implementimin e vetë rindërtimit. Udhëzimet përcaktojnë procedurat dhe strukturat përmes të cilave KKB-re si organe qendrore, sigurojnë përmbushjen e kritereve themelore të rrezikshmërisë, por edhe kërkesave procedurale, ligjore dhe teknike për rindërtim. Për shembull, Udhëzimet kërkojnë që KKB-re përmes shërbimit verifikues dhe zyrtarit për bashkësitë e pakicave, që të “verifikohet dhe sigurohet” se përfituesit e përzgjedhur të kenë qasje ligjore në pronën e caktuar<sup>136</sup>. Të drejtat pronësore hulumtohen vetëm pas konstatimit të rrezikshmërisë së përfituesit dhe pas miratimit nga KKB-re të të drejtës së përfituesit për t’u ndarë ndihma për rindërtim. Masat e këtilla i promovojnë të drejtat pronësore si dhe të drejtën për t’u kthyer në shtëpi. Gjithashtu udhëzimet parashikojnë mekanizma për parandalimin e korrupsionit. Përveç që administratori komunal i KB-re mund të ndërhyjë kur ai/ajo e sheh të nevojshme këtë gjë, por gjithashtu procedurat përmbajnë mënyrat e verifikimit dhe baraspeshimit, siç është rasti me shërbimin verifikues të KKB-re i përshkruar më sipër. Krahas kësaj, Udhëzimet kërkojnë për tre mënyra të ndryshme të proceseve verifikuese gjatë përpilimit të listës përfundimtare të përfituesve<sup>137</sup>. Gjithashtu ekziston mekanizmi i ankesës dhe mbrojtjes të procedurës së rregullt. Për shembull, njëherë pas publikimit të listës përfundimtare, mund të parashtrohet ankesa në lidhje me mospranimin e të drejtës së përfituesit apo kërkesa për t’u përfshirë si përfitues dhe këtyre duhet t’iu jepet përgjigja<sup>138</sup>. Krahas kësaj, Udhëzimet në mënyrë efikase promovojnë të drejtën për t’u kthyer në shtëpi duke refuzuar çdo “zhvendosje dytësore”, përfshirë edhe transferet e shtëpive nga pjesët rurale në ato urbane. E vetmja zhvendosje e cila lejohet me rastin e ndarjes së ndihmës për rindërtim, është ajo e cila ndodhë brenda fshatit/bashkësisë<sup>139</sup>. Mëtej, procedurat obligojnë që të zhvendosurit, si ata përbrenda Kosovës dhe ata që janë jashtë, të kenë konsiderata të barabarta për ndihmën në rindërtim, nëse ata shprehin dëshirën për t’u kthyer në vendin e tyre të origjinës. Përzgjedhja duhet të bazohet krejtësisht në kriterin e rrezikshmërisë.

Atëherë kur shfrytëzohen mekanizmat e përcaktuar me këto Udhëzime, këto në të vërtetë kanë promovuar në mënyrë efikase të drejtën e kthimit në shtëpi, kanë mbrojtur të drejtat pronësore juridike si dhe procesin e rregullt/drejtë, por edhe kanë parandaluar korrupsionin përmes procedurave të qarta dhe difinuara mirë dhe strukturave të cilat ato i kanë krijuar<sup>140</sup>. Edhe më tej, pa një sistem mbikqyrës apo meknizëm përcjellës, rriten gjasat e keqpërdorimeve dhe ndarjes së gabuar të ndihmës për rindërtim. Në Pejë, ku fondet e vitit 2002 përkohësisht ishin tërhequr për shkak të pohimeve mbi korrupsionin dhe favorizimin gjatë programit 2001, zyrtari komunal për projekte i UNMIK-ut i cili është anëtarë i KKB-re, i ka vënë në dukje OSBE-së për përpjekjet e përsëritura në këtë drejtim, por tërthorazi, për të përfshirë përfituesit “politiksht të përshtatshëm”<sup>141</sup>.

<sup>135</sup> Lexo nenin 2.3.1, të Udhëzimeve.

<sup>136</sup> Në fakt, “Udhëzimet” ofrojnë një proces shtatëshkallësh për shërbimin verifikues të KKB-re për t’ju ndihmuar përfituesve në verifikimin e posedimeve, përfshirë këtu edhe veprimet që duhet ndërmarë kur nuk mund të gjinden dokumentet kadastrale. Mëtej, “Udhëzimet” bazohen në përzgjedhjen sipas kritereve të rrezikshmërisë dhe jo në ato të të drejtave të konfirmuara pronësore juridike.

<sup>137</sup> Neni 3.4.1-3, të “Udhëzimeve”.

<sup>138</sup> Neni 3.4.4, “Udhëzimet”.

<sup>139</sup> Lexo nenin 2.3, pikën 2.

<sup>140</sup> Në Pejë, Deçan dhe Gjakovë, KKB-re në mënyrë të përpiktë dhe prej rastit në rast i kanë shqyrtuar përfituesit e propozuar së bashku me partnerin implementues. Në Ferizaj, ishte parashtruar një ankesë me pohimin se një përfitues i miratuar e ka keq-përfaqësuar veten. Ankesa ishte pranuar dhe personi është hequr nga lista. Në Klinë, një familje mundahej të ndërtonte shtëpinë në tokën e komunës. Drejtorati kadastral dhe i rindërtimit, kishte ndërhyrë dhe ndërtimi i kundërligjshëm ishte parandaluar.

<sup>141</sup> Një situatë e ngjajshme u shfaq në Klinë kur të favorizuarit personal dhe politikë ishin promovuar në përfitues, por refuzuar nga KKB-re.

Atëherë kur Udhëzimet nuk shfrytëzohen, rrezikohen të drejtat pronësore të pakicave si dhe procesi i rregullt/drejtë, por edhe e drejta për t'u kthyer në shtëpi. Madje këto të drejta edhe shkelen, sidomos në rastet e kthimeve të organizuara apo rastet e projekteve për pakicat. Në regjionin e Mitrovicës dhe Pejës, anashkalimi i Udhëzimeve dhe KKB-re ka rezultuar në përfundime/konkluzione negative. Në regjionin e Pejës, ky anashkalim ka rezultuar shndërrimin e disa shqetësime pronësore juridike në shkelje të ligjit në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut gjatë implementimit të projektit të kthimit të organizuar në Biqë dhe Grapc të komunës së Klinës. Sipas Udhëzimeve, administrata regjionale e UNMIK-ut ka vendosur të shfrytëzojë grupin e pajtimit që është unik për këtë regjion, Grupin për implementimin e kthimit (GIK). I themeluar si degë e Grupit regjional punues (GRP), GIK ka trashëguar funksionin implementues të GRP-së<sup>142</sup> për të mundësuar aspektet lokale politike për të kthyerit dhe që procesi i pajtimit të ndahet nga çështjet më teknike të implementimit. GIK parashihet të mbledhet për secilën komunë të angazhuar në projektin e kthimit të orgnaizuar dhe ka krijuar 5 ekipe të punës të cilat i mbulojnë temat teknike, përfshirë edhe ato mbi projektet për rindërtim dhe baraspeshim.<sup>143</sup> Mungesa e koherencës së kësaj strukture gjatë implementimit ka përjashtuar zgjidhjen çështjeve pronësore të cilat ndikojnë në procesin e kthimit.

Në praktikë, mungesa e definicionit të mandatit të GIK si dhe ekipeve të veta punuese ka parandaluar themelimin e mekanizmave mbrojtës të të drejtave të përfituesve potencial, sikurse që janë ata të paraparë me Udhëzime, dhe kanë shpër në përpjekjet për të anashkaluar këtë strukturë me rastin e ngritjes së çështjeve pronësore në projektin e kthimit të komunës së Klinës. Korniza e parashikuar nga GIK ka dështuar të sigurojë të drejtat pronësore dhe konfirmimin e tyre para rindërtimit, për të mënjeluar mundësinë e ndërtimit në tokën e tjetërkujt apo pa lejet përkatëse, por edhe i mungonte mjete juridike insitucional. Për më tepër, kjo rezultoi në ndërtime paleje në tokën e komunës, tokën në pronë shoqërore, por edhe në tokat e tjetërkujt dhe ndërtimin e të gjitha 41 shtëpive nga partneri implementues Technisches Hilfswerk (THW) pa lejet e nevojshme për ndërtim të lëshuara nga komuna<sup>144</sup>. Situatat e këtilla shkelin rregulloret 2000/45 dhe /53 dhe 2002/53 të UNMIK-ut<sup>145</sup>, Ligjin themelor mbi marrëdhënjet pronësore juridike, por edhe standardet ndërkombëtare në lidhje me pronën dhe të drejtat procesuale. Deri më tani këto shkelje nuk janë adresuar përkundër thirrjeve të përsërituar nga ana e administratës regjionale të UNMIK-ut.

Në Mitrovicë, mungesa e sistemit efikas të sistematizimit, centralizimit apo analizimit të informave pronësore apo informatave tjera mbi kthimin, sikurse ato të parapara në Udhëzime, ka penguar romët e zhvendosur nga "mahalla rome" që atyre t'u ndahet ndihma për rindërtim si dhe që ata të ushtrojnë të drejtat e tyre pronësore dhe të drejtën e kthimit në shtëpitë e tyre. Bashkësia rome e Kosovës ishte dëbuar me forcë nga mahalla e tyre, dhe shtëpitë e tyre ishin plaçkitur dhe djegur nga shqiptarët e Kosovës gjatë qershorit 1999<sup>146</sup>. Krahas përpjekjeve të ndërmarra për kthim dhe rindërtim të disa shtëpive, mahalla rome ende është hapësira më e madhe e ndërtesave të shkatërruara në Kosovë, me mbi 650 shtëpi të shkatërruara<sup>147</sup>.

<sup>142</sup> Në disa regjione, sikurse në Mitrovicë, këtyre u referoheshin si grupe punuese lokale (GPL)

<sup>143</sup> Temat tjera ishin: Nevojat emergjente, siguria, projektet e gjenerimit të të ardhurave dhe shërbimet komunale.

<sup>144</sup> Siç kërkohet nga neni 2.1, i rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/53 mbi ndërtimet në Kosovë.

<sup>145</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2000/53 neni 2.1

<sup>146</sup> OSBE, "Kosova: Siç është parë, siç është thënë, Pjesa II", dhjetor 1999, p. 102-3.

<sup>147</sup> Në tetor të v. 2000, UNHCR-ja ka tentuar t'i kthejë disa familje nëpër shtëpi-montazhi në pronën e tyre në mahallën rome për t'jo ofruar atyre vendosje të përkohëshme gjersa t'ju rindërtohen shtëpitë e tyre. Megjithatë KFOR-i kishte vënë veton mbi këtë operacion, mbi bazat e sigurisë dhe atë në minuatat e fundit dhe kështu projekti ishte braktisur.

Tani për tani, nga 645 përfitues potencial, vetëm 6 prej tyre të cilët jetojnë në pjesën veriore të Kosovës, nga kampet e REA-ve, janë identifikuar nga ana e grupit punues lokal (GPL) dhe të cilët posedojnë me dokumentacion të duhur mbi të drejtat pronësore, për të pranuar ndihmën, e që është kërkesë për realizimin e të drejtës së tyre për kthim. Arsyetimi i administratorit komunal të UNMIK-ut për këto shifra zhgënjyese është mungesa e përfituesve potencial të cilët posedojnë prova adekuate mbi të drejtat pronësore dhe të dëshirës për t'u kthyer. Kadastrin e lokalizuar në Krushevc, Serbi, numron 354 prona në "Mahallë", ndërsa vetëm 26 familje të evidentuara në regjistrin kadastral, janë identifikuar si banorë të Kosovës apo Serbisë dhe Malit të Zi. Janë duke u bërë përpjekje për identifikimin e titullarëve tjerë të cilët janë të zhvendosur nëpër tjera vende ndërsa ende nuk ka rezultate në këtë drejtim. Njëkohësisht brengosë është edhe fakti se, 80 familjet që jetojnë në kapet e pjesës veriore të Kosovës duket se kanë shprehur dëshirën për t'u kthyer dhe rimarrë pronën e tyre. Përderisa ata mund të mos posedojnë dokumente kadastrale, dokumentet të cilat ata mund t'i posedojnë, ato mund të përbëjnë prova adekuate mbi të drejtat pronësore për t'u kualifikuar për ndihmë në rindërtim, përmes procedurës së paraparë me Udhëzime<sup>148</sup>. Sidoçoftë, kjo mënyrë duket se nuk është marrë parasysh apo diskutuar brenda GPL-së. Në kuadër të GPL janë diskutuar gjërësisht opsionet e mundshme për t'ju qasur situatës në "Mahallë", përfshirë këtu edhe planet e komunës për një zhvendosje dytësore. Diskutimet ende nuk kanë mbaruar. Zhvendosjet dytësore, qëndrojnë në kundërshtim me Udhëzimet dhe politikën e UNMIK-ut mbi kthimin e qëndrueshëm. Gjendja e pronësore e mahallës rome, e rënduar nga mungesa e dukshme dhe e artikuluar e vullnetit politik, vërteton efektin përkeqësues të statusit të dobët ligjor të Udhëzimeve mbi qasjen e pakicave në të drejtat e tyre pronësore dhe të drejtën e tyre për t'u kthyer në shtëpi të veta.

Në kuadër të procesit të kthimit dhe rindërtimit, mbrojtja e të drejtave të atyre të cilët dëshirojnë të kthehen në shtëpitë e tyre, varet nga prania e mekanizmave të duhur ashtu siç parashihen në Udhëzimet, për të mbrojtur këto të drejta, por edhe struktura koherente dhe të menaxhuara mirë për t'i shfrytëzuar këta mekanizma. Një dinamikë e tillë është parë në situatën e paraqitur në Fushë Kosovë. Një OJQ "Erikshjalpen" ka ofruar ndihmë për rindërtim për serbët e Kosovës. Ata ia kanë propozuar projektin GPK-al, i cili e refuzon duke u bazuar në mungesën e kushteve të sigurisë që kërkohen për kthim të qëndrueshëm. Kjo OJQ gjithashtu i është drejtuar KKB-re e cila e ka aprovuar ndihmën për rindërtim vetëm duke u bazuar në gjendjen e rrezikshmërisë ekonomiko-sociale duke mos marrë në konsideratë aspektet e sigurisë. Pa marrë parasysh rrezikshmërinë apo disponibilitetin, për shkak të gjendjes së sigurisë, kthimi dhe rindërtimi nuk ishte i realizueshëm. KKB-re nu i kishte mekanizmat e nevojshëm për të vlerësuar në tërësi nëse gjendja ishte e përshtatshme për rindërtim, ndërsa GPK-al kishte mekanizmat e tillë. Prandaj, siç shihet, prania e strukturës koherente me mekanizma gjithpërfshirës dhe të themeluar për mbrojtjen e të drejtave të të kthyerve nuk ekziston në mënyrë konsistente në gjithë Kosovën.

## **VI. STRUKTURAT E REJA PËR KTHIM**

Gjatë periudhës raportuese, procesi i kthimit përshkohej me një koherencë të caktuar. Më heret, koordinimi i projekteve të kthimeve dhe çështjeve të kthimeve në nivelin lokal, komunal dhe regional, ka qenë i ndryshueshëm. Në disa raste grupet punuese lokale GPL-le apo ekipet punuese ishin themeluar për projekte të caktuara të kthimit, por shumica prej tyre nuk kishin të angazhuar zyrtarët lokal apo përfaqësuesit e gurpeve relevante. Për të orientuar dhe përforcuar koordinimin e çështjeve të kthimit, UNMIK-u ka themeluar grupet komunale dhe regjionale

<sup>148</sup> Neni 2.3.3, "Udhëzimet e UNMIK-ut mbi banimet dhe rindërtimet 2002", ofrojnë drejtime mbi provimin e të drejtave pronësore në mungesë të dokumentacionit kadastral apo gjyqësor.

punuese (GPK-al dhe GPR-al) mbi kthimet gjatë periudhës raportuese, fillimisht të udhëhequra nga UNHCR, por më vonë nga UNMIK-u në qershor 2002.

Këto grupe punuese ishin themeluar në të gjitha pesë regjionet në fund të vitit 2002, edhapse shumica prej tyre janë takuar vetëm disa herë. Në disa raste themelimit i tyre ishte shtyer për shkak të zhvillimeve politike: në Deçan, për shembull, arrestimi i ish-pjesëtarëve të UÇK-së kah mesi i gushtit, kishte provokuar një përkeqësim të klimës politike. Kah fundi i periudhës raportuese, grupet punuese kanë ekzistuar thuajse në të gjitha komunat e Kosovës. Mirëpo, nuk kishte GPK-al në Podujevë, regjioni i Prishtinës, Malishevë, regjioni i Prizrenit, në të cilat rezistenca ndaj kthimeve ishte posaçërisht e fuqishme. Krahas kësaj, Dragashit/regjioni i Prizrenit, gjithashtu i mungon GPK-al, me arsyetimin e udhëheqësve komunal se nuk ka nevojë për një grup të tillë pasi që në komunë ndodhin më shumë largime se sa kthime, dhe kryesisht për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike.

Prapë, themelimi i GPK-le dhe GPR-le, domosdoshmërisht nuk e reflekton zotimin për t'u kthyer nëpër komunat dhe regjionet gjegjëse. Kjo tregohet qartë në mbledhjet e GPK-le të regjionit të Mitrovicës, ku me përjashtim të vetë qytetit të Mitrovicës dhe Vushtrrisë, diskutimet përqëndroheshin në kthimin e personave të zhvendosur në komunat tejra, në vend se në komunat e tyre të origjinës. Ndërsa në Prishtinë dhe komunën e Klinës, mbledhjet janë të rralla.

GPK-le ishin menduar si forume primare të planifikimit dhe koordinimit të projekteve të kthimit. Krahas kësaj, ato mendoheshin si një lokomotivë e dialogut ndëretnik dhe pajtimit, përmes angazhimit të autoriteteve lokale, përfaqësuesve të zgjedhur nga të dyja grupet etnike të shumicës dhe pakicës, të zhvendosurit dhe të kthyerit e ardhshëm. Megjithatë, në shumicën e rasteve ndikimi i tyre në promovimin e pajtimit dhe kthimet në përgjithësi ka qenë i kufizuar. Efikasiteti i GPK-le varet kryesisht nga pjesëmarrja e përfaqësuesve të komuniteteve lokale dhe pakicave të zhvendosura, dhe gatishmërisë së tyre për të përhapur informacionet e përfituara nga anëtarët tjerë të komunitetit: nganjëherë kjo ka munguar. Krahas kësaj, shumë përfaqësues të shumicës nuk kanë marrë pjesë në këto mbledhje për shkaqe politike gjatë garës për zgjedhjet e tetorit, në disa raste edhe duke stopuar procesin e kthimit për disa muaj me rradhë. Në Prizren në GPK nuk marrin pjesë zyrtarët lokal. Është kyçe që edhe udhëheqësia politike dhe UNMIK-u të inkurajojnë për një përfaqësim të duhur në këto struktura.

Ndryshime të mëdha gjithashtu ishin evidente në nivelin qendror. Në maj 2002, rezultoi theksi i veçantë në shkallën më të lartë nga ana e UNMIK-ut pas miratimit të dokumentit strategjik (politik) mbi kthimet, për të udhëzuar procesin e gjithmbarshëm. Pas bartjes së përgjegjësisë të UNHCR-së në UNMIK për qëllim të fokusimit më të madh në rolin mbikqyrës në procesin e kthimeve, ZKK-te e ka marrë përsipër rolin udhëheqës në koordinimin e çështjeve të kthimit në nivelin qendror. Grupi koordinues i kthimeve, ekipi i veçantë për kthime dhe bordi teknik këshilldhënës ishin themeluar në nëntor dhe dhjetor të vitit 2002. I përbërë nga akterët ndërkombëtarë dhe IPV-es, grupi koordinues i kthimeve, i kryesuar nga ZKK-të i adreson çështjet operacionale dhe siguron koordinimin në mes të gjithë akterëve. Siç shihet më lartë, njëra prej sfidave kryesore do të jetë rritja e efikasitetit dhe zotimeve për grupet punuese komunale.

Ekipi i veçantë për kthime (taskforce) është i përbërë nga katër shtyllat e UNMIK-ut, ZKK-së, DÇPB, UNHCR-së, KFOR-it dhe IPV-es, dhe kryehohet nga PSSP. Përmes takimeve dy herë në vjet, pritet që të sigurohet implementimi konsistent i politikave të kthimit, përfshirë edhe grupet punuese komunale dhe regjionale. Gjatë vjeshtës, ZKK ka themeluar njësitet regjionale për kthim për punën në teren, për të punuar nga afër me autoritetet komunale dhe regjionale dhe promovimin koherent të politikave. Krahas kësaj, ZKK është në proces të rekrutimit të personelit për zyren në Beograd. Më tej, bordi teknik këshilldhënës, i kryesuar nga UNHCR ishte themeluar

në dhjetor për të ofruar ekspertizën e tij për proceset e zhvillimit të projekteve. Në fund, me publikimin e projektit të përbashkët të ZKK dhe UNHCR-së, të “Doracakut mbi kthimin e qëndrueshëm” , pritet të realizohet një koherencë më e madhe për strukturat e procesit të kthimit.

## **PJESA 5: QASJA NË STRUKTURAT PUBLIKE, CIVILE DHE POLITIKE**

### **I. QASJA NË PROCESIN ZGJEDHOR**

Në maj të v. 2002, Komisioni qendror i zgjedhjeve (KQZ) i kishte rekomanduar PSSP-së sistemin proporcional të zgjedhjeve për zgjedhjet komunale që do të mbaheshin në tetor 2002. Korniza e përgjithshme që kishte rezultuar nga rregullorja e UNMIK-ut 2002/11, mbi zgjedhjet komunale në Kosovë, dhe më pas të Rregullave zgjedhore të KQZ-së, ishte më e favorshme për subjektet më të vogla politike, gjë që në përgjithësi u dëshmuar si të favorshme edhe për subjektet politike të bashkësive të pakicave. Ky sistem nuk kishte ndonjë kufi/limit zgjedhor për fitimin e vendeve – ngjajshëm me sistemin e përdorur gjatë zgjedhjeve komunale të vitit 2000, por nuk përmbanë as masa të diskriminimit pozitiv, siç janë vendet e rezervuara për pakicat<sup>149</sup>. Rrjedhimisht, nga partitë e pakicave ishte kërkuar që të shqyrtojnë nëse koalicionet do të ishin më të favorshme, dhe për të ngritur shkallën e organizimit të tyre politik, për të mobilizuar votuesit e tyre potencial. Në këtë mënyrë, bashkësia vetëm do të mund të shtonte gjasat për të fituar vende në kuvendin komunal, poqese vetëm një subjekt politik do të përpiquej të mbledhë votat nga trupi zgjedhor i bashkësisë.

Korniza zgjedhore ishte fleksibile sa i përket mënyrës dhe formës sipas të cilës subjektet politike do të mund të merrnin pjesë në zgjedhje. Ky fleksibilitet ishte formuluar për të siguruar një votim sa më të llojlojshëm. Kjo ka shpjer deri te një shkallë të lartë të llojlojshmërisë politike brenda bashkësive të pakicave të Kosovës, por ndoshta e ka zbehur rëndësinë e secilit subjekt në reliev politik të Kosovës. Koncepti i sistemit zgjedhor ishte nisur nga parakushti se shumë prej bashkësive joshumicë janë të koncentruara në lokalitetet e caktuara brenda 30-të komunave të Kosovës dhe do të mund të fitonin përfaqësimin nëse ato do të mund të mobilizonin në mënyrë efektive trupin e tyre zgjedhor. Kryesisht kështu edhe u veprua, përveç disa përjashtimeve dhe vërejtjeve të diskutuara më poshtë. Megjithatë, për të parën herë që nga konflikti, të gjitha bashkësitë etnike kanë marrë pjesë në procesin zgjedhor komunal, që ka rezultuar me 25 subjekte politike nga pesë bashkësi etnike, të cilat kanë arritur përfaqësimin në së paku një kuvend komunal<sup>150</sup>.

Vlenë të përmendet se viti 2002 ka parë shfaqjen e një copëzimi të madh të subjekteve politike të serbëve të Kosovës. Kjo dallon thellë në krahasim me zgjedhjet për kuvend të Kosovës në vitin 2001, kur bashkësia serbe ishte bashkuar pas vetëm një subjekti të certifikuar – Koalicionit kthimi (KK). Prandaj KK ishte ballafaquar me një konkurrencë brenda vet bashkësisë serbe të Kosovës. Nga 68 subjekte politike të certifikuar për të garuar në zgjedhjet komunale gjatë vitit 2002, 31 prej tyre që garonin në 24 komuna, sipas origjinës, ishin nga bashkësia serbe. Nga këto, 21 subjekte politike kanë fituar gjithsejt 94 vende në 18 komuna. Nga këto 18 komuna, 8-të prej tyre përfaqësohen me nga vetëm një përfaqësues serb. Një moment i rëndësishëm është ai se, thuhet të gjitha vendet për përfaqësuesit serb ishin fituar nga votat individuale të hedhura nëpër komuna, me vetëm disa vota nga personat e zhvendosur intern (PzHI) në Serbi dhe Mal të Zi. Vlenë të përmendet se, megjithatë, KK i ka vituar votat kryesisht nga trupi zgjedhor në Serbi dhe Mal të Zi, pra jashtë Kosovës.

Në mesin e subjekteve politike serbe të Kosovës, duhet të dallohen dy lloje të tyre: ato të cilat janë regjistruar dhe janë aktive sikur në Serbi ashtu edhe në Kosovë, dhe të tjerat të cilat janë

<sup>149</sup> Sistemi i Kuvendit të Kosovës, për vendet e rezervuar për të përfaqësuar bashkësitë e ndryshme joshqiptare, që kishte për qëllim garantimin e pjesëmarrjes së tyre pamarrë parasyshtë përqindjen e fituar me vota për vendin e fituar.

<sup>150</sup> Vetëm bashkësia e vogël kroate dhe ajo rome, nuk kanë arritur të fitojnë ndonjë vend.

krijuar dhe janë aktive vetëm në Kosovë apo në ndonjë pjesë të caktuar të krahinës. Nga pikëpamja financiare, për qëllim të udhëheqjes së fushatë zgjedhore, subjektet politike të cilat veprojnë si degë të partive politike me seli në Serbi, kanë pasur përkrahje financiare, ndërsa subjektet e vogla dhe lokale me seli në Kosovë, kanë hasur në vështirësi financiare të konsiderueshme<sup>151</sup>.

Në lidhje me performancën e subjekteve politike të pakicave jo-serbe, mund të identifikohen dy zhvillime. Së pari, disa prej këtyre subjekteve, të cilat kanë marrë pjesë në së paku një prej zgjedhjeve të mëparshme, kanë treguar përmirësime të konsiderueshme në organizimin e tyre të brendshëm dhe në aftësitë e tyre për të mobilizuar trupin e tyre zgjedhor. Shembujt kryesorë të subjekteve politike jo-serbe dhe kohezive janë, Koalicioni i boshnjakëve të Kosovës “Vatan”<sup>152</sup> (gjithsejt shtatë vende në Kosovë) dhe Partia demokratike turke e Kosovës (KDTP)<sup>153</sup> të cilët kanë fituar pesë vende. I njëjti vlerësim, për një shkallë pak më të ultë, mund të zbatohet edhe ndaj partisë egjiptase të Kosovës - IRDK<sup>154</sup> (katër vende) dhe një vend për partitë e ashkalinjëve të Kosovës PDAK<sup>155</sup> të cilat kanë fituar tre vende. Gjithashtu, etniteti goran i Kosovës - GIG<sup>156</sup> - ka fituar dy vende në Dragash. Subjektet tjera të pakicave jo-serbe, kanë hasur në vështirësi financiare dhe ju ka munguar organizimi. Në disa raste, bashkësia ishte tepër e vogël për të mbështetur subjektin politik. Veçanërisht, bashkësia rome ka pësuar nga këta faktorë, dhe asnjëri prej dy subjekteve rome të cilat kanë garuar në zgjedhje nuk ka fituar ndonjë vend. Performanca zgjedhore e Iniciativës qytetare të kroatëve të Janjevës, të cilët përfaqësojnë bashkësinë kroate të Kosovës, paraqitet si një rast tjetër në këtë pikëpamje. Kryesisht të koncentruar në fshatin Janjevë të Lipjanit, duket se nuk ka pasur mjaft votues korat në Lipjan për të siguruar përfaqësimin në kuvendin komunal, dhe gjithashtu nuk kanë pasur mjete financiare për të mobilizuar përkrahjen në mesin e të zhvendosurve të tyre në Kroaci. Në përgjithësi do të duhej përfunduar se, përveç suksesit zgjedhor apo dështimit të subjekteve politike të jo-shumicës, hutia dhe fërkimet e brendshme sidomos brenda bashkësive të ashkalinjëve, romëve dhe boshnjakëve, edhe më tej e pengojnë zhvillimin e një përfaqësimi të mirëfilltë të bashkësisë. Dallimet e brendshme mund të ilustronin përmes rastit të dy partive ashkalike të Kosovës (PDASHK, PDAK) të cilat janë krijuar pas konfliktit në mes të udhëheqësve politik të ashkalinjëve të Kosovës<sup>157</sup>.

Pakicat etnike në përgjithësi janë ballafaquar me pengesa strukturale gjatë zhvillimit të aktiviteteve të fushatave politike. Profili i fushatave politike dhe qëndrimi i votuesve nga bashkësitë e pakicave, ishin të determinuara nga mjetet e kufizuara financiare, liria e kufizuar e lëvizjes për subjektet e vogla politike dhe nga pamundësia e mobilizimit të trupit zgjedhor jashtë Kosovës. Për shkak të gjendjes së vështirë financiare, Iniciativa qytetare rome (IQRK) nuk ka mundur të zhvillojë aktivitetet e fushatës. Për dallim nga kjo, PDAK ka përfituar nga përkrahja e diasporës së ashkalinjëve nga Evropa Perendimore, e cila i ka mundësuar këtij subjekt që të organizojë tubimet parazgjedhore në komunën e Fushë Kosovës dhe Podujevës. Fushata zgjedhore dhe qëndrimi i votuesve të subjekteve politike të serbëve, nuk ishin aq aktive. E vetmja parti politike serbe e cila ka mbajtur tubime politike në regjionin qendror të Prishinës, ishte

<sup>151</sup> Duhet të përmendet se edhe nismat politike të vendit që kanë buruar nga bashkësia e shumicës, kanë hasur në vështirësi të konsiderueshme financiare.

<sup>152</sup> SDA – Partia e veprimt demokratik + BSD – Partia demokratike boshnjake.

<sup>153</sup> Partia demokratike turke e Kosovës

<sup>154</sup> Iniciativa e re demokratike e Kosovës

<sup>155</sup> Partia demokratike e ashkalinjëve të Kosovës

<sup>156</sup> Iniciativa qytetare e Gorës

<sup>157</sup> Pas pranimit të pozitës dytësore në parti, si rrjedhojë ka ndodhur krijimi i partisë dhe udhëheqësisë së veçantë. Gjithashtu është raportuar se njëra prej këtyre partive në prag të zgjedhjeve, ka ndarë ndihma humanitare për disa familje të rrezikuara në regjionin e Prishtinës, me qëllimin e mundshëm të mbledhjes së votave. Ndarja e ndihmës humanitare ishte ndërprerë pas ditës së zgjedhjeve.

Lëvizja për Kosovë dhe Metohi (LKM) e udhëhequr nga Z. Momcilo Trajkovic. Subjektet politike të serbëve në regjionin e Prishtinës, nuk kanë raportuar për ndonjë pengesë në lidhje me certifikimin e subjekteve të tyre. Mirëpo, kanë theksuar se kjo ishte për shkak të përkrahjes së OSBE-së me transportimin e udhëheqësve politik për në takimet në departamentin për operacionet zgjedhore të OSBE-së.

Në përgjithësi, shërbimi për votues dhe regjistrim, ka qenë në disponim për të gjitha bashkësitë e pakicave, përfshirë këtu edhe të zhvendosurit që jetojnë në Serbi dhe Mal të Zi, me ç'rast OSBE-ja ka dhënë një kontribut të posaçëm në krijimin e regjistrimit të votuesve. Të gjitha bashkësitë gjithashtu kanë pasur qasje në programet edukuese dhe informative të votuesve, duke përfshirë këtu prap, fushatën e posaçme informative për votuesit e zhvendosur që jetojnë jashtë Kosovës.

## **II. QASJA NË PROCESIN POLITIK**

### **Strukturat qendrore**

Kuvendi i Kosovës përbëhet prej 120 deputetëve të zgjedhur, përfshirë këtu 20 vende të rezervuara për pakicat. Prej 14 partive të ndryshme të përfaqësuara, shtatë vijnë nga bashkësitë e pakicave. Gjithsejt 35 deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësojnë bashkësitë e pakicave<sup>158</sup>. Deri më tani, pak apo fare është nxjerrë nga legjislacioni sipas propozimeve të dala nga jo-shumica në nivelin qendror. Si hap pozitiv për raportet ndëretnike në Kosovë, është ai i kryesisë së Kuvendit e cila i ka tetë vende, njëri prej të cilit është rezervuar për përfaqësuesin nga bashkësitë e pakicave. Ky vend ndërrohet sipas sistemit të rotacionit. Gjatë vitit 2002, Z. Haxhi Merxha (PREBK) e ka plotësuar këtë vend dhe që nga janari i vitit 2003, Znj. Nafiye Gas (KDTP) duhet të plotësojë këtë pozitë. Si anëtare e kryesisë, Znj. Gas është femra me postin më të lartë në Kuvendin e Kosovës, por edhe në IPV-es të cilat nuk kanë ndonjë femër të emëruar në postin e ministrit.

Emërimet në IPV-es, të Z. Goran Bogdanovic në postin e ministrit të bujqësisë, pylltairsë dhe zhvillimit rural, Z. Nenad Radosavljevic si këshilltar në zyren për kthime të PSSP-së, Z. Milorad Todorovic si koordinator ndërministror për kthimet dhe Z. Numan Balic nga komuniteti boshnjak, në postin e ministrit të shëndetësisë, duhet të konsiderohen si zhvillime të rëndësishme në raportet në mes të komuniteteve të Kosovës pas konfliktit. Për qëllim të mundësisë të përfaqësimit të pakicave në komisionet e Kuvendit të Kosovës, numri fillestar i nëntë anëtarëve për secilin komision është rritur në njëmbëdhjetë pas lobimit të komitetit parlamentar ad hok të OSBE-së për Kosovë. OSBE-ja në mënyrë të suksesshme është siguruar që të vendosë anëtarin e partive gjegjëse në këto komisione. Një rezultat tjetër i kënaqshëm është fakti se përfaqësuesit nga pakicat kryesojnë katër nga gjithsejt shtatëmbëdhjetë komisione të Kuvendit. Komisioni mbi të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka rëndësi të posaçme dhe ka të drejtë të shqyrtojë të gjithë legjislacionin nën diskutim të Kuvendit, për të siguruar se legjislacioni në fjalë nuk bën shkelje të të drejtave dhe interesave të bashkësive të ndryshme etnike. Për këtë shkak, ky komision është një organ i fuqishëm i mënjanimin të diskriminimit. Përfaqësuesit e pakicave kryesojnë edhe komisionet tjera, atë të financave dhe ekonomisë, shëndetësisë dhe punës dhe mirëqenies sociale. Për qëllim të akomodimit të të gjitha bashkësive etnike, disa poste ofrohen në baza të sistemit të rotacionit.

Mirëpo, përgjegjshmëria e përfaqësuesve të lartë dhe eminent në strukturat qendrore politike, ndaj trupit të tyre zgjedhor është çështje seriozisht shqetësuese. Pas një rishikimi të institucioneve qeveritare të Kosovës, OSBE ka gjetur se gatishmëria joadekuate e zyrtarëve të zgjedhur për të

<sup>158</sup> Numri i përfaqësuesve për një parti politike të pakicave: Koalicioni kthimi (serb) 22; VATAN (boshnjakë) 4; KDTP (turq), 3 IRDK (egjiptas), 2 PDASHK (ashkali), 2 BSDAK (boshnjakë) 1, dhe PREBK (romë) 1.



marrë përsipër përgjegjësinë kundrejt zgjedhësve të tyre dhe mospërgjegjësia për shkak të, inter alia, komisioneve jofunksionale, paraqet një pengesë të madhe për pjesëmarrjen kuptimplote të bashkësive të pakicave në proceset politike.

### **Strukturat komunale**

Duke krahasuar përfaqësimin e anëtarëve nga pakicave në kuvendet komunale për periudhën 2000-2002, që përbëhej nga deputetët e zgjedhur dhe nga ata të emëruar, me mandatin 2002-2006 mund të konkludojmë se është shënuar rënje e përfaqësimit të pakicave në të njëjtin nivel. Për këtë arsye ekzistojnë gjasat që nivelet e ulta të përfaqësimit të pakicave të shpiejnë në një mosangazhim të mëtutjeshëm të pakicave në institucionet e nivelit lokal. Decentralizimi apo reforma e qeverisjes lokale mund të përmirësojë këtë çështje, edhpse për këtë padysim se nevojitet kohë për t'u realizuar.

Përderisa gjatë mandatit të parë të vetëqeverisjes lokale, vetëm pesë komuna kishin përbërje mono-etnike<sup>159</sup>, vetëqeverisja e tanishme lokale e Kosovës, posedon me 13 kuvende të tilla, përfshirë edhe dy kuvende mono-etnike serbe në veri të Kosovës<sup>160</sup>. Në 17 komunat tjera të Kosovës, vërehet një ndryshim i konsiderueshëm i numrit të përfaqësimit jo-shumicë. Me përjashtim të tre kkomunave në veri të lumit Ibër, dhe dy të tjera njëra në jug dhe tjetra në lindje të Kosovës<sup>161</sup>, të gjitha kuvendet tjera ballafaqohen me numrin në rënjë të përfaqësimit të bashkësive të pakicave. Gjithsejt, përfaqësimi në kuvendet komunale të Kosovës është zvogëluar prej 181 deputetëve jo-shumicë në numrin prej 110 sish për periudhën 2002-2006<sup>162</sup>.

Bazuar në faktin se, bashkësitë etnike dhe përfaqësimi i tyre në organet e zgjedhura në mënyrë demokratike për vetëqeverisjen lokale, në mënyrë të konsiderueshme është zvogëluar si rezultat i zgjedhjeve komunale 2002, mekanizmat pjesëmarrës për ato bashkësi të pakicave brenda strukturave ekzistuese të vetëqeverisjes lokale, fitojnë edhe më shumë në rëndësinë e tyre. Si një instrument kryesor për t'i dhënë legjitimitetin shqetësimeve të këtyre bashkësive, rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, stipulon krijimin e dy komiteteve të obligueshme për secilën komunë: Komitetin e bashkësive dhe Komitetin për ndërmjetësim (më tutje në tekst "komitetet"). Komitetet janë mekanizma të nevojshëm për lehtësimin e pjesëmarrjes së bashkësive etnike në jetën politike, kulturore, sociale dhe ekonomike të komunës. Gjatë të siguruarit se respektohen të drejtat dhe interesat e bashkësive të cilat jetojnë në komunë, komitetet gjithashtu, potencialisht e rrisin mirëbesimin e bashkësive dhe i inkurajojnë ato për t'u angazhuar në ndarjen e pushtetit mbe shumicën etnike.

Gjatë mandatit 2000-2002 të qeverive komunale, mundësitë e komiteteve për të ushtruar në mënyrë efikase rolin e tyre, kanë qenë të penguar nga një numër faktorësh, së bashku me disa paqartësi tjera të ambientit politik (psh, pjesëmarrja e serbëve të Kosovës). Krahas kësaj, interpretimet e ndryshme mbi tekstin e rregullores 2000/45 kanë kontribuar drejt vendim-marrjes së ngadalshme gjatë procesit të themelimit të komiteteve. Sipas Departamentit të UNMIK-ut për administratë lokale, komitetet duhej që të krijonin procedurat vetanake, duke u bazuar në udhëzimet e përgjithshme të parapara me rregulloren e sipërpërmendur<sup>163</sup>. Si rezultat i kësaj

<sup>159</sup> Këto ishin: Malisheva, Suhareka, Deçani, Gllogovci dhe Kaçaniku.

<sup>160</sup> Leposaviqi dhe Zveçani

<sup>161</sup> Shtërpcë dhe Novobërdë

<sup>162</sup> Në këtë shifër janë përfshirë deputetët nga komunat e Kosovës me shumicë serbe. Për një pasqyrë më të qartë mbi deputetët aktual të cilët përfaqësojnë zgjedhësit, në raste kur bashkësia etnike është pakicë krahas përkatësisë etnike, kjo shifër është 52 nga gjithsejt 918 vende. Gjatë zgjedhjeve 2000, shkalla e emërimeve ishte 143 nga gjithsejt 1046.

<sup>163</sup> Këto përfshijnë procedurat e emërimit të anëtarëve të komiteteve, rregullimi i të cilave i është lënë statuteve të komunave. Lexo rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 neni 23.

gasjeje decentraliste, efikasiteti i këtyre komiteteve dhe konsistenca në procesin e vendim-marrjes, dallonte prej një komune në tjetrën. Në vendet ku ekzistonte bashkëpunimi i ngushtë në mes të autoriteteve lokale dhe palës ndërkombëtare – siç janë ZKL-le dhe AK KB-ra – komitetet funksiononin dhe problemet e bashkësive të pakicave, parashtroheshinnë mënyrë efikase. Në vendet në të cilat nuk ekzistonin këto rrethana, komitetet de facto ishin jofunksionale dhe pengonin pjesëmarrjen kuptimplote të bashkësive të pakicave në punët e komunës.

Problem tjetër në nivelin e strukturave politike komunale, është i cilësisë dhe legjitimitetit të përfaqësueseve të pakicave. Duket të jetë rasti se, në mesin e bashkësive të REA\_ve të Kosovës në Prizren dhe Gjilan, apo në mesin e serbëve në Lipjan dhe Obiliq, ekzistojnë dëshmi se përfaqësuesit e tyre nuk e gëzojnë mbështetjen e plotë nga bashkësitë e veta. Shumë prej udhëheqësve lokal janë emëruar, dhe nga kjo, buron mungesa e mandati demokratik të dhënë nga zonat e tyre zgjedhore.

Ky problem vlen gjithashtu edhe për komitetet.<sup>164</sup> Pa pasur një mundësi për të fituar një kulaç në sistem i cili do t'i artikulonte shqetësimet e tyre të ndryshme dhe do të ofronte kompenzim për ta, bashkësitë e pakicave do të vazhdojnë të jenë të tjetërsuara nga proceset kryesore duke besuar se nuk janë në gjendje të ndikojnë në rezultatet e këtyre proceseve.

Me qëllim të adresimit të këtij problemi, Zyra e UNMIK-ut për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) hartoi një urdhëresë administrative mbi rregullat e procedurës për komitetet e bashkësive në shtator 2001, mirëpo finalizimi i saj është ende në zhvillim e sipër. Në mungesë të skemës së tillë procedurale për të dyja komitetet, problemet e njëjta sa i përket formimit të tyre ndodhën gjatë procesit të implementimit të zgjedhjeve komunale 2002.<sup>165</sup>

Deri në dhjetor 2002, të dy komitetet ishin themeluar vetëm në shtatë komuna.<sup>166</sup> Përderisa kuvendet komunale sapo janë zgjedhur dhe tani kanë mandat katër vjeçar, është treguar se kjo koha më e volitshme për t'i nxjerrur këto Rregulla të Procedurës për të dyja komitetet dhe komitetin për ndërmjetësim.

### **III. TOLERANCA, PAJTIMI DHE DIALOGU NDËRETNIK**

Në vlerësimin e kaluar u shënuar një rritje, edhepse e vogël, e mundësive për dialog ndërmjet të udhëheqësve të popullatës shumicë dhe asaj pakicë. Duhet të përfundohet se ky trend përfitoi nga momenti gjatë periudhës raportuese, duke lëvizur nga deklaratat individuale dhe retorike drejt një sërë nismash të ndryshme qytetare të ndërmarrja me qëllim të përmirësimit, edhepse të ngadalshëm, të marrëdhënieve ndërmjet tyre. Bashkësia ndërkombëtare në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar rëndësinë e deklaratave publike nga përfaqësuesit e IPV-ve për adresimin e qartë të çështjes së marrëdhënieve ndëretnike. Përderisa nismat spontane për dialogun ndëretnik mund të përfshijnë në veti edhe ndërveprimin e zakonshëm ndërmjet qytetarëve, që nga pranvera e vitit 2002 është vërejtur një rritje e numrit të kontakteve të nivelit të ulët ndërmjet fqinjëve, tregtarëve, konsumatorëve dhe pronarëve të shitoreve.

<sup>164</sup> Në bazë të Regullores së UNMIK-ut 2000/45, kuvendi komunal (neni 21) emëron anëtarët e komiteteve. Nuk është i paraparë shprehimisht zhvillimi i konsultimeve me njësitë zgjedhore.

<sup>165</sup> Sipas dokumentit të lëshuar nga Departamenti për Administratë Lokale i UNMIK-ut më 18 tetor 2002, procesi i emërimit të anëtarëve në të dyja komitetet është dashur të kryhet ndërmjet 25 dhe 30 nëntorit 2002. Edhe në kohën e përpilimit të këtij raporti, nuk dihet numri i saktë i komiteteve të themeluara nëpër komunat përkatëse.

<sup>166</sup> Leposaviq, Vushtrri, Zubin Potok, Pejë, Istog, Prizren, dhe Dragash.

Në pajtim me Kornizën Informativë të UNMIK-ut/UNHCR-së për personat e zhvendosur dhe komunitetet pranuese, nëpër radio stacionet lokale në Prizren, duke filluar nga dhjetori 2002 janë transmetuar një sërë diskutimesh publike të cilat kanë për qëllim mbështetjen e idesë për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike. Diskutimet të cilat përfshinin udhëheqësit e ndryshëm të komuniteteve, aktivistët e OJQ-ve, të organizatave rinore dhe të grave so dhe politikanë të ndryshëm, kishin për qëllim të vetëm shkëmbimin e pikëpamjeve rreth çështjes së kthimit të personave të zhvendosur në komunat e Kosovës jugore.<sup>167</sup> Prizreni është një qendër multietnike, dhe njihet për një laramani mediale e cila përshkohet me një numër të madh të transmetuesve në gjuhët e pakicave.<sup>168</sup> Një përparim i dukshëm sa i përket normalizimit të marrëdhënieve ndëretnike është arritur edhe në forcimin e lidhjeve ndërmjet grupeve rinore të përkatësive të ndryshme rinore. Projekti “Kampi për Ndërtimin e Tolerancës u implementua me sukses në shtator 2002. Përfaqësuesit e rinjë të Shoqatës Ura<sup>169</sup> mbajtën një sërë punëtorish dhe seminare mbi kuptimin e konfliktit dhe transformimin paqësor të konfliktit.

Niveli i dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme në kuadër të strukturave qeverisëse komunale dhe atyre qëndrore paraqesin një tregues për përparimin e arritur sa i përket pajtimit dhe realizimit të qëllimeve të përbashkëta. Një theks i veçantë duhet të vihet mbi rolin e përfaqësuesve komunal në procesin e kthimit, për shkak se këta liderë ishin në pozitë më të mirë për të dhënë porosi më të besueshme të cilat kuptohen nga publiku vendas. Deklaratat pozitive të bëra nga udhëheqësit, të shoqëruara me veprime konkrete në nivel komunal, kanë ndikim të fuqishëm në perceptimin të cilin do ta ketë popullata shumicë në lidhje me bashkësitë e pakicave.

Siç shihet me rastin e komunës së Vushtrrisë, me kthimin e ashkalinjëve të Kosovës, në mënyrë që të jenë efikase akcionet konkrete të niveleve komunale, këto duhet të përcjellen edhe në nivelin e fshatit, gjegjësisht komunitetin pranues (nikoqir). Hapat tjerë për të krijuar kushtet për këtë kthim janë ndërmarrë në mars të vitit 2001 kur një OJQ lokale ahkallike ka nisur diskutimet anëtarët e kuvendit komunal, TMK-në, SHPK-në dhe komunitetin pranues (nikoqir). Menjëherë pas kthimit të parë të këtij grupi në prill të vitit 2002, Kryeministri kishte vizituar komunitetin për të përkrahur dialogun ndëretnik dhe të drejtën për të u kthyer. Përkundër këtyre përgatitjeve, komuniteti i mbetur i ashkalinjëve sidhe të kthyerit, kanë përjetuar ngacmime dhe frikësime serioze<sup>170</sup>, duke treguar për nevojën e angazhimit më të madh të komunitetit shumicë drejt përpjekjeve për pajtim.

---

<sup>167</sup> Diskutimet e llojit të “Tryezës së Rrumbullakët mbi Kthimin” do të inçizohen, shpërndahen dhe transmetohen nëpër radio dhe stacionet televizive të regjionit të Prizrenit.

<sup>168</sup> Revistat boshnjake *ALEM* dhe *SELAM* dhe gazeta turke *YENI DONEM* (e cila shpërndahet anëmbanë Kosovës) mbulojnë të gjitha ngjarjet dhe aspektet të cilat ndodhin në strukturat komunale, qëndrore dhe lokale. Krahas kësaj, revistat boshnjake *DJULISTAN*, ajo turke *TURKCEM*, *BAY* dhe *SOFRA* mbulojnë tema të ndryshme edukative, kulturore dhe shkencore të cilat si publik të vetin i kanë nxënësit e shkollave fillore dhe atyre të mesme. Tri radio transmetues lokal janë të vendosur në regjionin e Prizrenit, transmetuesi në gjuhën turke *YENI DONEM* dhe dy në gjuhën boshnjake - *OMEGA-3* dhe *ASTRA*. Vlen të përmendet se radio stacioni *PRIZREN* dhe stacioni televiziv *TV Station STP* paraqesin stacione shumëgjuhësore të cilat transmetojnë programe në gjuhën shqipe, serbokroate dhe atë boshnjake.

<sup>169</sup> Shoqata Ura është një union i katër OJQ-ve rinore të grupeve të ndryshme etnike: shqiptare, boshnjake, turke dhe rome.

<sup>170</sup> Në mesin e incidenteve që kishin ndodhur është ai i 23 prillit 2002 – shpërthimi i një bombe – punim dore, në oborrin e një ashkaliu i cili asnjëherë nuk është larguar; pas vizitës së Kryeministrit me 20 dhe 21 maj një grup shqiptarësh ju afruan portës së shtëpisë së një të kthyeri dhe kishin thirrur emrat e tyre dhe tentuar që të depërtojnë duke shtyer portën me automjetin e tyre, dhe me 30 nëntor 2002, një i kthyer ishte rrahur nga punëtorët e një firme të ndërtimtarisë e cila ishte e kontraktuar për ndërtimin e shtëpive të të kthyerve.

Nga GPR-le pritet që të fuqizojnë angazhimin e përfaqësuesve lokal në procesin e kthimit. Shpresohet se një angazhim i tillë do të dërgojë një sinjal të tolerancës dhe pajtimit për komunitetet nga të cilat vijnë këta përfaqësues lokal. Fatkeqësisht kontributi i tyre deri më tash ka qenë i kufizuar pjesërisht për shkak se shumica e GPR-le ishin themeluar vetëm gjatë vjeshtës 2002, dhe pjesërisht për shkak se pjesëmarrja e zyrtarëve të zgjedhur komunal ka qenë e parregullt, apo ska pasë fare. Siç është theksuar më sipër, niveli dhe cilësia e pjesëmarrjes lokale nëp këtë proces në disa shembuj mund të shihet si pasqyrë e prioriteteve siç është pjesëmarrja e administratorit komunal të UNMIK-ut apo zyrtarë tjerë të këtij niveli<sup>171</sup>.

Interesat e përbashkëta të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme janë treguar si një pikënisje e shkëlqyeshme drejt forcimit të ndërveprimit ndërmjet tyre. Shtimi i kontakteve ndëretnike është mëse i dukshëm në fushat e ndryshme të mjeteve të informimit publik. Shembuj të mirë në këtë drejtim janë edhe krijimi i Pres Klubit multietnik në regionin lindor të Gjilanit nga ana e OSBE-së, apo shtimi i bashkëpunimit ndërmjet radiostacioneve lokale shqiptare dhe serbe. Transmetuesit publik nga Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova u pajtuan për të krjuar një Rrjet të televizioneve për fëmijë të Ballkanit dhe për të publikuar një revistë të përbashkët të përbërë nga artikujt e revistave në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi dhe Shqipëri me temën: “Një ditë në jetën e një fëmiju nga regjioni im”. Shembuj tjerë në lidhje me aktivitetet e reja për nxitjen e mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve si një hap drejt pajtimit është edhe filmi dokumentar “Intervistat Drejtpërdrejt” e inicuar nga OSBE-ja gjatë vitit 2002. Ky film dokumentar shfaq një pasqyrë reale të gjendjes së tanishme në të cilën jetojnë të rinjtë shqiptarë dhe ata serbë e cila për qëllim ka informimin e të dyja grupeve rinore për kushtet e tyre të jetesës. Investimet e vogla në infrastrukturë, shërbime publike apo objekte arsimore ishin një katalizator i nxitjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndëretnik. Investimet e Vogla për Fondin e Pakicave, e cila është siguruar nga qeveria e Holandës, rezultuan në nxjerrjen e rekomandimeve gjatë vlerësimit të kaluar për nevojën e përfitimeve të përbashkëta nga ndihmat si të popullatës shumicë gjithashtu edhe të asaj pakicë si një metodologji obligative për dhënien e ndihmës.

Me qëllim të krijimit të mundësive për t’i informuar pjesëtarët e pakicave në mënyrë që ata të zgjedhin pastaj se a dëshirojnë të marrin pjesë në jetën publike apo jo, OSBE-ja në bashkëpunim me Fondacionin Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) zhvilloi një projekt tremujor për t’i ndihmuar pakicave tjera joserbe për t’i ngritur shqetësimet e tyre dhe për t’i formuluar rekomandimet e tyre për përmirësimin e shërbimeve komunale. Rreth 70 mbledhje ishin mbajtur anëmbanë Kosovës me grupet e pakicave boshnjake, kroate, RAE, gorane dhe turke. Rreth 800 njerëz morrën pjesë në këto diskutime dhe u përgjegjën në pyetësorët për shërbimet komunale dhe kushtet e jetesës. Projekti ka hyrë në fazën e dytë të mbledhjeve me përfaqësuesit e bashkësive të pakicave, i cili ka për qëllim që të fitojë opinionet e njerëzve në lidhje me këto çështje me qëllim të formulimit sa më të mirë të rekomandimeve për komunat, përfaqësuesit e zgjedhur apo të emëruar, dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare. Pas këtij projekti pasuan edhe mbledhjet e tjera të mbajtura në këtë regjion, përderisa pritet të bëhet edhe botimi i një broshure ku do të përfshihen shqetësimet e pakicave, e cila do të shfrytëzohet nga kuvendet e zgjedhura komunale si një udhëzim për punën e tyre të ardhshme në këtë fushë.

Spektori i shoqërisë civile në Kosovë ka zgjeruar mjaft rolin e tij në procesin e dialogut ndëretnik dhe ka filluar të marrë përgjegjësitë në krijimin e lidhjeve ndërmjet komuniteteve të ndryshme. Një shembull i mirë i nismave të ndërmarra për forcimin e bashkëpunimit dhe dialogut ndëretnik është edhe formimi dhe konsolidimi i Alternativës për Dialog Civil, e cila është një grup multietnik i përbërë nga akterë të ndryshëm të jetës civile si në Kosovë ashtu edhe në Serbi,

<sup>171</sup> Për shembull një dinamikë e këtillë është parë në Prishtinë dhe Podujevë.

nismë kjo e ndërmarrë nga vetë OSBE-ja gjatë vitit 2002.<sup>172</sup> Qarku i rritur i përfaqësuesve të organizatave tjera civile pasqyrojnë një potencial të madh për këtë projekt. Aktivistë të njohur për paqë, tolerancë dhe përfshirje të shoqërisë civile në jetën publike, siç është edhe ish ambasadori i RFJ-së në SHBA dhe perfekt i Beogradit, Zoti Zhivorad Kovaçević, kanë për qëllim krijimin e mirëbesimit ndëretnik dhe të kushteve për kthimin e personave të zhvendosur pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike.

Një dimension tjetër i rëndësishëm i shoqërisë civile është edhe zhvillimi i OJQ-ve. Përderisa ekziston veç një numër i madh i OJQ-ve në Kosovë, shumica e tyre janë shumë të varur nga OJQ-të ndërkombëtare. Vetëm disa nga to kanë kapacitet, motivim dhe perspektivë afatgjate për të mbijetuar pa ndihmën e drejtpërdrejt të agjencive të ndryshme ndërkombëtare. Sidoqoftë, jemi dëshmitar të një rritje të numrit të nismave për tolerancë dhe pajtim. Rrjeti i Qendrave të Komuniteteve, nismë kjo e ndërmarrë nga OSBE-ja,<sup>173</sup> vazhdon me zhvillimin e shoqërisë civile dhe dhënien e ideve dhe përkrahjes OJQ-ve vendëse. Qendrat e tilla<sup>174</sup> lehtësojnë punën e rrjetit të OJQ-ve, duke ofruar hapësirë për takime dhe lidhje në internet, duke dhënë ndihmën gjatë regjistrimit të OJQ-ve, dhe duke pruar donatorët e mundshëm në qendrat dhe duke mbajtur seminare dhe punëtori të llojllojshme.

---

<sup>172</sup> Projekti i dialogut, i cili përbëhet nga Qendra për Regjionalizim me seli në Novi Sad dhe Shoqata Nëna Terezë nga Prishtina, e institucionalizojë karakterin e saj multi-etnik nëpërmjet të krijimit të një Këshilli Këshilldhënës të përbërë nga 4 anëtar shqiptar dhe 4 serbë në janar.

<sup>173</sup> Gjithsejt 8 qendra të komuniteteve ofrojnë shërbimet e tyre për komunitetet të cilat ndodhen në lokalitetet më të izoluar. Ato fillimisht janë themeluar me ndihmën ndërkombëtare, përderisa tani i janë dorëzuar akterëve vendës të shoqërisë civile.

<sup>174</sup> Një shembull tregues në këtë drejtim është edhe Iniciativa e Mitrovicës për Përkrahje të OJQ-ve (MINGOS), e cila buroi si një nismë e ndërmarrë nga ana e Departamentit të Demokratizimit të OSBE-së, apo edhe Qendra e Komuniteteve në Fushë Kosovë.